



UNIVERSITETI LUARASI
FAKULTETI I DREJTËSISË

LIBRI I ABSTRAKTEVE

KONFERENCA SHKENCORE NDËRKOMBËTARE

“DREJTËSIA, SIGURIA DHE
TË DREJTAT E NJERIUT”
(KSHNDSDN - FDUL 2025)

8 MAJ 2025



Universitat
Abat Oliba CEU



TOKAT
GAZIOSMANPAŞA
ÜNİVERSİTESİ



FAKULTETI ZA
POSLOVNU EKONOMIJU
I PRAVO BAR



FUTURA
FAKULTET ZA PRIMENJENU EKOLOGIJU



Komiteti Shkencor Ndërkombëtar i Konferencës

- 1) Prof. Dr. Maksim Haxhia
- 2) Prof. Dr. Dorina Hoxha
- 3) Prof. Dr. Ilirjan Mandro
- 4) Prof. Dr. Snežana Štetić
- 5) Prof. Asoc. Dr. Admir Belishta
- 6) Prof. Asoc. Dr. Mentor Lecaj
- 7) Prof. Asoc. Dr. Egzone Osmanaj
- 8) Prof. Asoc. Dr. Besard Belegu
- 9) Prof. Asoc. Dr. Artan Fejzullahu
- 10) Prof. Asoc. Dr. Žaklina Spalević
- 11) Prof. Asoc. Dr. Erjon Muharremaj
- 12) Dr. Jean-Christophe Gay
- 13) Dr. Vladica Ristić
- 14) Dr. Marija Maksin
- 15) Dr. Violeta Babić

Komiteti Organizativ i Konferencës

- 1) Prof. Asoc. Denard Veshi
- 2) Dr. Dael Dervishi
- 3) Dr. Katrin Treska
- 4) Dr. Lorenc Stojani
- 5) Dr. Blerina Shkurti
- 6) Dr. Ermira Tafani
- 7) Dr. Blendi Himçi
- 8) Dr. Erinda Ahmetaj
- 9) PhD. (C) Ganimete Ismajli
- 10) PhD. (C) Folitjona Puravelli
- 11) PhD. (C) Anisia Mandro
- 12) Ma. Katarina Bjelić

REFLEKTIME MBI BASHKËPUNIMIN E POSAÇËM

Florjan Kalaja¹

Abstrakt

Bashkëpunimi i posaçëm është një ndër çështjet më të rëndësishme të së drejtës penale. Shkrimi synon të trajtojë disa çështje me rëndësi praktike dhe teorike të kërrij instituti të së drejtës penale. Ndër çështjet që trajtohen janë dënimi në bashkëpunimin e posaçëm, mbivendosjet e fushës së veprave penale të bandës së armatosur me organizatën kriminale, mungesa e koherencës në proporcionalitetin e dënimit të këtyre formacioneve të bashkëpunimit të posaçëm, problematika të zhvillimit të praktikës gjyqësore në individualizimin e formave të posaçme të bashkëpunimit tej grupit të strukturuar kriminal dhe bashkëpunëtorët e jashtën ndërmjet bashkëpunimit të posaçëm dhe atij të zakonshëm. Shkrimi synon që për secilën nga këti çështje të parashtojë anklizën kritike dhe të përmbillet më tej me një konkluzion respektiv. Një ndër qëllimet që ky shkrim ka është edhe dhënia e proporzimeve respektive ligjore për zhvillimin e së drejtës penale në këtë fushë, duke pasur parasysh se kohët e fundit ka pasur edhe një iniciativë zyrtare për të hartuar një Kodit Penal të ri.

Fjalë kyçe: Bashkëpunimi i posaçëm, dënimi penal në bashkëpunimin e posaçëm; organizata kriminale; Organizata terroriste; Organizata e trafikimit të lëndëve narkotike; Banda e armatosur, Grupi i strukturuar kriminal; proporcionaliteti i dënimit; problematikat e praktikës gjyqësore; bashkëpunëtori i jashtëm; projekti i Kodit Penal të ri.

1. Autori është gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

REFLECTIONS ON SPECIAL COMPLICITY

Abstract

Special complicity is one of the most important issues of criminal law. The article aims to address several issues of practical and theoretical importance of this institution of criminal law. Among the issues addressed is the punishment in special organization, the overlaps of the field of criminal offenses of the armed gangs with the criminal organization, the lack of the coherence in the proportionality of the punishments of these special complicity formations, the problems of the development of judicial practice in the individualization of special forms of complicity beyond the structured criminal groups and external accomplices between special and ordinary complicity. This article aims to present a critical analysis for each of these issues and to conclude with a respective conclusion. One of the goals that this article has is also to provide the respective legal propositions for the development of criminal law in this area, considering that recently there has also been an official initiative to draft a new Criminal Code.

Keywords: *Special complicity; the punishment in special complicity; criminal organization; terrorist organization; the organization for drug trafficking; armed gang; structured criminal group; the proportionality of the punishment; the problems of judicial practice; the external accomplice; the new draft of the Criminal Code.*

PËRDORIMI I PROVAVE ELEKTRONIKE DHE STANDARDET E GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Adnan Xholi¹

Abstrakt

Prova elektronike, siç e pranoi Gjykata Evropiane në çështjen Yüksel Yalçınkaya k. Turqisë [GC], nr. 15669/20, 26 shtator 2023, është bërë i kudondodhur në gjykimet penale në funksion të digjitalizimit në rritje të të gjitha aspekteve të jetës. Ajo mund të lidhet me vepra të botës fizike, por edhe me ato specifike për mjedisin digjital.

Masat për marrjen dhe ruajtjen e provave elektronike janë gjithnjë e më të rëndësishme për hetimet penale dhe ndjekjet penale në të gjitha vendet. Mekanizmat efektivë për marrjen e provave elektronike janë thelbësore për luftimin e krimit dhe mekanizma të tillë duhet t’u nënshtrohen kushteve dhe masave mbrojtëse për të garantuar përputhjen e plotë me të drejtat dhe parimet themelore të njohura në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në nenin 6 të Traktatit për Bashkimin Evropian (TEU) dhe Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (“Karta”), në veçanti parimet e domosdoshmërisë dhe mbrojtjes së të dhënave të proporcionalitetit, procesit të duhur të komunikimit.

Fakti që krimet mund të kryhen në hapësirën kibernetike mund të ketë nevojën për bashkëpunim në mbledhjen dhe shkëmbimin e provave elektronike, duke shkaktuar marrëveshje të tilla si ato sipas Rregullores (BE) 2023/1543 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 12 korrik 2023 për Urdhrat Evropiane të Prodhimit dhe Urdhrat

1. Grada shkencore-Doktor.

Drejtues i Seksionit kundër Krimit të Organizuar dhe Terrorizmit, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar,

Email: xholiadan@gmail.com

Evropiane të Ruajtjes për provat elektronike në procedurat penale dhe për ekzekutimin e dënimeve me burg pas procedurave penale.

Praktika gjyqësore e GJEDNJ-s ka vendosur një mori standardesh për specifikat e mbledhjes dhe përdorimit të provave të tilla, si dhe sigurimin që kjo të mos çojë në ndërhyrje të pajustificuara në të drejtat dhe liritë e garantuara.

Fjalë kyçe: *papërdorshmëri, hetim, prove elektronike, standard, jurisprudence*

THE USE OF ELECTRONIC EVIDENCE AND THE STANDARDS OF THE EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS

Adnan Xholi¹

Abstract

Electronic evidence, as acknowledged by the European Court in the case of Yüksel Yalçinkaya v. Turkey [GC], no. 15669/20, September 26, 2023, has become ubiquitous in criminal trials in light of the increasing digitalization of all aspects of life. It can be related to acts in the physical world, but also to those specific to the digital environment.

The measures for the collection and preservation of electronic evidence are increasingly important for criminal investigations and prosecutions in all countries. Effective mechanisms for the collection of electronic evidence are essential for combating crime, and such mechanisms should be subject to conditions and safeguards to ensure full compliance with the rights and fundamental principles recognized in the European Convention on Human Rights, in Article 6 of the Treaty on European Union (TEU), and the Charter of Fundamental Rights of the European Union (“Charter”), particularly the principles of necessity and proportionality in data protection, as well as of due process of communication.

The fact that crimes can be committed in cyber-space may necessitate cooperation in the collection and exchange of electronic evidence, leading to agreements such as those under Regulation (EU) 2023/1543 of the European Parliament and Council of July 12,

1. Scientific Degree: PhD;

Head of the Section against Organized Crime and Terrorism at the Special Prosecutor’s Office against Corruption and Organized Crime;

Email: xholiadan@gmail.com

2023, on European Production Orders and European Preservation Orders for electronic evidence in criminal proceedings and for the enforcement of custodial sentences following criminal proceedings.

The judicial practice of the European Court of Human Rights (ECHR) has established a series of standards for the specifics of gathering and using such evidence, as well as ensuring that this does not lead to unjustified interference with guaranteed rights and freedoms.

Keywords: inadmissibility, investigation, electronic evidence, standard, jurisprudence.

PJESËMARRJA E VIKTIMAVE SI PALË CIVILE NE PROCESET PENALE NDËRKOMBËTARE

Rudina Jasini¹

Abstrakt

Drejtësia për viktimat e luftës dhe të krimeve të tjera ndërkombëtare është konsideruar si qëllimi kryesor i ngritjes dhe funksionimit të mekanizmave të ndryshëm në kuadrin e drejtësisë penale ndërkombëtare. Ky objektivi ka qenë në qendër të punës së tribunaleve penale ndërkombëtare duke përfshirë ato ad hoc, hibride si dhe në punën e Gjykatës Penale Ndërkombëtare në Hagë. Vështirësia më e madhe e ndeshur nga këto gjykata lidhet me ambiguitetin në interpretimin se çfarë do të thotë drejtësi për viktimat e krimeve të genocidit, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, dhe se çfarë forme ajo duhet të marrë në kontekstin procedural penal ndërkombëtar. Si i tillë, aplikimi i pjesëmarrjes së viktimave si palë civile (si palë e tretë) në proceset penale ndërkombëtare përben një risi në zhvillim dhe është karakterizuar nga përjasje të ndryshme dhe jo konsistente të gjykatave dhe tribunaleve të ngritura deri më sot. Në këtë ligjeratë do të ofrohet një përmbledhje e zhvillimit normativ dhe procedural të pjesëmarrjes së viktimave si palë civile si dhe aplikimin e saj në praktikë. Në mënyrë të veçantë, në këtë prezantim do të diskutohet edhe mbi ndikimin që zhvillimi dhe praktika në të drejtën e brendshme ka patur mbi atë të pjesëmarrjes së viktimave si palë civile në të drejtën penale ndërkombëtare

1. Dr Rudina Jasini, Studiuese dhe Lektore pranë Universitetit të Oxfordit, Fakulteti i Drejtësisë; Avokate në Grupin e Mbrojtjes së Z. Rexhep Selimit në Çështjen e Thaci et al pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë.

Email: inajasini@gmail.com

dhe anasjelltas. Gjithashtu, ky prezantim do të hedhë dritë mbi pasojat dhe impaktin që kjo pjesëmarrje ka në procesin penal dhe zhvillimin e procedurave gjyqësore, mbi të drejtat e të akuzuarit dhe mbi të gjitha mbi të drejtat e vetë viktimave.

Fjalë kyçe: *Viktimë; Viktimologji; E Drejta Penale Ndërkombëtare; Genocid; Krime të Luftës; Krime kundër Njerëzimit; Drejtësia Penale Ndërkombëtare*

THE PARTICIPATION OF VICTIMS AS CIVIL PARTIES IN INTERNATIONAL CRIMINAL PROCEEDINGS

Rudina Jasini¹

Abstract

Justice for victims has often been claimed as the raison d'être and the rallying call of international criminal justice mechanisms. This noble goal has been at the heart of the work of hybrid and ad hoc international criminal tribunals as well as the International Criminal Court in The Hague. The main challenge for these mechanisms lies in the ambiguity as to what justice for victims means and what form it takes within the international criminal justice. The incorporation of victims as civil parties (partie civile) in international criminal proceedings is a novelty, and as such its application has been significantly diffuse and at times divergent, betraying a far from cohesive and consistent approach by the international criminal tribunals established to date. This presentation will offer a résumé of the normative and procedural development of victim participation and its application in practice. More specifically, it will highlight the impact that the application of victim participation in domestic criminal justice systems has had on the development of this legal mechanism in the international criminal justice sphere and vice versa. Further, this presentation will shed light on the implications of victim participation with respect to the functionality of court proceedings, the rights of the accused, and the rights of victims themselves.

Key words: Victim; Victimology; International Criminal Law; Genocide; War Crimes; Crimes Against Humanity; International Criminal Justice

1. Dr Rudina Jasini, Researcher and Senior Lecturer, University of Oxford, Faculty of Law; Co-Counsel on the defence team of Mr Rexhep Selimi in Thaci et Al case before the Kosovo Specialist Chambers in The Hague.

Email: inajasini@gmail.com

THE ROLE OF SERVICE PROVIDERS IN SAFEGUARDING HUMAN RIGHTS: A STUDY OF ELECTRONIC EVIDENCE GOVERNANCE IN CROSS-BORDER CRIMINAL INVESTIGATIONS

Prof. Assoc. Erjon Muharremaj¹

PhD (c) Giola Cami²

Abstract

The rise of transnational crimes has led to a growing reliance on cross-border access to electronic evidence in criminal investigations. Implicated evidence occurs within a cross-border landscape that involves multiple jurisdictions and a mix of both public and private entities. This shift presents complexities for criminal proceedings, particularly concerning the integrity of data involved in due process.

The investigation of technology-enabled crimes has highlighted the inefficiencies of traditional cooperation mechanisms, having been deemed lengthy, slow and burdensome. To address this, lawmakers are exploring alternative instruments to improve efficiency in criminal proceedings. Within this meaning, this study will conduct a comparative legal assessment of the cooperation instruments established ad hunc effectum in the Council of Europe's framework—specifically, the Budapest Convention on Cybercrime and its Second Additional Protocol on Enhanced Cooperation and Disclosure of Electronic Evidence. The study will undertake a comparative analysis of the procedural rules under the existing Mutual Legal Assistance (MLA) framework against the pending ratification of the Direct Access to Service Provider procedure. As a case study, Albania's electronic evidence framework will be assessed

1. University of Tirana, Faculty of Law, Department of Public Law, erjon.muharremaj@fdut.edu.al

2. University of Szeged, Faculty of Law and Political Sciences, Department of Criminal Law, camigiola@stud.u-szeged.hu

for compliance with the CoE regulations.

This study will employ a doctrinal legal assessment, analyzing both regulations and literature. It will combine descriptive analysis, theoretical legal evaluation, and ECtHR case law. Additionally, a comparative method will be used, in order to examine the current criminal procedural norms governing both cooperation instruments and assess Albania’s compliance with the CoE framework.

Preliminary findings suggest that while the Protocol streamlines cross-border data collection by bypassing MLA-related delays, direct cooperation with service providers raises data processing concerns and potential human rights implications.

|| **Keywords:** *electronic evidence, cross-border, service provider, data processing, human rights.*

**ROLI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE NË
MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT:
NJË STUDIM MBI RREGULLIMIN LIGJOR
TË PROVAVE ELEKTRONIKE
NË HETIMET PENALE NDËRKUFITARE**

**Prof. Asoc. Erjon Muharremaj¹
PhD (c) Giola Cami²**

Abstrakt

Rritja e krimeve kibernetike, dhe jo vetem, ka sjellë në qendër të vëmendjes rëndësinë e provave elektronike, procesimi i të cilave përfshin juridiksione të dy ose më shtume shteteve, dhe përfshin si subjektet publike, ashtu edhe ato private. Ky realitet i ri paraqet sfida për procedurën penale, veçanërisht në lidhje me integritetin e të dhënave në kuadër të procesit të rregullt ligjor.

Në kuptim të veprimeve hetimore në nivel ndërkufitar, janë evidentuar mangësi të mekanizmave tradicionale të bashkëpunimit, të cilët konsiderohen të të ngadaltë dhe burokratikë. Për të adresuar sa më lart, ligjvënësit kanë propozuar instrumente alternative bashkëpunimi ndërkombëtar për të rritur efikasitetin e procedurave të administrimit të provës elektronike. Për këtë qëllim, ky studim bën një vlerësim të instrumenteve të bashkëpunimit, themeluar ad hunc effectum në kuadrin e Këshillit të Evropës (KiE), konkretisht Konventën e Budapestit për Krimin Kibernetik dhe Protokollin e saj të Dytë Shtesë për Bashkëpunim të Zgjeruar dhe Zbulimin e Provave Elektronike.

Përkatësisht, subjekt vlerësimi ligjor janë rregullimet normative të

1. Departamenti i të Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, erjon.muharremaj@fdut.edu.al

2. Departamenti i të Drejtës Penale, Fakulteti i Ligjit dhe Shkenave Politike, Universiteti i Szeged, Hungari. Cami.giola@stud.u-szeged.hu

Ndihmës së Ndërsjellë Juridike (NDJ), ndaj procedurës për Akses të Drejtpërdrejtë me Ofruesit e Shërbimeve. Në cilësinë e rastit studimor, do të vlerësohet përputhshmëria e kuadri ligjor të Shqipërisë mbi provat elektronike me legjislacionin e KiE-së.

Ky studim mbështetet në një analizë doktrinare juridike, duke shqyrtuar si kuadrin rregullator ashtu edhe literaturën përkatëse. Dy shtyllat kryesore të metodologjisë përfshijnë analizë ligjore cilësore dhe krahasuese si të normave ligjore, ashtu edhe të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

Rezultatet paraprake sugjerojnë se, ndërsa bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me ofruesit e shërbimeve përshpejton mbledhjen e të dhënave ndërkufitare duke anashkaluar vonesat që lidhen me NDJ-së, ai ngre shqetësime në lidhje me përpunimin e të dhënave dhe ndikimet e mundshme në të drejtat e njeriut.

Fjalë kyçe: prove elektronike, ndërkufitar, ofrues i shërbimeve, përpunimi i të dhënave, të drejtat e njeriut.

SEANCA PARAPRAKE, PARË NË KËNDVËSHTRIMIN E RISIVE DHE PROBLEMATIKAVE

Prof. Asoc. Dr. Admir Belishta¹

Klea Biqiku²

Abstrakt

Ndryshimet ligjore të vitit 2017, si rezultat i reformës në drejtësi, kanë prekur gjithashtu Kodin e Procedurës Penale. Për rrjedhojë, ky kod, në pothuaj 2/3 e përmbajtjes së tij ka pësuar amendime ligjore, të cilat janë pasqyruar në formën e shtesave, përditësimeve, apo edhe parashikimeve të instituteve të reja procedurale. Këto të fundit, janë parë si risi jo vetëm për sanksionimin për herë të parë në kod, por edhe për pasojat juridike që ato kanë sjellë në praktikën gjyqësore. Një ndër institutet e reja të parashikuara në kod në këtë periudhë është edhe seanca paraprake. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë në mënyrë të detajuar këtë institut procedural penal. Analiza nis me trajtimin ligjor të tij nga këndvështrimi teorik dhe vijon me pasqyrimin e zhvillimeve dhe problematikave që kanë dalë në praktikën gjyqësore, duke u referuar edhe në raste konkrete. Vëmendje e veçantë i kushtohet rolit të gjyqtarit në këtë fazë të procedimit, si dhe ndikimit të vendimmarrjeve të tij në trajtimin ligjor të çështjeve penale. Në këtë këndvështrim, kjo analizë juriidike synon të nënvizojë rëndësinë e seancës paraprake në zbardhjen e së vërtetës dhe garantimin e drejtësisë përmes vendimeve të drejta dhe të bazuara në ligj. Në përfundim, referimi i kësaj tematike, nëpërmjet gjetjeve apo konstatimeve, sjell rekomandime konkrete për përmirësimin e seancës paraprake, përmes amendimeve ligjore,

1. Dekan, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti "Luarasi" , admir.belishta@luarasi-univ.edu.al

2. Studente, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti "Luarasi", klea.biqiku@luarasi-univ.edu.al

praktikës gjyqësore të konsoliduar me vendime zhvillimore apo njehsuese të Gjykatës së Lartë, si dhe trajnimeve profesionale efikase. Kjo pasi vetëm nëse parashikohet saktë dhe zbatohet drejt, seanca paraprake do marrë rëndësinë e duhur si fazë e procedimit penal.

Fjalë kyçe: *Seanca paraprake, Gjyqtar, Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjykim, Praktikë gjyqësore, Kodi i Procedurës Penale.*

PRELIMINARY HEARING, SEEN FROM THE PERSPECTIVE OF INNOVATIONS AND PRACTICAL PROBLEMS

Abstract

The legal changes of 2017, as a result of the justice reform, have also affected the Criminal Procedure Code. Consequently, this code, in almost 2/3 of its content, has undergone legal amendments, which have been reflected in the form of additions, updates, or provisions of new procedural institutes. The latter have been seen as innovations not only for the sanctioning for the first time in this code, but also for the legal consequences that they have brought in judicial practice. One of the new institutes foreseen in this code is the preliminary hearing. The purpose of this paper is the detailed analysis of this criminal procedural institute, which begins with its theoretical legal treatment and continues with a reflection of the progress and problems arising in judicial practice, referring to concrete cases. Special attention is paid to the role of the judge in this phase of the criminal proceedings, as well as the impact of his decision-making on the legal treatment of criminal cases. In this perspective, this legal analysis aims to highlight the importance of the preliminary hearing in revealing the truth and guaranteeing justice through fair and legally based decisions. In conclusion, referring to this paper, through findings or observations, it brings concrete recommendations for improving the preliminary hearing, through legal amendments, consolidated judicial practice with developmental or unifying decisions of the Supreme Court, as well as efficient professional training. This is because only if it is correctly foreseen and effectively implemented, the preliminary court hearing will achieve the appropriate importance as a phase of criminal proceedings.

Keywords: Preliminary hearing, Judge, Request for sending the case to trial, Judicial practice, Criminal Procedure Code.

FINANCIAL CRIMES AND MONEY LAUNDERING IN KOSOVO LEGAL MECHANISMS FOR THEIR PREVENTION

Halim Bajraktari, Prof. Asoc. Dr¹
Dafina Abdullahu, PhD Candidate²

Abstract

Introduction: *New trends in the emergence of financial crimes and money laundering are also affecting Kosovo, a phenomenon that is increasing with the development of the rule of law on the one hand and on the other hand Kosovo has tightened its legislation, which has already been reviewed for the first time since the declaration of Independence, where there is still a high risk of tax evasion and money laundering.*

Purpose: *The study explores how financial crimes impact economic development and legal uncertainty. By explaining how, it highlights the risk of high levels of corruption, thus contributing to other areas of the justice system.*

Research design/methodology: *We have used analytical and statistical methods, finding the high-risk factors that influence the growth of these phenomena in Kosovo, the way in which this phenomenon appears, the role of the state in combating these phenomena, verifying how financial crimes and money laundering are spreading and have a negative impact on society.*

Findings: *In the financial market, recommendations have often been made regarding the rule of law; finding an approach for more*

1. Vice Dean at Faculty of Law, University “Ukshin Hoti” Prizren, Kosovo e-mail: halim.bajraktari@uni-prizren.com

2. Teaching assistant at Faculty of Economics, University “Ukshin Hoti” Prizren, Kosovo e-mail: dafina.abdullahu@uni-prizren.com

detailed control of these cases of manipulation strengthens and enhances the implementation of legal mechanisms in the country.

Keywords: *Financial crimes and money laundering, legal mechanisms, Kosovo..*

KRIMET FINANCIARE DHE PASTRIMI I PARAVE NË KOSOVË MEKANIZMAT LIGJORË PËR PARANDALIMIN E TYRE

Halim Bajraktari, Prof. Asoc. Dr¹
Dafina Abdullahu, kandidate në studimet doktorale²

Abstrakt

Hyrje: Trendet e reja të shfaqjes së krimeve financiare dhe pastrimit të parave po prekin edhe Kosovën, dukuri kjo që po rritet me zhvillimin e sundimit të ligjit në njërën anë dhe në anë tjetër Kosova ka shtrënguar legjislacionin e saj, i cili tashmë është rishikuar për herë të parë që nga shpallja e Pavarësisë, ku ende ekziston rreziku i lartë i evazionit fiskal dhe shpërdorimit të parave.

Qëllimi: Studimi eksploron se si krimet financiare ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe pasigurinë ligjore. Duke shpjeguar se si, ai nxjerr në pah rrezikun e niveleve të larta të korrupsionit, duke kontribuar kështu në fusha të tjera të sistemit të drejtësisë.

Dizajni/metodologjia e hulumtimit: Kemi përdorur metoda analitike dhe statistikore, duke gjetur faktorët me rrezikshmëri të lartë që ndikojnë në rritjen e këtyre dukurive në Kosovë, mënyrën se si shfaqet kjo dukuri, rolin e shtetit në luftimin e këtyre dukurive, verifikimin se si krimet financiare dhe pastrimi i parave po përhapen dhe kanë ndikim negativ në shoqëri.

Gjetjet: Në tregun financiar shpesh janë bërë rekomandime në

1. Prodekan në Fakultetin Juridik, Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, Kosovë
e-mail: halim.bajraktari@uni-prizren.com

2. Asistente mësimore në Fakultetin Ekonomik, Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, Kosovë
e-mail: dafina.abdullahu@uni-prizren.com

lidhje me sundimin e ligjit; gjetja e një qasjeje për kontroll më të detajuar të këtyre rasteve të manipulimit forcon dhe përmirëson zbatimin e mekanizmave ligjorë në vend.

Fjalët kyçe: *Krimet financiare dhe pastrimi i parave, mekanizmat ligjor, Kosovë.*

TRAJTIMI I VIKTIMAVE NË ÇËSHTJET PENALE QË LIDHEN ME TRAFIKIMIN E PERSONAVE TË RRITUR/MITUR: MIDIS STANDARDEVE LIGJORE DHE REALITETIT GJYQËSOR.

PhD (c) Manjola Kajana¹

Abstrakt

Në kontekstin e krimit të organizuar dhe veprave penale me rrezikshmëri të lartë si trafikimi i personave të rritur/mitur, mbrojtja e viktimave përbën një nga sfidat kryesore të drejtësisë penale shqiptare. Ndaj dhe në këtë punim autori do të ndalet në mënyrën sesi praktika gjyqësore shqiptare ka adresuar të drejtat dhe nevojat e viktimave në çështje të tilla, duke u fokusuar në rolin e prokurorit, efektivitetin e masave ndëshkimore dhe mekanizmat e parandalimit. Nëpërmjet analizës së disa rasteve konkrete dhe legjislacionit penal në fuqi, artikulli synon që të vëre në dukje se pavarësisht progresit të dukshëm, sfida të tilla si mbledhja e provave, bashkëpunimi i viktimave dhe siguria e tyre personale kërkojnë përmirësime të mëtejshme institucionale dhe bashkëpunim më të thellë ndërinstitutional dhe ndërkombëtar.

Fjalët kyçe: Trafikimi i personave, Viktima, Drejtësia penale, Mbrojtja e viktimave

1. Prokurore, Prokuroria e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK), manjolakajana@gmail.com

TREATMENT OF VICTIMS IN CRIMINAL CASES RELATED TO TRAFFICKING IN ADULTS/MINORS: BETWEEN LEGAL STANDARDS AND JUDICIAL REALITY

PhD (c) Manjola Kajana¹

Abstract

In the context of organized crime and high-risk criminal offenses such as the trafficking of adults and minors, the protection of victims remains one of the main challenges of the Albanian criminal justice system. This paper examines how the Albanian judicial practice has addressed the rights and needs of victims in such cases, focusing on the role of the prosecutor, the effectiveness of punitive measures, and prevention mechanisms. Through the analysis of specific cases and the current criminal legislation, the article aims to highlight that, despite notable progress, challenges such as evidence collection, victim cooperation, and their personal safety continue to require further institutional improvements and deeper inter-institutional and international cooperation.

Key words: *Human trafficking, Victim, Criminal justice, Victim protection*

1. Prosecutor, Special Prosecution Office Against Corruption and Organized Crime (SPAK), manjolakajana@gmail.com

GARANCITË PROCEDURALE NË KAPJEN DHE SEKUESTRIMIN E TË DHËNAVE KOMJUTERIKE TË APARATIT CELULAR

Ylli Pjetërnikaj¹

Enisa Shahini²

Abstrakt

Krimi kibernetik dhe provat elektronike paraqesin sfida të rëndësishme për sistemet e drejtësisë penale dhe sundimin e ligjit në të gjitha shtetet. Hetimi i krimit kibernetik dhe i provave elektronike kërkon njohuri dhe aftësi specifike, mjete teknike dhe korniza adekuate legjislative, si dhe bashkëpunim ndërkombëtar efektiv dhe efikas me aktorë të huaj të drejtësisë penale dhe subjekte private. Shtetet janë përshtatur me këto zhvillime duke ndryshuar ligjet e tyre, duke ndërtuar kapacitetet e tyre teknike dhe duke futur kompetenca të reja hetimore procedurale. Të gjitha këto masa dhe mjete duhet të zhvillohen dhe vendosen në përputhje me përgjegjësitë e shteteve sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Ashtu si me çdo hetim tjetër penal, hetimet e krimit kibernetik dhe përdorimi i kompetencave të veçanta procedurale prekin të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në instrumentet ndërkombëtare në nivel global dhe rajonal. Këto përfshijnë Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (UDHR), Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Në këtë optike edhe qasja në të dhënat e përfshira në një telefon celular, siç është intuitive, përbën një ndërhyrje serioze në të drejtat

1. Grada shkencore-Doktor, pedagog i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës; Email: Ylli.Pjeternikaj@pp.gov.al

2.Doktoraturë në process, Gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, email: enishahini@gmail.com

themelore të subjektit të të dhënave. Të dhëna të tilla, përgjithësisht, përfshijnë mesazhe, fotografi, video, histori të shfletimit në ueb, kërkime në aplikacione të tilla si Maps, duke lejuar që të nxirren përfundime shumë të sakta për jetën private të personit.

Për më tepër, shumë nga të dhënat e përfshira në një telefon celular, si imazhet ose adresa IP, lejojnë identifikimin e personit, ose bashkëbiseduesve të tyre, ose mund të përkufizohen si “të ndjeshme”, domethënë, ato janë në gjendje të zbulojnë origjinën racore ose etnike të palës së interesuar, bindjet e tyre fetare ose filozofike, opinionet e tyre politike, të dhëna të tilla shëndetësore, anëtarësimin në sindikatë, etj.

Në pritje të miratimit të rregullave të reja procedurale lidhur me sekuestrimin e aparatëve celular, në këtë punim do të fokusohemi në standartet e vendosura nga jurisprudence e vendit tonë, e vendeve të tjera dhe ajo ndërkombëtare si garanci për sekuestrimin e një pajisjeje të tillë.

Fjalë kyçe: sekuestrim, hetim, të dhëna kompjuterike, prove elektronike, krim kibernetik

PROCEDURAL GUARANTEES IN THE SEIZURE AND SEQUESTRATION OF COMPUTER DATA FROM CELLULAR DEVICES

Ylli Pjetërnikaj¹

Enisa Shahini²

Abstract

Cyber-crime and electronic evidence pose significant challenges for criminal justice systems and the rule of law in all states. Investigating cyber-crime and electronic evidence requires specific knowledge and skills, technical tools, and adequate legislative frameworks, as well as effective and efficient international cooperation with foreign criminal justice actors and private entities. States have adapted to these developments by changing their laws, by building their technical capacities, and by introducing new investigative procedural competencies. All these measures and tools must be developed and implemented in accordance with the responsibilities of states under the international human rights law.

Just like with any other criminal investigation, the investigations of cyber-crime and the use of specific procedural powers affect the rights and freedoms of individuals as defined in the international instruments at both global and regional levels. These include the Universal Declaration of Human Rights (UDHR), the International Covenant on Civil and Political Rights (ICCPR), and the European Convention on Human Rights (ECHR).

In this context, access to the data contained in a mobile phone, as

1. Scientific Degree: PhD; Lecturer at the School of Magistrates of Albania; Email: Ylli.Pjeternikaj@pp.gov.al

2. Scientific Degree: PhD in process; Judge at the Administrative Court of the First Instance Court of Tirana;
Email: enishahini@gmail.com

is intuitive, constitutes a serious interference with the fundamental rights of the data subject. Such data generally include messages, photographs, videos, web browsing history, searches in applications like Maps, allowing for very accurate conclusions to be drawn about a person's private life.

Furthermore, many of the data included in a mobile phone, such as images or IP addresses, allow for the identification of the person, or their interlocutors, or can be defined as "sensitive," meaning they are capable of revealing the racial or ethnic origin of the interested party, their religious or philosophical beliefs, their political opinions, such health data, union membership, etc.

Awaiting the approval of the new procedural rules regarding the seizure of mobile devices, this paper will focus on the standards established by the jurisprudence of our country, other countries, and international law, as safeguards for the seizure of such a device.

Keywords: *seizure, investigation, computer data, electronic evidence, cyber-crime.*

ASPEKTET HISTORIKE DHE PENALE TË VETËGJYQËSISË NË SHQIPËRI

Prof. Asoc. Engjëll Likmeta¹

PhD (c) Klei Kaçupi²

Abstrakt

Në të drejtën zakonore shqiptare, e cila përfaqëson një sistem kompleks normash tradicionale, mbrojtja e viktimave zinte një vend qendror në mekanizmat e drejtësisë popullore. Nëpërmjet Kanunit, sovrani i vërtetë – populli, me urtësinë dhe përvojën e tij të trashëguar brez pas brezi – kishte përcaktuar rrugët themelore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve: marrëveshjen mes palëve, ndërmjetësimin dhe gjykimin. Këto forma shërbenin jo vetëm për të ruajtur rendin dhe harmoninë shoqërore, por edhe për të garantuar drejtësi për viktimat.

Një nga shtyllat kryesore të sistemit kanunor ishte parimi i rivendosjes së të drejtës së të dëmtuarit përmes dënimeve të qarta dhe të përcaktuara në mënyrë proporcionale. Këto masa ndëshkuese synonin jo hakmarrjen, por kompensimin dhe rikthimin e ekuilibrit në komunitet. Ky punim synon pikërisht të shqyrtojë aspektet historike dhe juridike të mbrojtjes së viktimave në të drejtën zakonore shqiptare, duke analizuar rolin e dënimeve kanunore si mjete për garantimin e drejtësisë dhe për parandalimin e vetëgjyqësisë – një dukuri që ende mbart jehonën e së shkuarës në realitetin shqiptar bashkëkohor.

Fjalët kyçe: Vetëgjyqësi, Kanun, E drejtë zakonore.

1. Pedagog, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, engjell.likmeta@fdut.edu.al

2. Doktorant, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, kacupikle@gmail.com

HISTORICAL AND CRIMINAL ASPECTS OF VIGILANTISM IN ALBANIA

Assoc. Prof. Engjëll Likmeta¹

PhD (c) Klei Kaçupi²

Abstract

In Albanian customary law, a complex system of traditional norms, the protection of victims held a central place within the mechanisms of popular justice. Through the Kanun, the true sovereign—the people, guided by their inherited wisdom and experience—had established fundamental pathways for resolving disputes: agreement between parties, mediation, and adjudication. These mechanisms not only served to preserve social order and harmony but also ensured justice for victims. One of the main pillars of the Kanun system was the principle of restoring the rights of the injured party through clearly defined and proportionate punishments. These punitive measures were aimed not at revenge, but at compensation and the restoration of balance within the community. This paper aims to examine the historical and legal aspects of victim protection in Albanian customary law, analyzing the role of Kanun-based punishments as tools for ensuring justice and preventing vigilantism—a phenomenon that still echoes from the past into modern Albanian society.

Keywords: Vigilantism, Kanun, Customary Law.

1. Lecturer, Department of Criminal Law, Faculty of Law, University of Tirana, engjell.likmeta@fdut.edu.al

2. PhD Candidate, Department of Criminal Law, Faculty of Law, University of Tirana, kacupikle@gmail.com

PËRGJIMI SI MJET I KËRKIMIT TË PROVËS DHE RREGJISTRIMET PRIVATE

Dr.Eliona ELEZI¹

Dr.Ardian ELEZI²

Abstrakt

Përgjimet si mjet i kërkimit të provës ashtu dhe regjistrimet private janë teknika invasive dhe paraqesin ndjeshmëri në aspektin e të drejtës private të individëve si dhe sjellin rreziqe të mëdha për shkëlqimin e të drejtave themelore të njeriut. Zbatimi korrekt në përputhje me ligjin procedural penal dhe kushtet e autorizimit që ky lloj i fundit përcakton lejon përdorimin e tyre në interes të dhënave të mbledhura në kuadër të një procedimi penal të filluar. Ndërsa qasja e përdorimit masiv të regjistrimeve private nga cdo kush si dhe media në përgjithësi pavarësisht balancencës që gëzon e drejta për informim kërkon doosdoshmërinë e mënyrës së kryerjes së tyre si dhe vendeve ku lejohen. Ky fenomen i pasuar me pas me shpërndarjen e informacionit të paautorizuar dhe manipulimin e situatave të caktuara mund të sjell pasoja të parikuperueshme.

Rregullat dhe kuadri ligjor që rregullojnë përgjimet dhe regjistrimet private janë të ndryshme nga vendi në vend, por shumica e sistemeve juridike theksojnë një ekuilibër të ndjeshëm ndërmjet sigurisë publike dhe ruajtjes së privatësisë personale. Në shumë shtete, ligjet që lidhen me përgjimet dhe regjistrimet private janë të detajuara dhe kërkojnë një autorizim të veçantë nga gjykatat për të kryer këto aktivitete. Megjithatë, përdorimi i panevojshëm i këtij instrumenti mund të çojë në keqpërdorime dhe rrezik të papërgjegjshëm për individët dhe shoqërinë.

1.Magjistrate -Prokurore pranë Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë , Pedagoge e jashtme pranë Shkollës së Magjistraturës dhe Fakultetit të Drejtësisë Tiranë, elioralezi@yahoo.com

2. Pedagog pranë Universitetit “ Luarasi “ Tiranë. ardael2004@yahoo.com

Ky abstrakt shqyrton aspektet ligjore, etike dhe teknologjike të përgjimeve dhe regjistrimeve private, duke analizuar gjithashtu sfidat që dalin në përputhje me zhvillimet e shpejta teknologjike dhe ndikimin e tyre në jetën private të individëve.

Fjalët kyce: përgjim , rregjistrim privat, provë, e drejta e informimit. papërdorshmëri prove.

SURVEILLANCE AND PRIVATE RECORDINGS

Dr.Eliona ELEZI¹

Dr.Ardian ELEZI²

Abstract

Surveillance as a Means of Evidence Collection and the Sensitivity of Private Recordings: Legal, Ethical, and Technological Considerations. Wiretapping as a method of evidence collection, as well as private recordings, are invasive techniques that raise significant concerns regarding individuals' right to privacy and pose serious risks to the violation of fundamental human rights. Their proper application, in accordance with criminal procedural law and the authorization conditions stipulated by it, permits their use in the interest of evidence gathered within the framework of an initiated criminal proceeding.

However, the widespread use of private recordings by individuals or the media—regardless of the balance between the right to information and the right to privacy—demands clear regulation concerning the manner in which such recordings are conducted and the locations where they are allowed. This phenomenon, often followed by the unauthorized dissemination of information and the manipulation of specific situations, may lead to irreversible consequences.

The rules and legal frameworks governing surveillance and private recordings vary across countries. Nonetheless, most legal systems emphasize a delicate balance between public safety and the preservation of personal privacy. In many jurisdictions, laws pertaining to surveillance and private recordings are detailed and require specific judicial authorization to carry out such activities.

1. Magistrate - Prosecutor at the Prosecutor's Office of the General Jurisdiction in Tirana, External Lecturer at the School of Magistrate and the Faculty of Law in Tirana. elioralezi@yahoo.com

2. Lecturer at “Luarasi” University, Tirana. ardael2004@yahoo.com

Nevertheless, the unnecessary or excessive use of these instruments can result in misuse and pose irresponsible risks to both individuals and society at large.

This abstract explores the legal, ethical, and technological aspects of surveillance and private recordings, while also analyzing the challenges posed by rapid technological advancements and their impact on individuals' private lives.

Keywords: *surveillance, private recording, evidence, right to information, inadmissibility of evidence*

TERRORIZMI DHE EKSTREMIZMI I DHUNSHËM: MASAT LIGJORE DHE EFEKTIVITETI I TYRE

Dr. Blendi Himçi¹

Regis Topurja²

Orjona Shermadhi³

Xhoana Agolli⁴

Abstrakt

Terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm janë kërcënime serioze për rendin shoqëror në sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare në mbarë botën, përfshirë dhe Shqipërinë. Ky studim analizon masat ligjore të ndërmarra nga shtetet dhe organizatat ndërkombëtare për të parandaluar aktet terroriste dhe për të mbrojtur qytetarët nga kërcënimet, sulmet ndaj integritetit fizik të personit, rrëmbimit, shkatërrimit masiv të objekteve qoftë private apo publike nëpërmjet terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Rëndësi e veçantë në këtë studim i kushtohet analizës ligjore dhe strategjive që përdorin shtetet më të përparuara, si SHBA, Mbretëria e Bashkuar, dhe Franca, duke i krahasuar këto me vendet me resurse më të kufizuara. SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar janë pionierë në përdorimin e inteligjencës dhe teknologjisë për të luftuar terrorizmin, përfshirë ndjekjen dhe ndërprerjen e rrjeteve të financimit terrorist, ndërsa Franca ka zhvilluar një qasje të fuqishme të reagimit dhe parandalimit, përfshirë masa të rrepta ligjore dhe siguri të përforcuar në qytetet më të prekura. Gjithashtu, Komiteti Evropian kundër Terrorizmit,

1. Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë, blendih@yahoo.com

2. Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë regis.topurja@uniel.edu.al

3. Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë, orjonashermadhi@gmail.com

4. Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë agollixhoana75@gmail.com

ka luajtur një rol kyç në zhvillimin e standardeve dhe mekanizmave të koordinuar për të luftuar terrorizmin në Evropë, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mbështetur shtetet anëtare në përpjekjet e tyre. Duke përdorur metodat kërkimore empirike të hulumtimit dhe krahasimit, punimi mundohet të vlerësojë efektivitetin e masave ligjore duke krahasuar shifrat e suksesit në uljen e akteve terroriste dhe aktiviteteve ekstremiste të dhunshme në shtetet më të zhvilluara dhe ato në zhvillim. Punimi gjithashtu sugjeron që në vendin tonë të ndërtohet një infrastrukturë e fortë ligjore dhe mekanizma të avancuar të bashkëpunimit ndërkombëtar, që të përballemi me sfida më të mëdha në zbatimin e këtyre masave.

Fjalë kyçe: terrorizëm, ekstremizëm, dhunë, teknologji, masa ligjore, parandalim, strategji, Komiteti Evropian.

TERRORISM AND VIOLENT EXTREMISM: LEGAL MEASURES AND THEIR EFFECTIVENESS

Dr. Blendi Himçi¹

Regis Topurja²

Orjona Shermadhi³

Xhoana Agolli⁴

Abstract

Terrorism and violent extremism are serious threats to social order and national and international security worldwide, including Albania. This study analyzes the legal measures taken by states and international organizations to prevent terrorist acts and protect citizens from threats, attacks on the physical integrity of the person, kidnapping, and the massive destruction of objects, whether private or public, through terrorism and violent extremism. Particular emphasis is placed on the legal analysis and strategies used by the most advanced countries, such as the USA, the UK, and France, in comparison with countries with more limited resources. The USA and the UK are pioneers in the use of intelligence and technology to combat terrorism, including tracking and disrupting terrorist financing networks, while France has developed a robust response and prevention approach, including strict legal measures and reinforced security in the most affected cities. The European Counter-Terrorism Committee has also played a key role in developing standards and coordinated mechanisms to combat terrorism in Europe,

1. University “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Faculty of Business and Justice, blendih@yahoo.com

2. University “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Faculty of Business and Justice, regis.topurja@uniel.edu.al

3. University “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Faculty of Business and Justice, orjonashermadhi@gmail.com

4. University “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Faculty of Business and Justice, agollixhoana75@gmail.com

strengthening international cooperation and supporting member states in their efforts. Using empirical research methods of research and comparison, the paper attempts to assess the effectiveness of legal measures by comparing success rates in reducing terrorist acts and violent extremist activities in more developed and developing countries. The paper also suggests that a strong legal infrastructure and advanced mechanisms of international cooperation be built in our country, so that we can face greater challenges in implementing these measures.

Keywords: *terrorism, extremism, violence, technology, legal measures, prevention, strategy, European Committee.*

TË DREJTAT E VIKTIMËS NË PROCESIN PENAL: VËSHTRIM KRAHASUES I LEGJISLACIONIT SHQIPËTAR DHE ATIJ NDËRKOMBËTAR

Dr. Ermira Tafani¹

Rexhina Debrova²

Rosela Bali³

Abstrakt

Të drejtat e viktimës janë një komponent kyç i të drejtave të njeriut, veçanërisht i sistemit të drejtësisë penale, duke garantuar trajtimin e drejtë, mbrojtjen dhe mbështetjen e individëve që kanë pësuar dëme si pasojë e një vepre penale. Në Shqipëri të drejtat e viktimës patën një përmirësim të ndjeshëm me ndryshimet e reformës në drejtësi të vitit 2017. Ky studim ka për qëllim të analizojë të drejtat e viktimës në procesin penal, duke krahasuar kornizën ligjore kombëtare me atë ndërkombëtare. Nga një studim i thelluar i legjislacionit penal shqipëtar dhe atij ndërkombëtar, nëpërmjet metodës kërkimore krahasuese, do të synohet t'i jepet përgjigje pyetjes: Sa efektive është mbrojtja e viktimave në procesin penal në Shqipëri dhe a ka vend për përmirësime? Krahasimi i praktikave ndërkombëtare në mbrojtjen e viktimave shërben si bazë për të identifikuar modelet më të mira dhe për të propozuar përmirësime në legjislacionin kombëtar. Në përfundim, studimi thekson nevojën për përmirësimin e mekanizmave ligjorë dhe institucionalë në mbrojtjen e viktimave në procesin penal në Shqipëri, si dhe propozon disa rekomandime modeste për përmirësimin e Kodit të Procedurës Penale.

Fjalët kyçe: të drejtat e viktimës, Kodi i Procedurës Penale, mbrojtja e viktimave, proces penal, akte ndërkombëtare.

1. Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë, miratafani@yahoo.com

2. Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë, rexinadebrova13@gmail.com

3. Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë, roseabali42@gmail.com

VICTIM'S RIGHTS IN THE CRIMINAL PROCESS: A COMPARATIVE OVERVIEW OF ALBANIAN AND INTERNATIONAL LEGISLATION

Dr. Ermira Tafani¹

Rexhina Debrova²

Rosela Bali³

Abstract

By examining the factors that contribute to recidivism and the approach adopted in other jurisdictions to address it, this article aims to shed light on the necessity of integrating recidivism into our Criminal Code. Furthermore, the article proposes possible strategies for policymakers and legislators to effectively address recidivism, within the framework of the existing Criminal Code.

Keywords: *criminology, recidivist, recidivism, criminal justice system, rehabilitation, social-psychological policy, Criminal Code of Albania, penal reform, policy implementation.*

1. email: ejorgaqi@gmail.com

KRIMET TRANSNACIONALE DOGANORE DHE KONTROLLI I EKSPORTEVE PËR MATERIALET ME PËRDORIM TË DYFISHTË: SFIDA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE NË KUADRIN E SIGURISË NDËRKOMBËTARE

Admir ABRIJA¹,

Abstrakt

Në epokën e teknologjive në zhvillim të shpejtë dhe të tregtisë globale të ndërlidhur, eksporti i paligjshëm i materialeve me përdorim të dyfishtë, mallra dhe teknologji që mund të përdoren si për qëllime civile, ashtu edhe ushtarake, tashmë është shndërruar në një dimension kyç të krimit doganor transnacional. Ky punim analizon sfidat ligjore, institucionale dhe operacionale që paraqesin këto veprimtari kriminale, me fokus të veçantë në tensionin ndërmjet sistemeve kombëtare doganore dhe regjimeve ndërkombëtare të kontrollit të eksporteve. Duke u mbështetur në instrumente juridike ndërkombëtare, përfshirë Rregulloren (BE) 2021/821 dhe Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, studimi shqyrton mënyrën se si këto kuadro funksionojnë për të parandaluar përhapjen e materialeve me përdorim të dyfishtë. Kërkimi mbështetet gjithashtu në përvojën praktike të autorit në fushën e zbatimit të ligjit në sistemin doganor, si dhe në trajnimet profesionale të kryera në Shtetet e Bashkuara, Francë, Itali etj., duke sjellë analiza konkrete mbi dobësitë në inspektimet doganore, menaxhimin e rrezikut dhe bashkëpunimin

1. **AdmirABRIJA: kandidat për doktoraturë**, në vitin e dytë në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Ai prej më shumë se një viti mban detyrën e CEO I “Tirana Development Corporation” sh.a, shoqëri me kapital 100% shtetëror. Z. Abrija ka një eksperiencë të gjatë në administratën publike prej më shumë se 25 vitesh. Ai ka shërbyer në funksione të ndryshme në strukturat e Ministrisë së Brëndshme, Ministrisë së Financave, Prefekt I Tiranës, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Bashkisë Tiranë etj.

ndërinstitucional. Punimi argumenton se mekanizmat aktualë të zbatimit mbeten të fragmentuar dhe shpesh të pajisur dobët, veçanërisht në vendet në zhvillim ose në tranzicion. Autori e përfundon punimin e tijë me propozime për reforma politike dhe ligjore që mund të forcojnë bashkëpunimin transnacional dhe të rrisin rolin e autoriteteve doganore në zbulimin dhe ndjekjen penale të këtyre krimeve komplekse, të cilat përbëjnë një kërcënim serioz për sigurinë ndërkombëtare dhe atë kombëtare.

Fjalë kyçe: krimi transnacional, materiale me përdorim të dyfishtë, kontrolli i eksporteve, e drejta doganore, bashkëpunimi ndërkombëtar, ndjekja penale, siguria kombëtare.

TRANSNATIONAL CUSTOMS CRIMES AND EXPORT CONTROL OF DUAL-USE GOODS LEGAL AND INSTITUTIONAL CHALLENGES IN THE FRAMEWORK OF INTERNATIONAL SECURITY

Admir ABRIJA¹,

Abstract

In an era of rapidly developing technologies and interconnected global trade, the illicit export of dual-use materials goods and technologies that can be used for both civilian and military purposes, has become a key dimension of transnational customs crime. This paper analyzes the legal, institutional, and operational challenges posed by such criminal activities, with a particular focus on the tension between national customs systems and international export control regimes. Based on international legal instruments, including EU Regulation (EU) 2021/821 and the United Nations Security Council Resolutions, the study examines how these frameworks function to prevent the spread of sensitive materials.

The research is further supported by the author's practical experience in law enforcement within the customs system, as well as by professional training undertaken in the United States, France, Italy, and other countries. These insights allow for concrete analyses of weaknesses in customs inspections, risk management, and inter-institutional cooperation. The paper argues that current enforcement mechanisms remain fragmented and often under

1. Admir ABRIJA is a second-year PhD candidate at the Faculty of Law, University of Tirana. For over a year, he has served as the CEO of “Tirana Development Corporation” sh.a., a company with 100% public ownership. Mr. Abrija has over 25 years of experience in public administration. He has held various positions within the Ministry of the Interior, the Ministry of Finance, as Prefect of Tirana, the Ministry of Infrastructure and Energy, the Ministry of Justice, and the Municipality of Tirana, among others

resourced, particularly in developing or transitional countries. The study concludes with proposals for political and legal reforms aimed at strengthening transnational cooperation and enhancing the role of customs authorities in detecting and prosecuting these complex crimes, which pose a serious threat to both international security and national sovereignty.

Keywords: transnational crime, dual-use materials, export control, customs law, international cooperation, criminal prosecution, national security.

SFIDA E TË DREJTËS PENALE PËR GARANTIMIN E NJË MJEDISI DIGJITAL TË SIGURTË

Kandidate Msc. Gloria Lleshanaku¹

Dr. Ermira Tafani²

Abstrakt

Në epokën e transformimeve digjitale, krimet kibernetike përbëjnë një rrezik serioz për sigurinë individuale, institucionale dhe kombëtare. Kriminaliteti në hapësirën virtuale po avancon në foma gjithnjë e më të sofistikatuara, duke kërcënuar jo vetëm individët dhe bizneset, por edhe sigurinë kombëtare dhe ekonominë globale.

Në këtë kontekst, ky punim synon të analizojë tipologjinë e krimeve kibernetike, ndikimin e tyre në sigurinë digjitale dhe sfidat ligjore që hasin shtetet në përballjen me këto kërcënime. Të shumta janë rastet e sulmeve ndaj sistemeve kibernetike, vjedhjeve të të dhënave, mashtrimeve financiare apo forma të tjera të paligjshme të ushtrimit të aktiviteteve, përmes hapësirës virtuale. Nisur nga kjo situatë, studimi përmes analizave ligjore dhe krahasimeve me praktikat ndërkombëtare, thekson rëndësinë e një kornize të fortë juridike dhe teknike për garantimin e një mjedisi digjital më të sigurtë. Duke përdorur metodat kërkimore empirike dhe krahasuese studimi nxjerr në pah rëndësinë e ndërtimit të standardeve teknike dhe juridike në garantim të ofrimit të një sigurie digjitale në nivel sa më të lartë. Si përfundim studimi arrin në disa konkluzione se pavarësisht se Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë parashikon masa dhe sanksione

1. Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë, lleshanakugloria@gmail.com

2. Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Fakulteti i Biznesit dhe i Drejtësisë, miratafani@yahoo.com

për kryerjen e veprave të tilla, si krimi kibernetik, siguria digjitale, etj, zhvillimi i teknologjisë më hapa galopante, kërkon një qasje të përditësuar dhe harmonizim sa më të mirë mes mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, dhe zhvillimit të teknologjisë.

Fjalë kyce: Krim kibernetik; Siguri digjitale; Hapësirë digjitale; Përgjegjësi penale.

THE CHALLENGE OF CRIMINAL LAW TO ENSURE A SAFE DIGITAL ENVIRONMENT

Msc. Candidate Gloria Lleshanaku¹

Ph.D Ermira Tafani²

Abstract

In the era of digital transformation, cybercrime poses a serious threat to individual, institutional and national security. Cybercrime is advancing in increasingly sophisticated forms, threatening not only individuals and businesses but also national

security and the global economy. In this context, this paper aims to analyze the typology of cybercrimes, their impact on digital security and the legal challenges that states face in dealing with them. All cases of attacks on cyber systems, theft of data, other information or other illegal forms of exercising activities, in some virtual areas. Starting from this behavior, the study through legal analysis and comparison with external practices, emphasizes the importance of a strong legal and technical framework to guarantee a safer digital environment. Using empirical and comparative research methods, the study highlights the importance of building technical and legal standards to guarantee the provision of digital security at the highest possible level. In conclusion, the study reaches several conclusions that despite the fact that the Criminal Code of the Republic of Albania provides for measures and sanctions for the commission of such offenses as cybercrime, digital security, etc., the rapid development of technology requires an updated approach and the best possible harmonization between national and international legal mechanisms and the development of technology.

Keywords: *cybercrime, digital security, digital space, criminal liability.*

1. University “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Faculty of Business and Justice, lleshanakugloria@gmail.com

2. University “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, Faculty of Business and Justice, miratafani@yahoo.com

FËMIJËT USHTARË NË TË DREJTËN PENALE NDËRKOMBËTARE - KONTEKSTI HISTORIK DHE NEVOJA PËR BASHKËPUNIM GLOBAL

Irena Staka¹

ABSTRAKT

Ky punim trajton çështjen e fëmijëve ushtarë në kuadrin e të drejtës ndërkombëtare penale, duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të tyre si një kategori veçanërisht e cenueshme. Fillimisht, punimi ofron një qasje historike dhe ligjore mbi konceptin e fëmijëve ushtarë, duke analizuar aktet ndërkombëtare që synojnë eliminimin e kësaj praktike dhe garantimin e të drejtave themelore të të miturve të prekur nga konfliktet e armatosura.

Në vijim, trajtohet Statuti i Romës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GJPN), si instrumenti më i rëndësishëm bashkëkohor që përcakton dhe ndëshkon rekrutimin, përdorimin apo angazhimin e fëmijëve në veprime luftarake si krim lufte. Një pjesë kyçe e punimit fokusohet në çështjen “Lubanga”, si rasti i parë i ndjekur penalisht në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për rekrutim dhe shfrytëzim të fëmijëve ushtarë. Studimi vlerëson rëndësinë e këtij precedenti në nxitjen e përgjegjësisë individuale për krimet kundër fëmijëve dhe në vendosjen e një standardi më të lartë ligjor e moral për të drejtat e tyre.

Së fundi, analizohen në mënyrë gjithëpërfshirëse sfidat praktike dhe juridike për parandalimin dhe ndëshkimin e kësaj vepre, duke u përqendruar në rolin e shteteve, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile. Punimi ka për synim të theksojë nevojën e bashkëpunimit ndërkombëtar të zgjeruar në nivel ligjor dhe politik, në mënyrë që të garantohet mbrojtja efektive e fëmijëve dhe të

1. PhD (c)., Koordinator, Sektori i së Drejtës Penale, Drejtoria e së Drejtës Penale dhe Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit, Ministria e Drejtësisë, irenastaka1@gmail.com.

forcohen mekanizmat për parandalimin e çdo forme keqpërdorimi të tyre në konfliktet e armatosura. Njëkohësisht, theksohet nevoja për përfshirjen e ekspertëve të fushës në procesin e hartimit të politikave, me qëllim garantimin e një kuadri sa më të plotë mbrojtës për të miturit e përfshirë në situata konfliktuale.

Fjalë kyçe: fëmijë ushtarë, Statuti i Romës, Gjykata Ndërkombëtare Penale, krime lufte, **bashkëpunim ndërkombëtar**, mekanizma mbrojtës.

CHILD SOLDIERS IN INTERNATIONAL CRIMINAL LAW – THE HISTORICAL CONTEXT AND THE NEED FOR GLOBAL COOPERATION

Irena Staka¹

ABSTRACT

This paper addresses the issue of child soldiers within the framework of international criminal law, highlighting the importance of protecting their rights as a particularly vulnerable group. It begins by offering a historical and legal perspective on the concept of child soldiers, examining international instruments aimed at eradicating this practice and ensuring the fundamental rights of minors affected by armed conflicts.

It then discusses the Rome Statute of the International Criminal Court (ICC) as the most significant contemporary instrument that defines and penalizes the recruitment, use, or involvement of children in combat operations as a war crime. A key section of the paper focuses on the “Lubanga” case, the first case prosecuted before the ICC for the recruitment and exploitation of child soldiers. The study assesses the importance of this precedent in promoting individual accountability for crimes against children and setting a higher legal and moral standard for their protection.

Lastly, it provides a comprehensive analysis of the practical and legal challenges to preventing and punishing this offense, focusing on the roles of states, international organizations, and civil society. The paper aims to underscore the need for expanded international cooperation at the legal and political levels, to ensure effective protection of children and to strengthen mechanisms for preventing

1. PhD (c), Coordinator, Criminal Law Sector, Criminal and Civil Law Directorate, General Directorate of Codification and Harmonization of Law, Ministry of Justice, irenastaka1@gmail.com.

any form of their exploitation in armed conflicts. At the same time, it emphasizes the necessity of involving experts in the policy-making process, in order to establish the most complete protective framework for minors involved in conflict situations.

Keywords: *child soldiers, Rome Statute, International Criminal Court, war crimes, international cooperation, protective mechanisms.*

PËRBALLJA E SISTEMIT GJYQËSOR ME KRIMET FINANCIARE KOMPLEKSE: SFIDAT E ZBULIMIT, HETIMIT DHE GJYKIMIT TË SKEMAVE TË SOFISTIKUARA TË PASTRIMIT TË PARAVE

Renis Sheshi. ¹

Kevin Treska. ²

Abstrakt

Ky artikull analizon sfidat që hasin institucionet ligjzbatuese dhe gjyqësore në përballjen me krimet financiare komplekse, veçanërisht me pastrimin e parave. Në epokën e globalizimit financiar dhe transformimit digjital, skemat e pastrimit të parave kanë evoluar drejt formave gjithnjë e më të sofistikuara, duke krijuar pengesa të konsiderueshme për autoritetet përgjegjëse në nivel global.

Studimi fokusohet fillimisht në analizën e praktikave dhe strategjive ndërkombëtare në luftën kundër pastrimit të parave, me theks të veçantë në vendet me sisteme të avancuara. Nëpërmjet shqyrtimit të qasjeve institucionale, metodave hetuese, dhe teknikave procedurale të përdorura në juridiksione të ndryshme, artikulli identifikon praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare në këtë fushë.

Më pas, artikulli vlerëson kuadrin ligjor dhe institucional në Shqipëri, duke evidentuar sfidat specifike dhe hendekun midis sistemit aktual dhe praktikave më të mira ndërkombëtare. Analiza identifikon vështirësitë kryesore në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e çështjeve të pastrimit të parave në kontekstin shqiptar.

1. Magjistrat, Gjyqtar, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Email: renisheshi@yahoo.com

2. Master Ekzekutiv, Përgjegjës i Sektorit të Marrëveshjeve Ndërkombëtare, Ministria e Financave. E-mail: Kevin.Treska@financa.gov.al

Në përfundim, bazuar në mësimet e nxjerra nga përvojat ndërkombëtare, artikulli paraqet rekomandime specifike për përshtatjen e praktikave të suksesshme në realitetin shqiptar. Këto rekomandime fokusohen në përmirësimin e kuadrit ligjor, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për një përballje më efektive me krimet financiare komplekse.

Fjalët kyçe: pastrim parash, praktika ndërkombëtare, kuadër ligjor, institucionet ligjzbatuese, bashkëpunim ndërkombëtar, krim financiar, reforma ligjore, Shqipëri.

THE JUDICIARY'S CONFRONTATION WITH COMPLEX FINANCIAL CRIMES: CHALLENGES IN DETECTING, INVESTIGATING, AND ADJUDICATING SOPHISTICATED MONEY LAUNDERING SCHEMES

Renis Sheshi.¹

Kevin Treska.²

Abstract

This article analyzes the challenges faced by law enforcement and judicial institutions in confronting complex financial crimes, particularly money laundering. In the era of financial globalization and digital transformation, money laundering schemes have evolved into increasingly sophisticated forms, creating significant obstacles for responsible authorities at a global level.

The study initially focuses on analyzing international practices and strategies in combating money laundering, with special emphasis on countries with advanced systems. Through examining institutional approaches, investigative methods, and procedural techniques used in various jurisdictions, the article identifies best practices and international standards in this field.

Subsequently, the article assesses the legal and institutional framework in Albania, highlighting specific challenges and the gap between the current system and international best practices. The analysis identifies key difficulties in investigating, prosecuting, and adjudicating money laundering cases in the Albanian context.

1. Magistrate, Judge, Lezha Court of First Instance of General Jurisdiction. Email: renissheshi@yahoo.com

2. Executive Masters, Head of the International Agreements Sector, Ministry of Finance. E-mail: Kevin.Treska@financa.gov.al

In conclusion, based on lessons learned from international experiences, the article presents specific recommendations for adapting successful practices to the Albanian reality. These recommendations focus on improving the legal framework, strengthening institutional capacities, and enhancing international cooperation for a more effective response to complex financial crimes.

Keywords: money laundering, international practices, legal framework, law enforcement institutions, international cooperation, financial crime, legal reform, Albania.

KRIMET FINANCIARE DHE PASTRIMI I PARAVE

PhD (C) Anisa Pali¹

Abstrakt

Krimet financiare dhe pastrimi i parave janë të lidhura ngushtë për shkak të natyrës së aktiviteteve të paligjshme dhe nevojës për të mbuluar origjinën e fitimeve të paligjshme. Krimet financiare shpesh gjenerojnë para që duhet të “pastrohen” në mënyrë që ato të mos tërheqin vëmendjen e autoriteteve ligjore dhe të mund të përdoren pa rrezikuar zbardhjen e burimit të tyre.

Ky punim shqyrton trendet më të fundit të krimeve financiare, me fokus të veçantë në rritjen e pastrimit të parave dhe mënyrat se si ligji dhe politikat kombëtare janë adaptuar për të përballuar këto sfida. Në një periudhë ku krimet financiare po bëhen gjithnjë e më të sofistikuara dhe ndërkombëtare kjo për shkak edhe të zhvillimit të shpejtë të teknologjisë, vendi ynë ka parë një rritje të aktiviteteve të pastrimit të parave, shpesh të lidhura me korrupsionin, evazionin fiskal, dhe aktivitete të tjera të paligjshme që dëmtojnë ekonomikisht vendin dhe rrisin rrezikun për sigurinë kombëtare. Punimi analizon masat e reja legislative dhe reformat e strukturave ekzistuese, përfshirë zbatimin e rekomandimeve të Grupit të Veprimit Financiar (FATF) dhe implementimin e rregulloreve ndërkombëtare në fushën e luftës kundër pastrimit të parave.

Përmes shqyrtimit të zhvillimeve ligjore dhe politikave të reja, si rritja e transparencës në sektorin financiar dhe pasurive të paluajtshme, identifikimi dhe ndjekja e burimeve të dyshimta të financimit, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, ky punim synon të ofrojë një pasqyrë të plotë të përpjekjeve për të luftuar krimet financiare dhe pastrimin e parave. Gjithashtu, ky punim vlerëson sfidat dhe

1. Drejtorja Rajonale Tatimore Durrës, anisa.pali@yahoo.it

mundësitë e implementimit të këtyre reformave, si dhe mënyrën se si ato mund të ndikojnë në kontrollin dhe parandalimin e pastrimit të parave në të ardhmen, për të siguruar një mjedis më të sigurt dhe të qëndrueshëm financiar për vendin tonë.

Fjalët kyçe: *Krime financiare, pastrim parash, transparencë, masa ligjore.*

FINANCIAL CRIMES AND MONEY LAUNDERING

PhD (C) Anisa Pali¹

Abstract

Financial crimes and money laundering are closely linked due to the nature of illegal activities and the need to conceal the origin of illicit profits. Financial crimes often generate money that needs to be “laundered” so that it does not attract the attention of legal authorities and can be used without the risk of revealing its source.

This paper examines the latest trends in financial crimes, with a special focus on the rise of money laundering and how national laws and policies have adapted to address these challenges. In an era where financial crimes are becoming increasingly sophisticated and international, partly due to the rapid development of technology, our country has seen an increase in money laundering activities, often related to corruption, tax evasion, and other illegal activities that harm the country economically and heighten the risk to national security.

The paper analyzes new legislative measures and reforms of existing structures, including the implementation of recommendations from the Financial Action Task Force (FATF) and the adoption of international regulations in the field of combating money laundering. By reviewing legal developments and new policies, such as increased transparency in the financial and real estate sectors, identifying and tracking suspicious funding sources, and strengthening international cooperation, this paper aims to provide a comprehensive overview of efforts to combat financial crimes and money laundering. Furthermore, this paper evaluates the challenges and opportunities of implementing these reforms, as well as how they may affect the

1. Regional Tax Directorate, Durrës, anisa.pali@yahoo.it

control and prevention of money laundering in the future, ensuring a safer and more sustainable financial environment for our country.

Keywords: *Financial crimes, money laundering, transparency, legal measures.*

KRIMINALITETI FINANCIAR DHE PASTRIMI I PARAVE NË SHQIPËRI: NDËRTHURJA ME EKONOMINË FORMALE DHE PËRDORIMI I KRIPTOMONEDHAVE

Ergys Shehu¹

Abstrakt

Pastrimi i produkteve të veprës penale përbën një sfidë të ndërlikuar juridike dhe institucionale, sidomos në një realitet ku grupet kriminale po veprojnë me metoda gjithnjë e më të sofistikuara. Objektivi i tyre është përzierja e fitimeve kriminale me veprimtari të ligjshme financiare, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë identifikimin e parave të pista dhe ndarjen e tyre nga kapitali i ligjshëm. Në Shqipëri, një fenomen i përsëritur është kapja e sasive të mëdha të parave në pikat kufitare, të padeklaruara, të cilat më pas hyjnë në qarkullim në formë “cash” – një praktikë që rëndon ndjeshëm procesin hetimor dhe gjurmueshmërinë ligjore të tyre.

Një nga format më të zakonshme të kamuflimit të burimeve të paligjshme mbetet investimi në sipërmarrje ndërtimi, ku struktura ligjore dhe fiskale shpesh krijon hapësira për manipulim. Së fundmi, përdorimi i kriptomonedhave nga grupet kriminale po kthehet në një mekanizëm të ri, efektiv dhe të vështirë për t'u kontrolluar nga autoritetet, për shkak të natyrës së decentralizuar dhe anonimitetit që ofrojnë këto teknologji.

Ky artikull analizon nga një këndvështrim juridik mënyrat se si pastrimi i parave realizohet në praktikë, si dhe shqyrton mekanizmat ligjorë ekzistues për ta parandaluar dhe ndëshkuar atë. Në përqendrim është vënë korniza ligjore shqiptare, sfidat në zbatim dhe nevoja për

1. Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Ergys. Shehu@dpbsh.gov.al

harmonizim më të mirë me standardet ndërkombëtare, përfshirë domosdoshmërinë e rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përdorimit të teknologjive të reja në hetimin financiar.

Fjalë kyçe: pastrim parash, krime financiare, veprimtari kriminale, ndërtim, kriptomonedha, legjislacion penal, Shqipëri, qarkullimi cash, pikë kufitare, bashkëpunim institucional.

FINANCIAL CRIME AND MONEY LAUNDERING IN ALBANIA: INTERCONNECTION WITH THE FORMAL ECONOMY AND THE USE OF CRYPTOCURRENCIES

Ergys Shehu

Abstract

Laundering the proceeds of crime constitutes a complex legal and institutional challenge, especially in a reality where criminal groups are operating with increasingly sophisticated methods. Their objective is to mix criminal profits with legitimate financial activities, making it increasingly difficult to identify dirty money and separate it from legitimate capital. In Albania, a recurring phenomenon is the seizure of large amounts of money at border points, undeclared, which then enter circulation in the form of “cash” – a practice that significantly complicates the investigative process and their legal traceability.

One of the most common forms of camouflage of illicit sources remains investment in construction ventures, where the legal and fiscal structure often creates room for manipulation. Finally, the use of cryptocurrencies by criminal groups is becoming a new, effective and difficult mechanism for authorities to control, due to the decentralized nature and anonymity that these technologies offer.

This article analyzes from a legal perspective the ways in which money laundering is carried out in practice, as well as examines the existing legal mechanisms to prevent and punish it. The focus is on the Albanian legal framework, the challenges in implementation and the need for better harmonization with international standards, including the necessity of increasing inter-institutional cooperation

and the use of new technologies in financial investigation.

Keywords: *money laundering, financial crimes, criminal activity, construction, cryptocurrency, criminal legislation, Albania, cash circulation, border crossing, institutional cooperation.*

INSTITUTI I MASAVE TË SIGURIMIT PERSONAL, RAPORTI MIDIS JURISPRUDENCËS VENDASE DHE ASAJ TË GJEDNJ-SË

Msc. Skerdi DERVISHI¹

Abstrakti

Nëpërmjet këtij punimi synohet të analizohen masat e sigurimit personal me karakter shtrëngues të parashikuara në legjislacionin tonë të brendshëm. Zbatimi i masave të sigurimit ndërhyjnë në mënyrë direkte në gëzimin e lirë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke kërkuar në këtë mënyrë që shtetet të krijojnë mekanizma kontrolli për të siguruar një balancë të drejtë midis, nevojës së shtetit dhe organeve ligjzbatuese për të ruajtur sigurinë, dhe nga ana tjetër respektimin e të drejtave që gëzojnë individët. Rëndësi më të madhe në punim i është dhënë masës së sigurimit arrest në burg, kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale si dhe problematikave të shumta që hasen në aplikimin e kësaj mase në praktikë. Duke parë se kohët e fundit shumë studiues të së drejtës kanë patur polemika të shumta se nga ana e organeve të drejtësisë po abuzohet me aplikimin e një mase të tillë me karakter shtrëngues, si dhe të gjendur përballë faktit se vendi ynë ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, analiza teorike është shoqëruar me jurisprudencë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ndër të tjera në punim janë trajtuar edhe raste nga praktika vendase e cila nuk duhet lënë pa përmendur fakti se, shpesh Gjykata e Lartë nëpërmjet vendimeve të saj ka dhënë një zgjidhje esenciale duke sqaruar sa më qartë rrugën juridike dhe hapat procedural që organet proceduese duhet të kenë parasysh në aplikimin e masave të sigurimit. Në përfundim të punimit, duke u bazuar në analizën e tematikave si dhe logjikës juridike, janë paraqitur disa opinione personale në formën e konkluzioneve.

1. Asistent-lektor pranë Fakultetit të Shkencave Politiko-Juridike, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, e-mail: skerdid22@gmail.com

INSTITUTION OF PERSONAL SECURITY MEASURES, THE REPORT BETWEEN NATIONAL JURISPRUDENCE AND ECHR JURISPRUDENCE

Msc. Skerdi DERVISHI

Abstract

This paper aims to analyze the personal security measures with a coercive character provided for in our national legislation. The implementation of security measures directly intervenes in the free enjoyment of human rights and fundamental freedoms, requiring the authorities to create control mechanisms to ensure a fair balance between the state's and law enforcement agencies' need to maintain security, and, on the other hand, the respect for the rights enjoyed by individuals. The main focus of the paper is on the security measure of arrest in prison, the conditions and criteria established in the Criminal Procedure Code, as well as the many issues encountered in the practical application of this measure. Given that recently there has been significant debate among legal scholars regarding the abuse of such a coercive measure by judicial authorities, and considering that our country has ratified the European Convention on Human Rights, the theoretical analysis is accompanied by jurisprudence from the European Court of Human Rights. The paper also addresses cases from domestic practice, which should not be overlooked, as the High Court often provides an essential solution through its decisions, clearly explaining the legal path and procedural steps that prosecuting bodies should consider when applying security measures. In conclusion, based on the analysis of the themes and legal logic, some personal opinions and conclusions are presented.

MODELI EUROPIAN “BARNAHUS” I DREJTËSISË MIQËSORE PËR TË MITUR

MSc. Av. Maend Kullaj¹

Abstrakt

Barnahus i referohet modelit europian të drejtësisë miqësore për të mitur që mbledh bashkë të gjithë profesionistët e fushës në një qendër të vetme multidisiplinare. E ideuar nga qeveria islandeze për të trajtuar kryesisht të miturit viktimë dhe dëshmitarë të dhunës, abuzimeve, dhe shfrytëzimeve, në veçanti atyre seksuale, modeli tashmë është promovuar nga Këshilli i Europës dhe Bashkimi Europian dhe po zbatohet me sukses në disa shtete europiane. Barnahus shërben si një zyrë miqësore e përbashkët ku polici, prokurori, gjyqtari, avokati, punonjësi social, mjeku, dhe psikologu, punojnë me dhe për të miturin. Ky artikull shpalos standardet e modelit të shërbimeve Barnahus për ruajtjen e interesit më të lartë të fëmijës dhe shmangien e viktimizimit të dytë, dhe vlerëson mundësitë për një zbatim teorik të Barnahus-it në Shqipëri, i cili në fakt ka disa vite që është ndërmarrë si nismë nga organizata të shoqërisë civile. Nga ana tjetër, artikulli paraqet edhe sfidat e mundshme sipas shteteve për zbatimin e modelit Barnahus, si kostoja, mungesa e koordinimit, ose infrastruktura. Ky artikull vjen në kuadër edhe të ndryshimeve të para në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, të planifikuara në fund të vitit 2025, lidhur me disa të drejta procedurale të të miturit. Artikulli në përfundim mbështet dhe propozon institucionalizimin e modelit Barnahus nga shteti shqiptar, i cili nuk ka shfaqur ende interes për zbatimin e këtij modeli, duke kaluar kështu përfundimisht nga një regjim i drejtësisë “penale” për të mitur, në një të drejtësisë “miqësore” për të mitur të bërë realitet.

Fjalë kyçe: Barnahus; europian; drejtësi miqësore për të mitur; viktimizim i dytë; Shqipëri

1. MSc. Av. Maend Kullaj, avokat, asistent-lektor, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Albanian University. E-mail: m.kullaj@albanianuniversity.edu.al.

THE EUROPEAN “BARNAHUS” MODEL OF CHILD-FRIENDLY JUSTICE

MSc. Atty. Maend Kullaj¹

Abstract

Barnahus refers to the European model of child-friendly justice that brings together all the relevant professionals in a single multidisciplinary center. Created by the Icelandic government mainly to treat child victims and witnesses of violence, abuse, and exploitation, especially sexual, the model has now been promoted by both the Council of Europe and the European Union and has been successfully implemented in some European countries. Barnahus serves as a friendly common office where the police officer, prosecutor, judge, lawyer, social worker, doctor, and psychologist work and cooperate with and for the child. This article unveils the standards of the Barnahus model of services for ensuring the best interest of the child and preventing secondary victimization, and assesses the opportunities for a theoretical implementation of Barnahus in Albania, which in fact for years has been the initiative of civil society organizations. On the other hand, the article also presents possible challenges for the implementation of the Barnahus model, according to countries, like the cost, lack of coordination, or infrastructure. This article also comes ahead of the first amendments to the Code of Criminal Justice for Minors, planned by the end of 2025, related to some procedural rights of the minor. The article concludes by supporting and proposing the institutionalization of the Barnahus model by the Albanian government, which has yet to express interest in the model's implementation, finally going from a “criminal” justice regime to making reality a “child-friendly” one.

Keywords: Barnahus; European; child-friendly justice; secondary victimization; Albania

1. MSc. Atty. Maend Kullaj, Attorney, Assistant Lecturer, Faculty of Social Sciences, Albanian University. E-mail: m.kullaj@albanianuniversity.edu.al.

DREJTËSIA PENALE PËR TË MITURIT

Krist Manxharaj¹

Abstrakti

Drejtësia penale për të miturit është një fushë e veçantë e sistemit ligjor që synon trajtimin e shkeljeve të ligjit nga të miturit duke balancuar nevojën për rehabilitim dhe mbrojtjen e të miturve. Ky studim shqyrton dënimin penal të të miturve në qytetin e Beratit gjatë një periudhe pesëvjeçare, duke analizuar faktorët që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve, llojet e veprave penale të kryera dhe masat ndëshkuese të aplikuara. Nëpërmjet një qasjeje empirike, duke kombinuar analiza statistikore dhe intervista me profesionistë të drejtësisë, studimi synon të identifikojë tendencat kryesore dhe efektivitetin e politikave ndëshkuese dhe rehabilituese. Rezultatet tregojnë se faktorët socio-ekonomikë dhe familjarë luajnë një rol kyç në përfshirjen e të miturve në veprimtari kriminale. Ky studim analizon qasjet ligjore dhe praktikat ndërkombëtare në trajtimin e të miturve në përballjen me ligjin, duke u fokusuar në standardet e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe kornizat ligjore kombëtare. Studimi sugjeron se një sistem penal i fokusuar në edukim dhe riintegrim, në vend të ndëshkimit të ashpër, është më efikas në reduktimin e krimit. Në vitet e fundit interesi për njohjen dhe zbatimin e tyre ka ardhur në rritje duke u bërë kështu pjesë e moduleve të trajnimit dhe e monitorimit nga organizata të ndryshme joqeveritare që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Është pikërisht kjo kategori e cila për shkak të veçantive të saj të moshës, të papjekurisë fizike dhe intelektuale duhet të gëzojë një mbrojtje të veçantë nga shteti. Kjo frazë përbën kështu edhe preambulën e Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e fëmijëve”.

“Ardhshmëria e një kombi matet drejpërsëdrejti nga gjendja prezente e rinisë së tij”²

1. Jurist, Inspektor i Policisë pranë DVP Berat. mirandakolldani@gmail.com

2. Xhon.F.Kenedi

CRIMINAL JUSTICE FOR MINORS

Krist Manxharaj¹

Abstract

Juvenile criminal justice is a specific field of the legal system which aims to address juvenile offenses by balancing the need for rehabilitation and the protection of minors. This study examines the criminal sentencing of juveniles in the city of Berat over a five-year period of time, analyzing the factors influencing juvenile delinquency, the types of offenses committed, and the punitive measures applied. By means of an empirical approach that combines statistical analysis and interviews with justice professionals, this study aims to identify the key tendencies and assess the effectiveness of punitive and rehabilitative policies. The findings indicate that the socio-economic and family factors play a crucial role in the juvenile involvement in criminal activities. This study also explores legal approaches and international practices in juvenile justice, focusing on the standards set by the United Nations Convention on the Rights of the Children and national legal frameworks. The research suggests that a justice system centered on education and reintegration, rather than harsh punishment, is more effective in reducing juvenile crime. Human rights in general, and the children's rights in particular, are among the most sensitive aspects of a democratic society. In recent years, the interest in recognizing and enforcing these rights has grown, becoming an integral part of training programs and monitoring efforts by various non-governmental organizations operating in the field of human rights. Given their age, physical immaturity, and intellectual development, it is precisely this category which requires special protection from the state. This principle is also enshrined in the preamble of the United Nations Convention on the Rights of the Child.

“The future of a nation is directly measured by the present condition of its youth.”²

1. Lawyer, Police Inspector at DVP Berat. mirandakolldani@gmail.com

2. John F. Kennedy

MBROJTJA E FËMIJËVE NË METAVERSE: SFIDAT LIGJORE DHE PARANDALIMI I KRIMEVE VIRTUALE

MSc. Av. Iris Shehaj¹

Abstrakt

Përmirësimi i sigurisë së fëmijëve në internet është aktualisht një prioritet global, veçanërisht me zhvillimin e shpejtë të teknologjive të reja dhe me rritjen e përdorimit të hapësirave virtuale si “metaverse”, ku fëmijët janë të ekspozuar ndaj një sërë kërcënimesh si për shembull, krimet kibernetike, ngacmimet seksuale, bullizimi, lejimi i veprimeve me natyrë qartësisht seksuale, drogërat, lojërat e fatit, fyerjet dhe ngacmimet në bazë të racës, seksualitetit dhe gjinisë. Për më tepër, metaverse mund të përdoret nga grupet ekstremiste si mjet për të rekrutuar dhe radikalizuar fëmijë. Metaverse është një koncept që përfaqëson një botë virtuale, ku individët mund të angazhohen në aktivitete dhe ndërveprime të ngjashme me ato të botës reale ose ku përdoruesit kanë mundësi të krijojnë dhe personalizojnë avatarë, duke krijuar një botë virtuale që mund të jetë shumë e ndryshme nga ajo që mund të përjetojnë në jetën e tyre fizike. Ky artikull ka si qëllim të identifikojë dhe analizojë sfidat dhe kërcënimet me të cilat fëmijët përballen në metaverse, si dhe thekson nevojën për një kornizë ligjore e cila adreson mangësitë e legjislacionit aktual, anonimitetin, dhe ndërveprimin midis botës fizike dhe asaj virtuale. Një nga sfidat më të mëdha ligjore është vendosja e përgjegjësisë ndaj individëve të cilët mund të krijojnë veprime kriminale në metaverse, ndërsa mbajnë të fshehur identitetin e tyre pas avatarëve të krijuar. A duhet të mbajë personi përgjegjësi ligjore për veprimet kriminale të kryera në metaverse,

1. MSc. Av. Iris Shehaj, Juriste, Hulumtuese ligjore, Qendra SCiDEV.
E-mail: irisshehaj1@gmail.com

dhe çfarë ndodh kur këto veprime kanë pasoja kriminale në jetën reale? Artikulli shqyrton gjithashtu kuadrin ligjor dhe rregullator të Bashkimit Evropian, në veçanti rolin e Aktit të Shërbimeve Digjitale (DSA), si një kornizë për mbrojtjen e përdoruesve të rinj. Artikulli në përfundim, synon të kontribuojë në ofrimin e rekomandimeve për politika ligjore që parandalojnë dhe ndëshkojnë krimet virtuale.

Fjalë kyçe: *Metaverse, Bota Virtuale, Avatar, Siguria e Fëmijëve në Internet, Krime Virtuale*

CHILD PROTECTION IN THE METAVERSE: LEGAL CHALLENGES AND PREVENTION OF VIRTUAL CRIMES

MSc. Atty. Iris Shehaj¹

Abstract

The improvement of children's online safety is currently a global priority, especially with the rapid development of new technologies and the increased use of virtual spaces like the "metaverse", where children are exposed to a range of threats such as cybercrimes, sexual harassment, bullying, explicit sexual activities, drugs, gambling, insults, and harassment based on race, sexuality, and gender. Furthermore, the metaverse can be used by extremist groups as a tool for recruiting and radicalizing children. The metaverse is a concept that represents a virtual world where individuals can engage in activities and interactions similar to those in the real world or where users have the opportunity to create and customize avatars, creating a virtual world that can be very different from what they experience in their physical lives. This article aims to identify and analyze the challenges and threats children face in the metaverse, as well as highlight the need for a legal framework that addresses the shortcomings of existing legislation, anonymity, and the interaction between the physical and virtual worlds. A key legal challenge is the attribution of responsibility to individuals who may engage in criminal activities within the metaverse while keeping their identity hidden behind avatars. Should a person be held legally accountable for criminal actions committed in the metaverse, and what are the implications when such actions result in criminal consequences in the real world? This article further examines the legal and regulatory

1. MSc. Atty. Iris Shehaj, Legal Officer, Legal researcher, SCiDEV Center. E-mail:iris-shehaj1@gmail.com

framework of the European Union, with particular focus on the Digital Services Act (DSA) as a framework for protecting young users. In conclusion, the article aims to contribute by providing recommendations for legal policies that prevent and punish virtual crimes.

Keywords: *Metaverse, Virtual World, Avatar, Online Child Safety, Virtual Crimes*

SHQIPËRIA DHE SFIDA E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM: ANALIZË E MASAVE TË NDËRMARRA NDËR VITE

Arjola Cana¹

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim të analizojë fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, duke u fokusuar në kuadrin ligjor, mekanizmat institucionalë dhe efektivitetin e masave të ndërmarra nga shteti shqiptar në parandalimin dhe luftimin e këtyre kërcënimeve të natyrës së sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Në një situatë të ndikuar ndjeshëm nga zhvillimet globale të sigurisë dhe sfidat e reja që lidhen me radikalizimin dhe përhapjen e ideologjive ekstremiste, Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s dhe pjesëmarrëse aktive në Koalicionin Global kundër DAESH/ISIS, ka përafruar politikat e saj me standardet ndërkombëtare dhe ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për ndërtimin e një përgjigjeje institucionale të qëndrueshme dhe funksionale.

Ky punim synon të analizojë në mënyrë kronologjike dhe kritike masat që janë ndërmarrë nga institucionet shqiptare për parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni në periudhën 2000–2025. Analiza do të mbështetet në aktet ligjore dhe nënligjore, në “Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit”, e cila përfaqëson dokumentin kryesor orientues për hartimin dhe zbatimin e masave ligjore, politike dhe sociale në këtë fushë, si dhe në raporte dhe vlerësime nga struktura institucional. Gjithashtu do të shihet roli i strukturave institucionale si Drejtoria e Antiterrorit dhe Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Punimi vlerëson efektivitetin e qasjes

1. Master Shkencor në Drejtësi, Specialiste në Drejtorinë e Kodifikimit dhe Harmonizimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë, arjolacanaa@gmail.com

shqiptare dhe propozon rekomandime për përmirësimin e masave ekzistuese në një kontekst demokratik dhe të drejtë të sigurisë. Në përfundim, theksohet domosdoshmëria e forcimit të kapaciteteve ligjzbatuese, përmirësimit të koordinimit ndërinstitucional dhe integritit të një qasjeje të balancuar ndërmjet sigurisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në politikat kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Fjalë kyçe: *Ekstremizmi i dhunshëm, Radikalizimi, Terrorizmi, Siguria kombëtare, Strategjia kundër ekstremizmit, Politika e sigurisë*

ALBANIA AND THE CHALLENGE OF VIOLENT EXTREMISM: AN ANALYSIS OF MEASURES UNDERTAKEN OVER THE YEARS

Arjola Cana¹

Abstract

This paper aims to analyze the phenomenon of violent extremism in Albania, with a focus on the legal framework, institutional mechanisms, and the effectiveness of the measures undertaken by the Albanian state in preventing and combating these threats to national and international security. In a context significantly influenced by global security developments and new challenges related to radicalization and the spread of extremist ideologies, Albania—as a NATO member and an active participant in the Global Coalition against DAESH/ISIS—has aligned its policies with international standards and has undertaken significant steps toward establishing a sustainable and functional institutional response. This paper seeks to provide a chronological and critical analysis of the measures undertaken by Albanian institutions to prevent and combat this phenomenon during the period 2000–2025. The analysis will be based on primary and secondary legislation, as well as on the “Cross-Sectoral Strategy for the Prevention of Violent Extremism and the Fight against Terrorism,” which serves as the main guiding document for the design and implementation of legal, political, and social measures in this field, in addition to reports and assessments from institutional structures. Furthermore, the role of institutional bodies such as the Counter-Terrorism Directorate and the Coordination Center against Violent Extremism will be examined. The paper evaluates the effectiveness of Albania’s approach and offers

1. Master of Science in Law, Specialist at the Directorate of Codification and Harmonization of Legislation at the Ministry of Justice, arjolacanaa@gmail.com

recommendations for the improvement of existing measures within a democratic and rights-based security framework. In conclusion, it highlights the necessity of strengthening law enforcement capacities, enhancing inter-institutional coordination, and integrating a balanced approach between security and the protection of human rights in countering violent extremism policies.

Keywords: *Violent extremism, Radicalization, Terrorism, National security, Counter-extremism strategy, Security policy*

SHQIPËRIA: VEND IMPORTUES, EKSPORTUES APO TRANZITOR I TERRORIZMIT?

MSc. Taulant SULA¹

Dr. Mareglen TOMORI²

Abstrakt

Siguria përbën një ndër sfidat më të mëdha me të cilat përballet njerëzimi, veçanërisht në epokën e globalizimit. Lëvizjet ndërkombëtare të popullsisë, të shoqëruara me diversitet kulturor e fetar, përbëjnë një faktor ndikues në ndërlikimin e çështjeve të sigurisë. Shpesh, këto lëvizje ndodhin duke anashkaluar filtrat e vendosur nga sistemet shtetërore të kontrollit kufitar, duke sjellë emigrim të paligjshëm dhe rrjedhimisht rrezik për infiltrimin e elementëve të rrezikshëm, përfshirë edhe aktorë të terrorizmit ndërkombëtar.

Shqipëria nuk ka mbetur jashtë këtij realiteti global. Ajo është përfshirë në mënyra të ndryshme në këtë fenomen: si vend tranzit, eksportues dhe në masë më të vogël edhe si vend importues i ideologjive apo individëve të lidhur me terrorizmin. Pavarësisht se ka një popullsi homogjene etnike, përbërja e saj kulturore dhe fetare është e larmishme, si pasojë e historisë së saj të gjatë të pushtimeve dhe ndikimeve të huaja. Pozicioni gjeostrategjik i Shqipërisë, si urë lidhëse mes Lindjes dhe Perëndimit që nga koha e Via Egnatia-s, e bën atë veçanërisht të ekspozuar ndaj rrjeteve të trafikut dhe terrorizmit ndërkombëtar.

Pas viteve 1990, me rënien e regjimit komunist dhe hapjen e kufijve, Shqipëria u përfshi në lëvizje masive emigratore. Krahës eksporteve kulturore, ndodhën edhe eksporte të kriminalitetit, ndërsa nga vendet

1. Specialist i Hetimit, Drejtoria Antiterrorit, Policia e Shtetit Shqiptar taulantsula94@gmail.com

2. Kriminolog, President Ekzekutiv – CEO, International Police Organization IPO to-morimareglen@gmail.com

pritëse u importuan modele të reja sjelljeje dhe organizimi kriminal, përfshirë edhe forma të hershme të ekstremizmit dhe terrorizmit. Kjo u përshpejtua më tej nga zhvillimet teknologjike dhe dixhitale. Ndër vite, janë dokumentuar raste të shtetasve shqiptarë që janë përfshirë në veprimtari terroriste, përfshirë rekrutimin dhe pjesëmarrjen në luftëra jashtë territorit të vendit, kryesisht në Siri përkrah organizatës terroriste ISIS, sidomos në periudhën 2012–2015. Ky abstrakt synon të shtrojë për diskutim rolin që ka dhe mund të ketë Shqipëria në dinamikën globale të terrorizmit dhe të sugjerojë nevojën për forcim të mekanizmave të kontrollit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për të parandaluar përfshirjen e mëtejshme të vendit në këto fenomene.

Fjalë kyçe: *Shqipëria, terrorizëm, emigrim, ISIS, siguri kombëtare, ekstremizëm i dhunshëm*

ALBANIA: AN IMPORTING, EXPORTING, OR TRANSIT COUNTRY FOR TERRORISM?

MSc. Taulant SULA¹

Dr. Mareglen TOMORI²

Abstract

Security represents one of the greatest challenges facing humanity, particularly in the era of globalization. International movements of populations, accompanied by cultural and religious diversity, contribute significantly to the complexity of security issues. Often, these movements occur by bypassing the filters established by state border control systems, resulting in illegal immigration and consequently increasing the risk of infiltration by dangerous elements, including actors associated with international terrorism.

Albania has not remained outside of this global reality. It has been involved in this phenomenon in various ways: as a transit country, an exporter, and to a lesser extent, an importer of ideologies or individuals connected to terrorism. Despite having an ethnically homogeneous population, its cultural and religious composition is diverse, as a consequence of its long history of occupations and foreign influences. Albania's geostrategic position, serving as a bridge between East and West since the time of the Via Egnatia, makes it particularly exposed to international trafficking and terrorism networks.

After the 1990s, with the fall of the communist regime and the opening of borders, Albania experienced massive migratory movements. Alongside cultural exports, there was also the export of criminality, while from host countries, new models of behavior and criminal or-

1. Investigation Specialist, Counter-Terrorism Directorate, Albanian State Police, taulantsula94@gmail.com

2. Criminologist, Executive President – CEO, International Police Organization (IPO), tomorimareglen@gmail.com

ganization were imported, including early forms of extremism and terrorism. This trend was further accelerated by technological and digital developments. Over the years, there have been documented cases of Albanian citizens involved in terrorist activities, including recruitment and participation in wars outside the country’s territory—primarily in Syria alongside the terrorist organization ISIS, particularly during the 2012–2015 period.

This abstract aims to present for discussion the role Albania currently plays and may potentially play in the global dynamics of terrorism, while also suggesting the need to strengthen control mechanisms and international cooperation to prevent the country’s further involvement in such phenomena.

Keywords: Albania, terrorism, migration, ISIS, national security, violent extremism

MBROJTJA E GARANTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NË EPOKËN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE DHE SFIDAT E DREJTËSISË PENALE

M.Sc. Eljona Ruçi

Abstrakt

Në shekullin ku po jetojmë, teknologjia për çdo individ është burim kryesor i informacionit, i kënaqësisë, i argëtimit, i sigurisë, dhe i shëndetit, pra praktikisht mund të themi se mbulon të gjitha sferat më të rëndësishme të jetës. Megjithatë, kjo e ardhme kaq e ndritur fatkeqësisht e ka një kosto dhe në fakt, pak a shumë vihet re se po shkohet drejt çënimit të mbrojtjes së jetës private.

Edhe Inteligjenca Artificiale është një ndër llojet e zhvillimit të teknologjisë e cila po bën të mundur që kompjuteri të ketë aftësinë që të veprojë si qenie njerëzore. Qëllimi afatgjatë i politikës në Shqipëri, ashtu sikundër kudo në praktikën ndërkombëtare, është që kjo inteligjencë të përfshihet në të gjithë sektorët, duke synuar një ndikim pozitiv transformues në: arsim, bujqësi, në kujdesin shëndetësor, në administratën publike, si dhe në taksa e tatime.

Por, ky zhvillim teknologjik tejte i sofistikuar praktikisht po tregon se po bëhet kanosëse për njerëzimin ku ekziston gjithmonë e më shumë mundësia që inteligjenca artificiale ta mposhtë njeriun. Bazuar në konkluzionin e mësipërm, në çdo shtet ligjor duhet të ekzistojë sanksionimi i normave juridiko - penale për të garantuar efektivisht njohjen, zhvillimin dhe mbrojtjen e aspekteve të ndryshme në të cilat materializohet koncepti i jetës private dhe siguria kombëtare.

Gjatë këtij punimi do të trajtohen e analizohen praktikisht mënyrat dhe format e ndryshme sesi ndikon ligjërisht Inteligjenca Artificiale në çënimin e jetës private në nivel global. Gjithashtu, në këtë artikull

do të sugjerohen masat parandaluese për reduktimin sa më tepër të veprave penale që çënojnë jetën private të individit, duke patur shkak përdorimin e AI-së.

Fjalë kyçe: *zhvillim teknologjik, Inteligjenca Artificiale, jetë private, siguria kombëtare, norma penale juridike*

PROTECTING AND GUARANTEEING HUMAN RIGHTS IN THE AGE OF ARTIFICIAL INTELLIGENCE AND CRIMINAL JUSTICE CHALLENGES

Abstract

In the century we are living in, technology for each individual is the main source of information, pleasure, entertainment, security, and health, so practically we can say that it covers all the most important spheres of life. However, this bright future unfortunately has a cost and in fact, it is more or less noticed that it is moving towards the violation of the protection of private life.

Even Artificial Intelligence is one of the types of technology development which is making it possible for the computer to have the ability to act like a human being. The long-term goal of politics in Albania, as everywhere in international practice, is that this intelligence is included in all sectors, aiming for a positive transformative impact in: education, agriculture, health care, public administration, as well as taxes.

But this highly sophisticated technological development is practically showing that it is becoming a threat to humanity where there is always more and more possibility that artificial intelligence will defeat man. Based on the above conclusion, in every legal state there must be the sanctioning of legal - criminal norms to effectively guarantee the recognition, development and protection of the various aspects in which the concept of private life and national security materialize.

During this paper, the different ways and forms of how Artificial Intelligence legally affects the violation of private life at the global level will be practically treated and analyzed. Also, in this article, preventive measures will be suggested to reduce as much as possible criminal offenses that affect the private life of the individual, due to the use of AI.

Key words: *technological development, Artificial Intelligence, private life, national security, criminal law*

PËRGJEGJËSIA PENALE E KORPORATAVE DHE SFIDAT E NDJEKJES PENALE TË SUBJEKTEVE JURIDIKE

Al Banushi¹

Abstrakt

Ky punim synon të analizojë natyrën e përgjegjësisë penale të korporatave, si subjekte juridike të veçanta për nga mënyra e ndërverprimit në fushën e ligjës penale, duke u fokusuar konkretisht në vështirësitë që hasen gjatë procesit të ndjekjes penale të tyre dhe propozimin e zgjidhjeve për sfidat e hasura.

Së pari, do të analizohen bazat teorike dhe evolucioni historik i kësaj fushe, duke përfshirë kornizën ligjore ndërkombëtare dhe atë vendase, ku ky koncept mbështetet.

Përmes një qasjeje krahasuese, do të shqyrtohet kuadri ligjor shqiptar dhe ai i vendeve të Bashkimit Evropian, duke u ndalur në mekanizmat e tyre për sanksionimin dhe ekzekutimin e këtyre sanksioneve ndaj korporatave.

Karakteristikë e viteve të fundit është padyshim forcimi i vazhdueshëm i ndikimit të korporatave në reformimin e mjedisit ekonomik, social e politikë në vend. Zhvillimi galopant dhe i pakontrolluar i pozitave të tyre, mund të sjellë pasoja negative për shoqërinë, duke minimizuar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve të prekur nga aktiviteti i tyre.

Analiza e mëposhtme, do të trajtojë në mënyrë të hollësishme vështirësitë që lidhen me mbledhjen e provave, rregullimin strukturorë kompleks të korporatave dhe përcaktimin e përgjegjësisë individuale brenda këtyre të fundit, me fokus të veçantë në fushën e

1. Msc. E drejtë Civile; Specialist në Sektorin e Integritimit Evropian, Drejtoria e Integritimit dhe Negociatave, Ministria e Drejtësisë; albanushi1@hotmail.com

krimeve financiare dhe korrupsionit.

Për më tepër, do të shtjellohen llojet e sanksioneve që mund t'u imponohen këtyre subjekteve juridike dhe ndikimi që ka ndjekja penale në aktivitetin ekonomik dhe politikat e brendshme të tyre.

Në përfundim, sugjerohen ndryshime ligjore dhe rekomandime konkrete, me qëllim rritjen e efektivitetit të ndjekjes penale ndaj këtyre subjekteve tregtare, duke u bazuar në praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian.

Fjalë kyçe: përgjegjësi penale, korporatë, subjekt juridik, kuadër ligjor, hetim, sanksion.

CRIMINAL LIABILITY OF CORPORATIONS AND THE CHALLENGES OF PROSECUTING LEGAL ENTITIES

Al Banushi¹

Abstract

This paper aims to analyze the nature of corporate criminal liability as distinct legal entities in the field of criminal law, focusing specifically on the difficulties encountered during their prosecution and proposing solutions to the challenges faced.

First, the theoretical foundations and historical evolution of this field will be examined, including both the international and domestic legal frameworks that support this concept.

Through a comparative approach, the legal framework of Albania and that of European Union countries will be reviewed, with a focus on their mechanisms for sanctioning corporations and enforcing these sanctions.

In recent years, corporations have increasingly influenced the reformation of the economic, social, and political environment in the country. Their rapid and often uncontrolled expansion can have negative consequences for society, potentially undermining the protection of fundamental rights and freedoms of individuals affected by their activities.

The following analysis will explore in detail the challenges related to evidence collection, the complex structural regulation of corporations, and the determination of individual responsibility within them, with particular attention to financial crimes and corruption.

1. MSc. Civil Law; Specialist at the European Integration Sector, Directorate of Integration and Negotiations, Ministry of Justice; albanushi1@hotmail.com

Furthermore, the types of sanctions that can be imposed on these legal entities will be examined, as well as the impact of criminal prosecution on their economic activity and internal policies.

In conclusion, legal amendments and concrete recommendations will be suggested to enhance the effectiveness of prosecuting these commercial entities, drawing on the best practices of European Union countries.

Keywords: *criminal liability, corporation, legal entity, legal framework, investigation, sanction.*

RESTORATIVE JUSTICE FOR JUVENILES IN CONFLICT WITH THE LAW

Albjona Kajusha¹

Daniela Ndoj²

Abstract

The number of minors in conflict with the law in Albania is constantly growing, which results in a serious problem for the society. Economic and social factors, the educational system, exposure to social networks, are some of the factors that have influenced the spread of this phenomenon.

With the enactment of the Juvenile Criminal Justice Code in 2018, a very important legal instrument such as restorative justice was sanctioned. Through this instrument, the rehabilitation and reintegration of minors into society is aimed. A mechanism with a humane and non-punitive approach, offering minors the opportunity for a better future.

This paper aims to analyze measures that include restorative justice, alternative measures to avoid criminal prosecution and the mediation procedure. Among other aspects, the mechanisms that restorative justice employs in the framework of the intellectual, health, and psychological reintegration process of the minor will also be analyzed. The main focus will be on their effectiveness and applicability by the competent domestic bodies in relation to Albanian legislation and European Union directives.

A key role in the alternative solutions offered by restorative justice is played by the participation of the minor in the process and the involvement of the community, aiming for the best possible

1. Student in Faculty of Law, University of Tirana email: albjonakajusha@gmail.com

2 Student in Faculty of Law, University of Tirana email: danielandoj44@gmail.com

resolution of the conflict based on the best interest of the minor. Also, the contribution of local institutions in the prevention of juvenile delinquency is a key factor in deterring them from committing criminal acts. However, how efficient is the implementation of legal provisions by these bodies in practice in our country?

To conclude the previous claims, several measures are presented in the form of recommendations that should be taken into account by institutions regarding the treatment of minors in conflict with the law, to ensure their most effective rehabilitation.

Keywords: *measures of restorative justice, intermeditation, compensation for damages, preventative mechanisms.*

DREJTËSIA RESTAURUESE, I MITURI NË KONFLIKT ME LIGJIN

Albjona Kajusha¹

Daniela Ndoj²

Abstrakt

Numri i të miturve në konflikt me ligjin në Shqipëri është në rritje të vazhdueshme, duke u kthyer në një shqetësim serioz për shoqërinë. Faktori ekonomik, social, sistemi arsimor, ekspozimi ndaj rrjeteve sociale, janë disa nga arsyet që kanë ndikuar në përhapjen e këtij fenomeni. Me hyrjen në fuqi të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur në vitin 2018, u sanksionua një mekanizëm i rëndësishëm si drejtësia restauruese. Nëpërmjet këtij instrumenti synohet rehabilitimi dhe riintegrimi i të miturit në shoqëri. Një mekanizëm me qasje humane e jo ndëshkuese, duke i ofruar të miturit mundësinë për një të ardhme më të mirë.

Në këtë punim synohet të analizohen masat që përfshihen në drejtësinë restauruese, masat alternative për shmangien nga ndjekja penale dhe procedura e ndërmjetësimit. Ndër të tjera do të analizohen edhe mekanizmat që drejtësia restauruese ka në funksion të saj, në kuadër të procesit të riintegritit intelektual, shendetësor dhe psikologjik të të miturit. Fokusi kryesor do të jetë efektiviteti i tyre dhe zbatueshmëria nga organet kompetente vendase në raport me legjislacionin shqiptar dhe direktivat e Bashkimit Europian. Rol kryesor në zgjidhjet alternative që ofron drejtësia restauruese, luan dhe pjesëmarrja e të miturit në proces dhe përfshirja e komunitetit duke synuar zgjidhjen më të mirë të mundshme të konfliktit bazuar në interesin më të lartë të të miturit. Gjithashtu edhe kontributi i institucioneve vendase në parandalimin e kriminalitetit tek të miturit

1. Student in Faculty of Law, University of Tirana email: albjonakajusha@gmail.com

2 Student in Faculty of Law, University of Tirana email: danielandoj44@gmail.com

është një faktor kryesor në frenimin e tyre nga ndërmarrja e akteve kriminale, por sa efikas është zbatimi i parashikimeve ligjore nga këto organe në praktikë në vendin tonë?

Në pjesën përmbyllëse janë paraqitur në formë rekomandimesh disa masa që duhet të merren parasysh nga institucionet në lidhje me trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, për ti siguruar një rehabilitim sa më efektiv.

Fjalët kyç: drejtësia restauruese, ndërmjetësimi, kompesimi i dëmit, mekanizmat parandalues.

EVALUATING THE EFFECTIVENESS OF INTERNATIONAL LEGAL FRAMEWORKS IN COMBATING MONEY LAUNDERING: A CASE STUDY OF WACHOVIA BANK

Kristian Nela¹
Artemis Azizaj²

Abstract

Governments and organizations use international legal frameworks to combat financial crime, which is crucial in safeguarding a nation's economic welfare. Money laundering (ML) encourages illegal activities, impairs investors' trust, and manipulates global financial markets. This thesis evaluates the role of international legal frameworks in combating money laundering by researching the implementation of relevant task forces and organizations, focusing on critically evaluating a case study, namely the Wachovia Bank scandal. This case study provides empirical evidence, which is crucial in determining the limitations of enforcement and compliance with legal frameworks at the international level. Organizations such as the Financial Action Task Force (FATF), United Nations conventions, Basel Committee, World Bank, IMF, and IOSCO are at the frontline of determining the effectiveness of regulating financial institutions, enforcing compliance, and mitigating cross-border financial crimes. Research findings display a gap in the effectiveness of the combative frameworks regarding money laundering, especially in terms of practical implementation and cross-border cooperation. Even though international legal frameworks strengthen legal compliance mechanisms, financial transparency, and regulatory harmonization,

1. Student, Faculty of Law, University of Tirana, kristinela17@gmail.com

2. Student, Faculty of Law, University of Tirana, Azizajartemisa@gmail.com

disparities in regulatory enforcement, institutional capacity, and jurisdictional fragmentation continue to present significant challenges. The research establishes that adjustments are necessary to enforce the law and counter financial crimes more effectively. Strengthening international cooperation, harmonizing regulatory standards, and improving oversight are essential to ensuring financial stability and market integrity. Ultimately, the findings highlight the need for more consistent enforcement mechanisms, increased political will, and better resource allocation to enhance the global response to money laundering and protect the integrity of international financial systems.

VLERËSIMI I EFEKTIVITETIT TË KUADROVE LIGJORE NDËRKOMBËTARE NË LUFTËN KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE: NJË RAST STUDIMOR MBI BANKËN WACHOVIA

Kristian Nela¹
Artemis Azizaj²

Abstrakt

Qeveritë dhe organizatat përdorin kuadrot ligjore ndërkombëtare për të luftuar krimin financiar, i cili është thelbësor për mbrojtjen e mirëqenies ekonomike të një kombi. Pastrimi i parave (ML) inkurajon aktivitetet e paligjshme, dëmton besimin e investitorëve dhe manipulon tregjet financiare globale. Kjo tezë vlerëson rolin e kuadrove ligjore ndërkombëtare në luftën kundër pastrimit të parave duke hulumtuar zbatimin e forcave përkatëse të detyrës dhe organizatave, me fokus në një vlerësim kritik të një studimi rasti, konkretisht skandalin e bankës Wachovia. Studimi i këtij rasti ofron prova empirike, të cilat janë thelbësore për të përcaktuar kufizimet e zbatimit dhe pajtueshmërisë me kuadrot ligjore në nivel ndërkombëtar. Organizata të tilla si Task Forca për Veprimin Financiar (FATF), konventat e Kombeve të Bashkuara, Komiteti i Bazelit, Banka Botërore, FMN dhe IOSCO janë në vijën e parë për të përcaktuar efektivitetin e rregullimit të institucioneve financiare, zbatimin e pajtueshmërisë dhe zbutjen e krimeve financiare ndërkufitare. Gjetjet e hulumtimit tregojnë një hendek në efektivitetin e kuadrove luftuese në lidhje me pastrimin e parave, veçanërisht në aspektin e zbatimit praktik dhe bashkëpunimit ndërkufitar. Edhe pse kuadrot ligjore ndërkombëtare forcojnë mekanizmat e pajtueshmërisë ligjore, transparencën financiare dhe harmonizimin rregullator, dallimet në zbatimin

1. Student, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, kristinela17@gmail.com

2. Student, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Azizajartemisa@gmail.com

rregullator, kapacitetin institucional dhe fragmentimin juridiksional vazhdojnë të paraqesin sfida të mëdha. Hulumtimi konstaton se janë të nevojshme rregullime për të zbatuar më efektivisht ligjin dhe për të luftuar krimet financiare. Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, harmonizimi i standardeve rregullatore dhe përmirësimi i mbikëqyrjes janë thelbësore për të siguruar stabilitetin financiar dhe integritetin e tregut. Përfundimisht, këto gjetje theksojnë nevojën për mekanizma më të qëndrueshëm të zbatimit, vullnet më të madh politik dhe shpërndarje më të mirë të burimeve për të përmirësuar përgjigjen globale ndaj pastrimit të parave dhe për të mbrojtur integritetin e sistemeve financiare ndërkombëtare.

KRIMET KIBERNETIKE- ROLI I MEKANIZMAVE LIGJORE KOMBËTARE E NDËRKOMBËTARE NË LUFTËN KUNDËR SFIDAVE DIGJITALE

Dhurata Saraçi

Abstrakt

Kriminaliteti kibernetik përfaqëson një sfidë aktuale për sistemet juridike dhe institucionet e sigurisë, duke ndikuar në mënyrë të ndjeshme mbi të drejtat e individëve, stabilitetin e subjekteve tregtare dhe integritetin e institucioneve publike.

Viktimat e këtyre krimeve përballen me pasoja komplekse, duke përfshirë dëmtime të karakterit ekonomik, cenim të privatësisë, pasoja psikologjike dhe vështirësi të shumta në aksesin ndaj drejtësisë dhe mekanizmeve mbrojtës. Pavarësisht progresit në rregullimin normativ dhe politikave parandaluese, ende vërehen mangësi në efikasitetin e sistemeve ligjore për t'u përgjigjur në mënyrë adekuate ndaj këtij fenomeni. Ky punim synon të analizojë në mënyrë të hollësishme konceptin e viktimës së krimit kibernetik, duke shqyrtuar kategoritë e ndryshme të subjekteve të prekura, natyrën e pasojave që ata përjetojnë dhe sfidat juridike me të cilat përballen në kërkimin e drejtësisë.

Analiza përfshin një qasje të kombinuar normative dhe krahasimore, duke shqyrtuar legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe praktikën më efektive në mbrojtjen e viktimave të këtyre krimeve. Në kontekstin e mekanizmeve mbrojtës, studimi thekson rëndësinë e forcimit të kuadrit normativ dhe institucional, duke promovuar masa parandaluese dhe rritjen e kapaciteteve të organeve përgjegjëse për të trajtuar në mënyrë të specializuar këtë kategori kriminaliteti. Njëkohësisht, theksohet nevoja për një harmonizim më të madh të politikave ndërkombëtare dhe përmirësimin e bashkëpunimit mes

shteteve, duke siguruar një qasje të unifikuar dhe rezultative për mbrojtjen e viktimave.

Nëpërmjet konkluzioneve të arrira në bazë të studimit të kryer, synohet të kontribuohet në debatin akademik dhe politik mbi mbrojtjen e viktimave të krimit kibernetik, duke ofruar rekomandime të bazuara në analiza empirike dhe rregullative për forcimin e politikave publike dhe legjislacionit përkatës. Njohja dhe zbatimi efektiv i procedurave dhe mekanizmave ligjorë është thelbësor për të garantuar një mbrojtje efektive të të drejtave dhe lirive themelore të individëve në epokën digjitale.

Fjalë kyçe: digjitalizim, platformë, rrjet, sulm, krim kibernetik, viktimat, privatësi, mbrojtje, siguri, parandalim.

CYBERCRIMES- THE ROLE OF NATIONAL AND INTERNATIONAL LEGAL MECHANISMS IN ADDRESSING DIGITAL THREATS

Abstract

Cybercrime represents a current challenge for legal systems and security institutions, significantly impacting the rights of individuals, the stability of commercial entities, and the integrity of public institutions.

Victims of these crimes face complex consequences, including damage of their economic rights, violation of privacy, psychological consequences, and numerous difficulties in accessing justice and protective mechanisms. Despite progress in regulatory frameworks and preventive policies, there are still shortcomings in the efficiency of legal systems to adequately respond to this phenomenon. This paper aims to thoroughly analyze the concept of cybercrime victims, examining the different categories of affected subjects, the nature of the consequences they experience and the legal challenges they face in seeking justice.

The analysis includes a combined normative and comparative approach, reviewing national and international legislation, as well as the most effective practices in protecting the victims of these crimes. In the context of protective mechanisms, the study emphasizes the importance of strengthening the normative and institutional framework, promoting preventive measures, and enhancing the capacities of responsible bodies to deal with this category of crime in a specialized manner. At the same time, it highlights the need for greater harmonization of international policies and improving cooperation between states, ensuring a unified and effective approach to victim protection.

Through the conclusions reached based on the conducted study, the aim is to contribute to the academic and political debate on the

protection of cybercrime victims, offering recommendations based on empirical and regulatory analyses to strengthen public policies and relevant legislation. The recognition and effective implementation of legal procedures and mechanisms is crucial to ensuring effective protection of individuals' fundamental rights and freedoms in the digital age.

Keywords: *digitalization, platform, network, attack, cybercrime, victims, privacy, protection, security, prevention.*

LEGAL REGULATION OF MASS TOURISM: CASE STUDY ON BALANCING ECONOMIC BENEFITS, SUSTAINABLE GROWTH, AND THE PRESERVATION OF LOCAL CULTURE AND HERITAGE

Jean-Christophe Gay, PHD¹

Katarina Bjelić, Master²

Abstract

This paper examines the phenomenon of tourismophobia, understood as a sociocultural reaction to excessive tourism, and analyses the legal responses across different jurisdictions. By analysing urban regulations, constitutional rights, administrative law, and international environmental obligations, the paper focuses on the legal mechanisms that balance the right to mobility with the need to protect local communities and ecosystems. Using case studies from European cities such as Barcelona, Venice and Amsterdam, where legal restrictions have been implemented regarding short-term rentals, cruise ships and public behavior, the paper explores the legal challenges and consequences associated with excessive tourism. The paper highlights how well-defined laws can contribute to more effective tourism management by creating a legal framework that not only regulates tourism activities but also protects the rights of local communities to housing, a quality environment and the preservation of cultural identity. The legal response to tourismophobia must be comprehensive, addressing the economic, social, and ecological dimensions of tourism. By regulating short-term rental platforms such as Airbnb and Booking.com, as well as imposing limits on the

1. Full professor at Université Côte d’Azur, Nice, France. Jean-Christophe.GAY@univ-cotedazur.fr

2. Teaching assistant at Singidunum University, Belgrade, Serbia, kbjelic@singidunum.ac.rs

number of cruise ships or days on which properties can be rented to tourists, it is possible to mitigate the negative effects of excessive tourism. Furthermore, the adoption of clear and transparent laws that integrate international environmental standards can contribute to the sustainable development of tourist destinations. In conclusion, the paper suggests that the proper definition of legal frameworks and the implementation of legislative measures can be crucial in addressing the issues of mass tourism, enabling a balance between economic benefits and the rights of local populations to a healthy living space and the preservation of cultural heritage.

Key words: tourismophobia, tourism law, mass tourism regulation, sustainable tourism development

EFFECTIVENESS OF LEGAL MECHANISMS AGAINST RELIGIOUS DISCRIMINATION IN SERBIA

PhD Dijana Savić Božić¹

Abstract

In accordance with the requirements for accession to the European Union, Serbia has adopted comprehensive anti-discrimination legislation. The Law on Prohibition of Discrimination, passed in 2009, offers significant legal protection against religious discrimination. This law prohibits any form of direct or indirect discrimination based on religion or belief, as well as any unjustified distinction, exclusion. The Serbian judiciary played a vital role in maintaining religious freedom and protecting individuals from discrimination. Courts have consistently interpreted and applied anti-discrimination laws to protect the rights of religious minorities and ensure equal treatment for all citizens, regardless of their religious affiliation. Important court decisions have set important precedents in the fight against religious discrimination. In cases where religious discrimination was proven, the courts awarded compensation to the victims, sending a clear message that such acts will not be tolerated under Serbian law. The paper examines the legal framework for protection against religious discrimination in the Republic of Serbia, constitutional provisions and legal acts that protect freedom of religion and equality before the law. The analysis includes relevant international agreements and contracts, with an emphasis on the European Convention on Human Rights and its influence on Serbian legislation. In addition, the paper deals with enforcement mechanisms and the challenges they face in maintaining religious freedom and the fight against discrimination. Religious freedom and the protection of individuals against

1. Doctor of Law, Faculty of Organizational Studies EDUKA, Belgrade, dinabozic@gmail.com

discrimination based on their beliefs are fundamental human rights that are internationally recognized. The Republic of Serbia, as a multi-ethnic and multi-religious country, values and supports the principles of religious tolerance and diversity. This paper investigates the legal framework and mechanisms that exist to protect individuals from religious discrimination in the Serbian legal system. It will examine relevant legislation, court decisions and international obligations that ensure the protection of religious rights and freedoms.

Keywords: *religious discrimination, legal mechanisms, Republic of Serbia*

EFEKTIVITETI I MEKANIZMAVE LIGJORË KUNDËR DISKRIMINIMIT FETAR NË SERBI

Dr. Dijana Savić Božić¹

Abstrakt

Në përputhje me kërkesat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Serbia ka miratuar legjislacion gjithëpërfshirës kundër diskriminimit. Ligji për Ndalimin e Diskriminimit, i miratuar në vitin 2009, ofron mbrojtje të konsiderueshme ligjore kundër diskriminimit fetar. Ky ligj ndalon çdo formë të diskriminimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të bazuar në fe ose besim, si dhe çdo dallim, përjashtim të pajustificuar. Gjyqësori serb luajti një rol jetik në ruajtjen e lirisë fetare dhe mbrojtjen e individëve nga diskriminimi. Gjykatat kanë interpretuar dhe zbatuar vazhdimisht ligjet kundër diskriminimit për të mbrojtur të drejtat e pakicave fetare dhe për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare. Vendimet e rëndësishme gjyqësore kanë krijuar precedentë të rëndësishëm në luftën kundër diskriminimit fetar. Në rastet kur u vërtetua diskriminimi fetar, gjykatat u dhanë dëmshpërblime viktimave, duke dërguar një mesazh të qartë se akte të tilla nuk do të tolerohen sipas ligjit serb. Punimi shqyrton kornizën ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi fetar në Republikën e Serbisë, dispozitat kushtetuese dhe aktet ligjore që mbrojnë lirinë e fesë dhe barazinë para ligjit. Analiza përfshin marrëveshje dhe kontrata relevante ndërkombëtare, me theks në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ndikimin e saj në legjislacionin serb. Për më tepër, punimi trajton mekanizmat e zbatimit dhe sfidat me të cilat përballen në ruajtjen e lirisë fetare dhe luftën kundër diskriminimit. Liria fetare dhe mbrojtja e individëve nga diskriminimi bazuar në bindjet e

1. Doktor i drejtësisë, Fakulteti i Studimeve Organizative EDUKA, Beograd, dinabozic@gmail.com

tyre janë të drejta themelore të njeriut që njihen ndërkombëtarisht. Republika e Serbisë, si një vend multietnik dhe shumë-fetar, vlerëson dhe mbështet parimet e tolerancës dhe diversitetit fetar. Ky punim hulumton kornizën ligjore dhe mekanizmat që ekzistojnë për të mbrojtur individët nga diskriminimi fetar në sistemin ligjor serb. Ai do të shqyrtojë legjislacionin përkatës, vendimet e gjykatave dhe detyrimet ndërkombëtare që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive fetare.

Fjalët kyçe: diskriminimi fetar, mekanizmat juridikë, Republika e Serbisë

LIRIA E SHPREHJES DHE KUFIZIMET E SAJ NË KOSOVË: SFIDAT DHE ASPEKTET LIGJORE NË EPOKËN E INFORMACIONIT

Prof. Assoc. Dr. Arif Riza¹

Valeri Qatani²

Abstrakt

*Trajtimi i sfidave ligjore dhe kushtetuese që lidhen me lirinë e shprehjes në Kosovë, veçanërisht në kontekstin e zhvillimeve të fundit teknologjike dhe ndikimin e mediave digjitale. Me rritjen e informacionit dhe shpërndarjen e tij përmes platformave sociale, shqetësimet për shpërndarjen e lajmeve të rreme, fjalëve të urrejtjes dhe dezinformacionit janë bërë të njohura dhe kërkojnë një balancë të kujdesshme midis mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe sigurisë publike. Ky abstrakt do të përqendrohet në disa aspekte kyçe: **Kufizimet e lirisë së shprehjes në Kushtetutën e Kosovës:** Analiza e dispozitave kushtetuese të Kosovës që mbrojnë lirinë e shprehjes dhe të drejtat e tjera të njeriut, duke shqyrtuar kufizimet që mund të vendosen për të ruajtur rendin publik, të drejtat e individëve dhe sigurinë kombëtare. **Roli i legjislacionit kosovar për mediat dhe lajmet e rreme:** Diskutimi mbi rregullimet ligjore që adresojnë sfidat e mediave digjitale dhe kontrollin e lajmeve të rreme në Kosovë, duke shqyrtuar balancimin mes lirisë për informacion dhe masave të nevojshme për të parandaluar ndikimet negative të dezinformatës. **Përputhshmëria me standardet ndërkombëtare:** Analiza e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe standardeve të BE-së dhe të Komitetit për të Drejtat e Njeriut, që kërkojnë mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe përcaktimin e kufizimeve të saj, dhe si Kosova i integron këto parime në kuadrin e saj ligjor. Ofrimi i një pasqyre të thelluar të sfidave që përballet*

1. University “Ukshin Hoti” Prizren, Repulic of Kosovo, arif.riza@uni-prizren.com

2. Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, Republic of Kosovo, valeri.qatani1@gmail.com

Kosova në balancimin e të drejtës për liri shprehje dhe mbrojtjen e interesave të tjera publike, si dhe të provojë mundësitë për zhvillimin e një kuadri ligjor që përmbush kërkesat e sigurisë dhe të drejtat themelore në epokën e informacionit.

FREEDOM OF EXPRESSION AND ITS LIMITATIONS IN KOSOVO: CHALLENGES AND LEGAL ASPECTS IN THE INFORMATION AGE

Abstract

Addressing the legal and constitutional challenges related to freedom of expression in Kosovo, particularly in the context of recent technological developments and the impact of digital media. With the increase in information and its distribution through social platforms, concerns about the spread of fake news, hate speech and disinformation have become prominent and require a careful balance between the protection of freedom of expression and public safety. This abstract will focus on several key aspects: Limitations on freedom of expression in the Constitution of Kosovo: Analysis of Kosovo’s constitutional provisions protecting freedom of expression and other human rights, examining the limitations that can be imposed to preserve public order, individual rights and national security. The role of Kosovo’s media and fake news legislation: Discussion on legal arrangements that address the challenges of digital media and the control of fake news in Kosovo, examining the balance between freedom of information and measures needed to prevent the negative impacts of disinformation. Compliance with international standards: Analysis of international agreements and EU and Human Rights Committee standards that require the protection of freedom of expression and the definition of its limitations, and how Kosovo integrates these principles into its legal framework. Providing an in-depth overview of the challenges that Kosovo faces in balancing the right to freedom of expression and the protection of other public interests, as well as exploring opportunities for developing a legal framework that meets the requirements of security and fundamental rights in the information age.

GJENDJA E PANDEMISË DHE IMPAKTI I SAJ NË LIRINË E TUBIMIT DHE ORGANIZIMIT NË SHQIPËRI

Prof.Asoc.Dr. Ermonela Ruspi¹

Abstrakt

Pandemia COVID-19 e përballi shoqërinë njerëzore me shumë sfida. Problematikat që krijoi ishin të shumta, dhe një ndër këto ishte dhe kufizimi i të drejtave dhe lirisë themelore të njeriut. Ky punim trajton ndikimin e masave kufizuese të vendosura nga autoritetet shqiptare në kuadër të menaxhimit të krizës shëndetësore, duke analizuar balancën ndërmjet nevojës për mbrojtjen e shëndetit publik nga njëra anë dhe nga ana tjetër, respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën për lirinë e tubimit dhe organizimit. Metodrat e zbatuara në këtë studim kombinojnë analizën ligjore, shqyrtimin empirik dhe krahasimin ndërkombëtar, me objekt kryesor vlerësimin e akteve rregulluese dhe proporcionalitetin e kufizimeve në të drejtën për lirinë e tubimit dhe organizimit.

Fillimisht, studimi trajton kornizën ligjore shqiptare dhe ndërkombëtare në lidhje me lirinë e tubimit dhe organizimit, duke u fokusuar në kufizimet e lejuara gjatë emergjencave publike. Në vijim, analizohet ndikimi konkret i masave kufizuese në Shqipëri, duke trajtuar gjithashtu çështjet e transparencës, përgjegjshmërisë dhe konsultimit publik në procesin e vendimmarrjes.

Për të parandaluar përhapjen e virusit, organet shtetërore zbatuan masa të natyrës kufizuese, të cilat në disa raste shënuan tejkalim të autoritetit dhe mungesë të proporcionalitetit. Nga ana tjetër, kjo gjendje e pazakontë ka nxjerrë në pah nevojën për mekanizma më të fortë të mbrojtjes së të drejtave dhe për qasje më gjithëpërfshirëse në

1. Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, ermonelaruspi@gmail.com

hartimin e politikave emergjente.

Punimi në përmbyllje synon të japë disa rekomandime për forcimin e mekanizmave mbrojtës për të drejtat e njeriut në Shqipëri, duke propozuar hapa konkretë për garantimin e proporcionalitetit të kufizimeve dhe për promovimin e një dialogu efektiv ndërmjet aktorëve shtetërorë dhe shoqërisë civile. Për këtë qëllim, i kushtohet rëndësi balancimit ndërmjet sigurisë publike dhe lirive themelore.

Fjalë kyçe: pandemi, liri e tubimit, akt normativ, jurisprudencë, kufizime, proporcionalitet

THE PANDEMIC'S INFLUENCE ON THE RIGHT TO FREEDOM OF ASSEMBLY AND ORGANIZATION IN ALBANIA

Assoc. Prof. Dr. Ermonela Ruspi¹

Abstract

The COVID-19 pandemic faced human society with many obstacles. One of the challenges was the restriction of fundamental human rights and freedoms. This paper addresses the impact of restrictive measures imposed by the Albanian authorities in the framework of health crisis management, analysing the balance between the need to protect public health on the one hand and, on the other, respect for human rights, including the right to freedom of assembly and organization. The methods applied in this study combine legal analysis, empirical review, and international comparison to analyse regulatory acts and the proportionality of restrictions on the right to freedom.

The study initially deals with the Albanian and international legal framework regarding the right to freedom of assembly and organization, focusing on the restrictions allowed during public emergencies. Then, it analyses the concrete impact of the restrictive measures in Albania, addressing the issues of transparency, accountability, and public consultation in the decision-making process.

To prevent the spread of the virus, state bodies implemented restrictive measures, which in several cases marked an excess of authority and a lack of proportionality. On the other hand, this unusual situation has highlighted the need for stronger rights protection mechanisms and a more comprehensive approach to emergency policymaking.

1. Lecturer, "Eqrem Çabej" University, Gjirokastër, ermonelaruspi@gmail.com

In conclusion, the paper aims to provide some recommendations for strengthening the protection mechanisms for human rights in Albania, proposing concrete steps to guarantee the proportionality of restrictions and promote an effective dialogue between state actors and civil society. To this purpose, the balance between public security and fundamental rights is crucial.

Keywords: pandemic, freedom of assembly, normative act, jurisprudence, restrictions, proportionality

GJYKIMI INCIDENTAL NË ASPEKTIN KUSHTETUES

Docent Valentina Kondili¹

Dr. Jonida Kondili²

Abstrakt

Kontrolli kushtetues në Shqipëri ka lindur me krijimin e Gjykatës Kushtetuese (në vijim Gjykata) në vitin 1992. Në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991, të ndryshuar me ligjin nr. 7561, datë 29.04.1992 "Për dispozitat kryesore Kushtetuese" u përcaktua juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese, funksionet si dhe subjektet nismëtarë të kontrollit kushtetues. Në rrethin e subjekteve që mund të vinin në lëvizje Gjykatën Kushtetuese u përcaktuan dhe gjykatat. Gjykata në rast se gjatë gjykimit të çështjes arrinte në përfundimin se akti normativ nuk pajtohej me ligjin "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe me ligjet e tjera, asaj i lindi e drejta të pezullonte gjykimin dhe t'ia dërgonte materialet e çështjes për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese. Fillimisht gjykonte papajtueshmërinë e akteve normative nënligjore me Kushtetutën dhe me ligjin. Aktualisht me miratimin e kushtetutës dhe konkretisht në nenin 134, shkronja "d" të saj, u përcaktuan subjektet që mund të venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Si subjekt për kontrollin kushtetues është përcaktuar çdo gjykatë e juridiksionit të zakonshtëm (duke nënkuptuar gjyqtarët). Bazuar në nenin 145, pika 2 të Kushtetutës gjyqtarët kur çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye në këtë punim do të trajtohet instituti i gjykimit incidental në aspektin e zhvillimit të tij historik dhe teorik, do të evidentohet jurisprudenca kushtetuese, si dhe problematikat e dala në zbatim

1. Lektore pranë Universitetit "Luarasi", valentina.kondili@luarasi-univ.edu.al

2. Këshilltare ligjore në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

të gjykimit incidental sidomos lidhur me kristalizimin e kritereve që gjykatat duhet të kenë parasysh për të parashtruar rastin për gjykim përpara Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata nismëtare e gjykimit incidental duhet të përcaktojë qartë dispozitat e ligjit që janë të papajtueshme me Kushtetutën, duke evidentuar në vendim dispozitën dhe shkaqet konkrete për të cilat kërkohet shfuqizimi i saj, si dhe të parashtrrojë argumente juridike, të cilat jo gjithmonë kanë qenë të plota ose në nivel kushtetues.

Një trajtim specifik lidhur me problematikat e evidentuara në praktikë do të bëhet duke patur parasysh praktikën gjyqësore në përgjithësi, praktikën e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë si dhe praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Trajtimet e adresuara në këtë punim synojnë evidentimin e përmbajtjes të këtij instituti, për rrjedhojë përmirësimin e cilësisë së gjykimit lidhur me çështje të kësaj natyre.

Fjalë Kyçe: Gjykata, Gjykata Kushtetuese, juridiksioni kushtetues, kontrolli kushtetues, gjykimi incidental.

INCIDENTAL JUDGMENT IN THE CONSTITUTIONAL TERMS

Docent Valentina Kondili¹

PHD. Jonida Kondili²

Abstract

Constitutional review in Albania was established with the establishment of the Constitutional Court in 1992. Law no. 7491, dated 29.04.1991, amended by law no. 7561, dated 29.04.1992 "On the main constitutional provisions", defined the jurisdiction of the Constitutional Court, its functions and the initiating subjects of constitutional review. The courts were also defined as subjects that could initiate proceedings before the Constitutional Court. If the Court, during the trial of the case, concluded that the normative act did not comply with the law "On the main constitutional provisions" and other laws, it had the right to suspend the trial and send the case materials to the Constitutional Court for review. Initially, it judged the incompatibility of normative sub-legal acts with the Constitution and the law. Currently, with the adoption of the Constitution the subjects that can initiate the Constitutional Court are determined in the article 134, point 1, letter "d". Any court of ordinary jurisdiction (meaning judges) has been determined as a subject for constitutional control. Based on article 145, point 2 of the Constitution, when judges consider that laws are contrary to the Constitution, they do not apply them. In this case, they suspend the trial and send the case before the Constitutional Court. For this reason, this paper will address the institute of incidental trial in terms of its historical and theoretical development, will highlight constitutional jurisprudence, as well as the problems that have

1. Lecturer at "Luarasi" University, valentina.kondili@luarasi-univ.edu.al

2. Legal Advisor at the Constitutional Court of Albania

arisen in the implementation of incidental trial, especially regarding the crystallization of the criteria that courts must take into account in submitting a case for trial before the Constitutional Court.

The court initiating the incidental trial must clearly determine the provisions of the law that are incompatible with the Constitution, highlighting in the decision the provision and the concrete reasons for which its repeal is requested, as well as present/concret legal arguments, which have not always been complete or argued at a constitutional level.

A specific treatment regarding the issues identified in practice will be done taking into account the judicial practice in general, the practice of the Supreme Court of the Republic of Albania as well as the practice of the Constitutional Court of the Republic of Albania.

This paper aim to highlight the content of this institute, consequently improving the quality of judgment regarding issues of this nature.

Keywords: Court, Constitutional Court, constitutional jurisdiction, constitutional review, incidental judgment.

LIRIA E SHPREHJES NË EPOKËN DIGJITALE: SFIDAT, KUFIZIMET DHE BALANCA E DREJTAVE

PhD (c) Erinda Ballanca¹

Abstrakt

Liria e shprehjes është një nga shtyllat e shoqërive demokratike, duke u garantuar individëve të drejtën për të shprehur mendimet e tyre dhe të drejtën për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pa kufizime shtetërore. Ndërsa liria e mendimit është një e drejtë absolute dhe e patjetërsueshme, që nuk mund të kufizohet në asnjë rrethanë, liria e shprehjes së mendimit nuk gëzon të njëjtën paprekshmëri; megjithatë, teksa teknologjia përparon dhe platformat digjitale bëhen forma dominuese të komunikimit, kufijtë e lirisë së shprehjes janë bërë më të ndërlikuar. Epoka digjitale ka sjellë sfida të reja dhe ka transformuar diskursin publik, si dhe ndërveprimin me publikun, duke ngritur pyetje thelbësore mbi kufijtë e shprehjes së lirë dhe rreziqet që lidhen me abuzimin ose keqpërdorimin e kësaj të drejte. Ky punim eksploron dimensionet e lirisë së shprehjes në epokën digjitale, duke analizuar ndërthurjen e kuadrit rregullator shtetëror, me kufizimet e nevojshme, ndërsa shqyrton balancën komplekse mes mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe adresimit të mundësive për dëmet që vijnë nga keqpërdorimi i kësaj të drejte. Punimi shqyrton sfida kyçe si dezinformimi, gjuha e urrejtjes dhe pasojat e heshtjes disproporcionale të grupeve të marginalizuara. Gjetjet tregojnë nevojën për një qasje që balancon mbrojtjen e lirisë së shprehjes me nevojën për të parandaluar dëmet, duke theksuar rëndësinë e transparencës, përgjegjshmërisë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në qeverisjen digjitale. Ky hulumtim kontribuon në debatin e

1. Avokate e Popullit, Doktorante pranë Departamentit të së Drejtës Publike, FDUT, erinda.ballanca.dr@gmail.com

vazhdueshëm mbi ndërthurrjen e të drejtave themelore të njeriut dhe të drejtave digjitale, me qëllimin për të promovuar një hapësirë publike digjitale më gjithëpërfshirëse dhe të drejtë.

Fjalë kyçe: Liria e Shprehjes; Balanca e të drejtave; Platformat digjitale; Të drejtat e njeriut;

FREEDOM OF EXPRESSION IN THE DIGITAL AGE: CHALLENGES, LIMITATIONS AND THE BALANCE OF RIGHTS

Abstract

Freedom of speech is a cornerstone of democratic societies, guaranteeing individuals the right to express their opinions and the right to receive or impart information and ideas without interference by public authorities and without state restrictions. While freedom of thought is an absolute and inalienable right that cannot be limited under any circumstances, freedom of expression does not enjoy the same inviolability; however, as technology advances and digital platforms become dominant forms of communication, the boundaries of free speech have become more complicated. The digital era has introduced new challenges and has reshaped public discourse as well as public outreach, raising critical questions about the boundaries of free expression and the risks associated to the improper or misuse of such right. This paper explores the dimensions of freedom of speech in the digital age, analyzing the intersection of state regulations, along with the necessary limitations, while examining the complex balance between safeguarding individual expression and addressing the potential harms caused by misuse of this right. It examines key challenges such as misinformation, hate speech, and the aftermath of disproportionate silencing of marginalized voices. Findings reveal the need for an approach that balances the protection of free expression with the need to prevent harm, emphasizing the importance of transparency, accountability, and international cooperation in digital governance. This research contributes to the ongoing debate on the intersection between fundamental human rights and digital rights, aiming to foster a more inclusive and equitable online public sphere.

Keywords: *Freedom of speech; Balance of rights; Digital platforms; Human rights;*

PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË. BALANCIMI I KUFIZIMEVE LIGJORE NË RAPORT ME TË DREJTAT E NJERIUT

Dr.Fjorida Ballauri¹

Abstrakt

Në kuadër të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 në Shqipëri, sistemi gjyqësor kaloi nën një reformim të thellë qoftë në aspektin e organizimit dhe funksionimit ashtu edhe në elementë që prekën statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të cilët tashmë ligji përdor termin e njësuar “magjistratë”. Në mënyrë të veçantë, ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ka sanksionuar kufizime të interesave private të magjistratëve për shkak të funksionit të tyre, duke iu referuar në mënyrë specifike për zbatim rregullimeve të parashikuar në ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave.

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, ka parashikuar një sërë ndalimesh për gjyqtarët, prokurorët dhe familjarët e tyre, të cilat do të jenë objekt i analizës ligjore në këtë punim. Qëllimi i këtij artikulli është kryerja e një analizë ligjore dhe vlerësimi modest i autorit, nëse ekziston një balancë e drejtë midis kufizimeve të interesave private që legjislacioni shqiptar ka parashikuar për magjistratët dhe personat e lidhur me ta, në raport me të drejtat e individit.

Fjalë kyçe: *sistem i drejtësisë, konflikt interesi, magjistrat, kufizim, të drejtat e njeriut*

1. Këshilltare Ligjore në Institucionin e Presidentit të Republikës, Pedagoge e jashtme në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë, Tiranë. fjori.k@gmail.com

PREVENTION OF CONFLICT OF INTEREST IN THE JUSTICE SYSTEM. BALANCING LEGAL CONSTRAINTS IN RELATION TO HUMAN RIGHTS

Dr.Fjorida Ballauri¹

Abstract

In the framework of the 2016 constitutional amendments in Albania, the judicial system underwent a profound reform both in terms of organization and functioning, also in elements that affected the status of judges and prosecutors, for whom the law now uses the unified term "magistrates". In particular, the law on the status of judges and prosecutors in the Republic of Albania has sanctioned restrictions on the private interests of magistrates due to their function, referring specifically to the implementation of the regulations provided for in the Law on the Prevention of Conflict of Interest.

In the Law on the Prevention of Conflict of Interest, there are foreseen a series of prohibitions for judges, prosecutors and their family members, which will be the subject of legal analysis in this paper. The purpose of this article is a legal analysis and modest assessment of the author, whether there is a fair balance between the limitations of private interests that Albanian legislation has provided for magistrates and persons associated with them, in relation to the human rights.

Keywords: justice system, conflict of interest, magistrates, restriction, human rights

1. Advisor to the President, the Institution of the President of the Republic of Albania, Lecturer, at the Faculty of Security and Investigation, Security Academy, Tirana, fjori.k@gmail.com

KUADRI LIGJOR NË SHQIPËRI SI DHE PRAKTIKAT E DISA VENDEVE PËR AMNISTINË FISKALE DHE PENALE

Prof. Asoc. Dr. Naim TOTA, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës¹
Jura ÇITOZI, Studente, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë²

Abstrakt

Amnistia fiskale është një mjet politik dhe ligj që përdoret nga qeveritë për të lehtësuar barrën financiare të tatimpaguesve dhe për të stimuluar përmbushjen e detyrimeve fiskale. Në shqipëri, amnistia fiskale ka qenë një temë e diskutueshme dhe e zbatuar në mënyrë periodike, duke synuar reduktimin e borgjeve tatimore dhe nxitjen e formalizimit të ekonomisë.

Të gjitha programet e amnitive fiskale parimisht synojnë të nxisin taksapaguesit, të cilët kanë shkëlur ligjin që të rregullojnë vullnetarisht çështjet e tyre tatimore në këmbim të një shkalle mbrojtjeje nga ndjekja ligjore. Programet e deklarimit vullnetar të pasurive dallojnë nga amnistitë e drejtpërdrejta të taksave, pasi rezultati i pritur në rastin e parë nuk është falja e plotë apo e pjesshme e detyrimeve tatimore, por deklarimi i të ardhurave dhe pasurive të padeklaruara më parë, si pjesë e një strategjie kombëtare të përmirësimit të përputhjes me detyrimet fiskale.

Ky punim analizon kuadrin ligjor të amnitive fiskale në shqipëri, duke marrë në konsideratë ligjet dhe rregulloret e fundit, si dhe efektet e tyre në ekonominë vendase.

Përveç kësaj, puninmi bën një krahasim të kuadrit ligjor dhe të politikave të amnitive fiskale në Shqipëri me ata të disa vendeve të tjera si psh Italia, Greqia, Spanja, Turqia, Afrika e Jugut. Nepërmjet

1. Prof. Asoc. Dr. Avokat. Naim TOTA, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Adresa Email: naimtota@yahoo.com

2. Jura ÇITOZI, Studente, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, Adresa Email: juracitozi16@gmail.com

këtij krahasimi, identifikohen pikat e forta dhe të dobëta të sistemit shqipëtar, si dhe mësimet që mund të nxirren nga përvoja e vendeve të tjera. Në veçanti, analizohen aspekte si kriteret e përcaktimit të borxheve të amnistuara, procedurat e aplikimit dhe efektet afatgjata në ekonominë kombëtare.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të pasqyrojë disa modele të rregullimit ligjor që disa shtete evropiane dhe më gjerë kanë për kryerjen e programeve të amnistisë përmes deklarimit vullnetar të pasurive të padeklaruara, subjektet përfituese, niveli i taksës që aplikohet dhe kohëzgjatja e amnistisë.

Përfundimisht punimi ofron rekomandime për përmirësimin e politikave të amnistive fiskale në shqipëri, duke theksuar nevojën për një qasje më të qëndrueshme dhe transparente, që të siguroj një bilanc midis interesave të shtetit dhe të tatimpaguesve. Nepërmjet kësaj analize, synohet të kontribuohet në debatin publik dhe në procesin e vendimmarrjes në fushën e politikave fiskale.

Fjalë kyçe: Amnistia fiskale, barra financiare, kuadri ligjor, subjektet përfituese, detyrimet tatimore etj..

THE LEGAL FRAMEWORK IN ALBANIA AND THE PRACTICES OF SOME COUNTRIES REGARDING FISCAL AND CRIMINAL AMNESTY

Assoc. Prof. Dr. Naim TOTA, “Aleksandër Moisiu” University, Durrës¹
Jura ÇITOZI, Student, Faculty of Law, Tirana²

Abstract

Fiscal amnesty is a political and legal tool used by governments to ease the financial burden of taxpayers and to stimulate the fulfillment of fiscal obligations. In Albania, fiscal amnesty has been a controversial and periodically implemented topic, aiming to reduce tax debts and encourage the formalization of the economy.

All fiscal amnesty programs principally aim to encourage taxpayers who have broken the law to voluntarily resolve their tax matters in exchange for a degree of protection from legal prosecution. Voluntary asset declaration programs differ from direct tax amnesties, as the expected outcome in the first case is not the full or partial forgiveness of tax obligations, but the declaration of previously undeclared income and assets as part of a national strategy to improve compliance with fiscal obligations.

This paper analyzes the legal framework of fiscal amnesties in Albania, taking into consideration the latest laws and regulations, as well as their effects on the domestic economy.

Furthermore, the paper makes a comparison of the legal framework and fiscal amnesty policies in Albania with those of some other countries such as Italy, Greece, Spain, Turkey, and South Africa. Through this comparison, the strengths and weaknesses of the

1. Assoc. Prof. Dr. Naim TOTA, “Aleksandër Moisiu” University, Durrës, Email Address: naimtota@yahoo.com

2. Jura ÇITOZI, Student, Faculty of Law, Tirana, Email Address: juracitozi16@gmail.com

Albanian system are identified, as well as the lessons that can be learned from the experience of other countries. In particular, aspects such as the criteria for determining forgiven debts, the application procedures, and the long-term effects on the national economy are analyzed.

The main objective of this paper is to reflect on several models of legal regulation that some European and other countries have for carrying out amnesty programs through the voluntary declaration of undeclared assets, the beneficiary subjects, the level of tax applied, and the duration of the amnesty.

Finally, the paper offers recommendations for improving fiscal amnesty policies in Albania, emphasizing the need for a more sustainable and transparent approach that ensures a balance between the interests of the state and those of taxpayers. Through this analysis, the aim is to contribute to the public debate and the decision-making process in the field of fiscal policy.

Keywords: *Fiscal amnesty, financial burden, legal framework, beneficiary subjects, tax obligations, etc..*

STUDIMET E SIGURISE DHE ELITA ME KULTURE STRATEGJIKE SI DOMOSDOSHMERI PËR FUQIZIMIN E SIGURISË KOMBËTARE DHE ZHVILLIMIN E VENDIT.

Dr. Ardian Elezi¹

Abstrakt

Siguria konsiderohet, njëherazi një vlerë ekzistenciale dhe universale si dhe një koncept shumë kompleks, perceptimi e realizimi i saj është tashmë detyrë e përgjegjësi e aktorëve të shumtë kombëtar e ndërkombëtar. Bota që njihnim para pandemisë, para konflikteve të armatosura në disa pjesë të globit nuk është si më parë. Ajo sot është në një proces ndryshimi afatgjatë dhe me paparashkueshmëri, ku vet koncepti dhe mjedisi i sigurisë janë në evolucion të vazhdueshëm i cili mbart me vete kulme, sfida, rreziqe, kriza e pasiguri, të cilat përfshijnë gjithë botën, ku “pasiguria me dilemat e vet do të jetë realitet i përhershëm, ndërsa përpjekja për siguri kombëtare është e do të jetë një preokupim i vazhdueshëm që na shoqëron në mënyrë permanente gjithë ne dhe sidomos gjithë aktorët shtetëror e vendimarrësit përgjegjës për të”. Vendi i ynë si gjithë vendet e shtetet e vogla duhet të kuptojnë se siguria e tyre zë fill së pari në brenda nesh, ambjentit të shtëpisë ku jetojmë, se janë vetë ato që duhet të identifikojnë dhe zgjidhin problemet, sfidat e vakumet e tyre në fushën e sigurisë.

Ne një mjedis sigurie tejet dinamik, ku skenarët ndryshojnë vazhdimisht dhe procesi bëhet gjithnjë e më kompleks, mënyra më efektive për t’iu përgjigjur, është të përgatitesh për ndryshimin. Në vendet e zhvilluara në perëndim dhe kudo gjetke që drejtohen nga lider të përgjegjshëm, ndjeshmëria dhe angazhimi i elitave në

1. Dr Ardian Elezi, pedagog prane Universitetit Luarasi

studimet e sigurisë është tashmë prioritet e domen i tyre, të cilat me angazhimet e kontributet e tyre intelektuale, patriotike e kombetare u rekomandojnë institucioneve vendimarrëse skenar të ndryshëm e të shumtë për parashikueshmërinë e së ardhmës, zgjidhje racionale për politika e strategji sigurie efektive dhe dobiprurëse. Në kuader dhe te proceseve integruese dhe partneriteteve bashkëpunuese si dhe për të operuar me të njëjtin standard me partnerët, por edhe për të harmonizuar mënyrën e veprimit në nivel kombëtar, e vetmja rrugë për të përballuar sfidat shumëplanëshe në fushën e sigurisë mbetet arsimimi, kualifikimi dhe trajnimi me programe bashkëkohore, ngritja e qendrave të analizës e studimeve strategjike të njehesura në nivel kombëtar, krijimi e konsolidimi i një elite me një kulturë strategjike në këtë fushë.

Në epokën e inteligjencës artificiale dhe transformimeve të shpejta teknologjike, elitat intelektuale, politike, liderët duhet të kenë një vizion që shkon përtej kufijve tradicionalë të politikës. Studimet lidhur me sigurinë kombëtare gjithnjë e më shumë e vënë theksin te rëndësia e kulturës e cila ngelet një element shumë i rëndësishëm i strategjisë së sigurisë si dhe në çështjet ndërkombëtare. Kultura strategjike është një mënyrë alternative për të shpjeguar sjelljen strategjike. Cdo shtet dhe institucion sigurie ka një kulturë strategjike, ku elitat të mbrojtura prej saj janë ato që përcaktojnë vizionin e platformën e tyre për të ardhmen e një vendi.

Në hapsiren shqiptare këto studime janë të rralla dhe të pavlerësuara nga lidërsia politike i cili ka manifestuar mungesë të theksuar kulturore të sigurisë, çka shpesh ka përbërë rrezik e kërcënim për stabilitetin dhe zhvillimin e vendit. Pergatitja e elitave me kulturë strategjike, rivlerësimi e fuqizimi i institucioneve, akademike, vlerësimi i arsimit me fokus promovimin e kurrikulave që lidhen me çështje të sigurisë kombëtare, krijimi i mjedisit të ngrohtë dhe realizimi i një kulturore bashkëpunuese institucionale dhe intelektuale mbetet njëherazi sfidë e domosdoshmëri për sigurinë kombëtare e zhvillimin e vendit. Siguria ne kompleksitetin e elementeve të vet, duke përfshirë dhe ato individuale në larmishmërinë e vet, sigurisë juridike që lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, , analiza e mjedisit të sigurisë që gjithnjë ndryshon me sfida e kërcënimet që

paraqiten, një ridimension i tyre, si paraqitet realiteti dhe pervoja shqiptare ne ecurine e rrugtimin e vet, studimet e sigurise si roli dhe kontributi i elitave me një kulture strategjike si nje domosdoshmëri për sigurinë kombëtare dhe zhvillimin dhe fuqizimin e vendit, ndër të tjera jane disa nga ceshtjet objekt i kësaj trajtese.

Fjalë kyçe: marrëdhënie ndërkombëtare, siguri kombëtare, studime të sigurisë, siguria individuale, juridike, elitat intelektuale, vend i vogël ,mjedis i sigurise,kulture strategjike, kulture bashkëpunuese, zhvillim i vendit etj

SECURITY STUDIES AND ELITES WITH STRATEGIC CULTURE AS NECESSITIES FOR STRENGTHENING NATIONAL SECURITY AND DEVELOPING THE COUNTRY

Dr. Ardian Elezi¹

Abstract

Security is considered, at the same time, an existential and universal value as well as a very complex concept, its perception and realization is now the duty and responsibility of many national and international actors. The world we knew before the pandemic, before the armed conflicts in some parts of the globe is not the same as before. Today it is in a process of long-term and unpredictable change, where the concept and environment of security itself are in continuous evolution which carries with it peaks, challenges, risks, crises and uncertainty, which include the entire world, where "insecurity with its dilemmas will be a permanent reality, while the effort for national security is and will be a continuous preoccupation that permanently accompanies all of us and especially all state actors and decision-makers responsible for it". Our country, like all small countries and states, must understand that their security begins first within us, in the home environment where we live, that it is we ourselves who must identify and solve our problems, challenges, and vacuums in the field of security.

In a highly dynamic security environment, where scenarios are constantly changing and the process becomes increasingly complex, the most effective way to respond is to prepare for change. In developed countries in the West and elsewhere that are led by responsible leaders, the sensitivity and engagement of elites in security studies is now a priority and their domain, which with their

1. Dr. Ardian Elezi, pedagogue at Luarasi University

intellectual, patriotic and national commitments and contributions recommend to decision-making institutions different and numerous scenarios for the predictability of the future, rational solutions for effective and beneficial security policies and strategies. In the framework of integration processes and cooperative partnerships, as well as to operate with the same standard with partners, but also to harmonize the way of acting at the national level, the only way to face the multifaceted challenges in the field of security remains education, qualification and training with contemporary programs, the establishment of nationally recognized centers of analysis and strategic studies, the creation and consolidation of an elite with a strategic culture in this field.

In the era of artificial intelligence and rapid technological transformations, intellectual and political elites, leaders must have a vision that goes beyond the traditional boundaries of politics. Studies related to national security increasingly emphasize the importance of culture, which remains a very important element of security strategy as well as in international affairs. Strategic culture is an alternative way to explain strategic behavior. Every state and security institution has a strategic culture, where the elites formed by it are the ones who determine their vision and platform for the future of a country.

In the Albanian space, these studies are rare and unappreciated by the political leadership, which has manifested a pronounced lack of security culture, which has often constituted a risk and threat to the stability and development of the country.

The preparation of elites with a strategic culture, the reassessment and strengthening of academic institutions, the assessment of education with a focus on promoting curricula related to national security issues, the creation of a warm environment and the realization of a cooperative institutional and intellectual culture remains both a challenge and a necessity for national security and the development of the country. Security in the complexity of its elements, including the individual one in its diversity, legal security related to the protection of fundamental human rights and freedoms, the analysis of the security environment that is always changing with

the challenges and threats that arise, a re-dimension of them, how the Albanian reality and experience are presented in its progress and path, security studies as the role and contribution of elites with a strategic culture as a necessity for national security and the development and strengthening of the country, among others, are some of the issues that are the subject of this treatise.

Keywords: *international relations, national security, security studies, individual security, legal security, intellectual elites, small country, security environment, strategic culture, cooperative culture, national development, etc.*

ANALIZË KRAHASIMORE E SË DREJTËS ADMINISTRATIVE NË EVROPËN JUGLINDORE DHE BE

Dr. Dael Dervishi¹
Fatmir Latifi²

Abstrakt

Ky punim trajton në mënyrë krahasimore të drejtën administrative në rajonin e Evropës Juglindore (Shqipëri, Kosovë dhe Serbi) dhe vendet e Bashkimit Evropian (Gjermani, Francë dhe Itali). Objektivi kryesor është të identifikojë dallimet, ngjashmëritë, dhe praktikat më të mira që mund të shërbejnë si modele për përmirësimin e administratës publike në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Analiza përqendrohet në strukturën dhe organizimin institucional të administratës publike, mekanizmat e kontrollit administrativ dhe gjyqësor, transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve publike, si dhe ndikimin e drejtpërdrejtë të standardeve të Bashkimit Evropian në reformimin e sistemeve administrative në rajon. Studimi nxjerr në pah se, ndërsa vendet e Ballkanit kanë harmonizuar kuadrin e tyre ligjor dhe institucional me standardet evropiane, zbatimi praktik dhe krijimi i një kulture të qëndrueshme të llogaridhënies dhe integritetit mbeten sfidë kyçe. Në fund, jepen rekomandime konkrete duke u bazuar në praktikat e mira të vendeve anëtare të BE-së, si p.sh. forcimi i kontrollit gjyqësor administrativ, zbatimi efektiv i vendimeve gjyqësore kundër administratës, digjitalizimi dhe transparenca proaktive, si dhe promovimi i meritokracisë dhe profesionalizmit në administratë.

Fjalë kyçe: *E drejta administrative, administrata publike, analiza krahasimore, transparenca, llogaridhënia, standardet e BE-së, reforma administrative.*

1. Pedagog pranë Universitetit Luarasi, dael.dervishi@luarasi-univ.edu.al

2. Student pranë Universitetit Luarasi, fatmir.latifi@luarasi-univ.edu.al

COMPARATIVE ANALYSIS OF ADMINISTRATIVE LAW IN SOUTHEASTERN EUROPE AND THE EU

Abstract

This paper comparatively examines administrative law in the Southeast European region (Albania, Kosovo, and Serbia) and selected European Union countries (Germany, France, and Italy). Its primary objective is to identify differences, similarities, and best practices that can serve as models for enhancing public administration in the Western Balkans. The analysis focuses on the institutional structure and organization of public administration, mechanisms of administrative and judicial oversight, transparency and accountability of public authorities, as well as the direct influence of European Union standards on administrative reforms in the region. The study highlights that while Balkan countries have harmonized their legal and institutional frameworks with EU standards, practical implementation and fostering a sustainable culture of accountability and integrity remain key challenges. Finally, concrete recommendations are provided based on EU member states' best practices, such as strengthening administrative judicial review, effective enforcement of court decisions against administrative bodies, digitalization and proactive transparency, and the promotion of meritocracy and professionalism within public administration.

Keywords: Administrative law, public administration, comparative analysis, transparency, accountability, EU standards, administrative reform

SFIDAT E INTEGRIMIT EVROPIAN TË QEVERISJES VENDORE DHJETË VITE PAS REFORMËS ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE

Dr. Vera Shtjefni¹

Abstrakt

Shqipëria, si vend kandidat në Bashkimin Evropian, po vijon negociatat me objektivin për t'u anëtarësuar në BE deri në vitin 2030. Dhjetë vite më parë përfundoi Reforma Administrative-Territoriale dhe filloi funksionimi i njësive të qeverisjes vendore dhe organeve të tyre të dala nga zgjedhjet vendore 2015. Njësitë e Qeverisjes vendore kanë një rol të rëndësishëm në Bashkimin Evropian. Në BE mbi 70% e legjislacionit komunitar zbatohet në nivel vendor. Njësitë vendore të vendeve të BE janë pjesë e bashkëpunimit horizontal mes tyre sikurse edhe atij vertikal me institucionet e BE.

Ne fokus të punimit do të jetë analiza e arritjeve dhe problematikave kryesore të njësive të qeverisjes vendore në këto 10 vite për përmbushjen e funksioneve të tyre, roli i munguar i qarqeve si njësi të nivelit të dytë si dhe hapat ligjorë dhe institucionalë. Periudha deri në anëtarësimin në BE do të ketë sfida, jo vetëm për të përmbushur standartet ligjore dhe institucionale, por që këto njësi vendore të organizohen, funksionojnë dhe performojnë si njësitë e vendeve të tjera anëtare të BE.

Ky punim synon të kontribuojë në evidentimin e rolit thelbësor që ka qeverisja vendore në përmbushjen e objektivave dhe sfidave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Procesi i anëtarësimit në BE është një mundësi e shkëlqyer për të analizuar ecurinë e qeverisjes vendore në këto vite dhe për të vijuar me reformën ligjore e institucionale për

1. Personel akademik me kohë të plotë, Departamenti i të Drejtës Publike, Fakulteti Drejtësisë, Universiteti i Tiranës , vera.shtjefni@unitir.edu.al

një model funksional që përmbush standartet më të larta të qeverisjes vendore të vendeve të BE.

Ky punim nuk i drejtohet vetëm botës akademike, por aktorëve të tjerë e qeverisjes qendrore dhe vendore, shoqërisë civile dhe profesionistëve për të nxitur reformën e qeverisjes vendore në Shqipëri.

CHALLENGES OF EUROPEAN INTEGRATION OF LOCAL GOVERNMENT TEN YEARS AFTER THE ADMINISTRATIVE-TERRITORIAL REFORM

Abstract

Albania, as a candidate country in the European Union, is in negotiation process with the objective of joining the EU by 2030. Ten years ago, the Administrative-Territorial Reform was completed and the functioning of local government unit and their bodies resulting from the 2015 local elections has begun. Local Government have an important role in the European Union. In the EU, over 70% of Acquis Communautaire is implemented at the local level. Local Government of EU countries is part of horizontal cooperation among themselves as well as vertical cooperation with EU institutions.

The focus of the paper will be the analysis of the achievements and main problems of local government in these 10 years in fulfilling their functions, the missing role of regions as second-level Local Government, as well as legal and institutional steps. The period leading up to EU membership will have challenges, not only to meet legal and institutional standards, but also for Local Government to be organized and perform like the Local Government of other EU member states.

This paper aims to contribute to highlighting the essential role that local government has in fulfilling the objectives and challenges of Albania's EU membership. The EU membership process is an excellent opportunity to analyse the performance of local government in these years and to continue with legal and institutional reform for a functional model that meets the highest standards of local government in EU countries.

This paper is not only addressed to the academic researcher, but also to other central and local government actors, civil society, and professionals to promote local government reform in Albania.

EXTERNAL PRESSURES, INTERNAL REALITIES: THE 2016 ALBANIAN JUDICIAL REFORM AND THE MULTIFACETED IMPACT OF INTERNATIONAL ORGANIZATIONS ON RULE OF LAW DEVELOPMENT

PhD. Nertil Berdufi¹

Phd (C) Jetnor Kasmi²

Abstract

This paper examines the dual role of international organizations (IOs) and developed countries in shaping rule of law (RoL) reforms in developing states, critiquing the “false paradigm” of externally imposed governance models and emphasizing the interplay between international influence and domestic authorship.

Through a case study of Albania’s 2016 judicial reform—a process driven by EU conditionality and U.S. support—the study argues that while IOs are indispensable in overcoming institutionalized corruption and political resistance, sustainable progress requires reconciling external accountability mechanisms with local ownership.

Despite measurable successes, including the dismissal of corrupt judges and the establishment of anti-corruption bodies, the reform’s legitimacy and pace remain contested due to technocratic overreach, performative compliance by elites, and societal skepticism of foreign-driven agendas. The paper concludes that RoL promotion must navigate the tension between international

1. Assistant Professor at Western Balkans University in Tirana, Albania, nertilberdufi@gmail.com

2. Program Officer at the International Commission on Missing Persons (ICMP), jetnor92@gmail.com

norms and contextual realities, prioritizing hybrid frameworks that empower domestic reformers without replicating neo-colonial dependencies.

Key Words: Rule of Law (RoL), International Organizations (IOs), False Paradigm, EU Accession Conditionality, Corruption in Post-Communist States, Domestic Ownership of Reforms, Albanian Justice Reform

**PRESIONET E JASHTME, REALITETET E
BRENDSHME: REFORMA NË DREJTËSI NË
SHQIPËRI 2016 DHE NDIKIMI I SHUMËANSHËM
I ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE NË
ZHVILLIMIN E SUNDIMIT TË LIGJIT**

Abstrakt

Ky punim shqyrton rolin e dyfishtë të organizatave ndërkombëtare dhe vendeve të zhvilluara në formësimin e reformave për shtetin e së drejtës në shtetet në zhvillim, duke kritikuar “paradigmën e rreme” të modeleve të qeverisjes të imponuara nga jashtë dhe duke theksuar ndërveprimin midis ndikimit ndërkombëtar dhe autorësisë vendase. Përmes një studimi rasti mbi reformën gjyqësore të Shqipërisë në vitin 2016—një proces i nxitur nga kushtëzimi i BE-së dhe mbështetja e SHBA-së—studimi argumenton se, ndonëse organizatat ndërkombëtare janë të pazëvendësueshme për kapërcimin e korrupsionit të institucionalizuar dhe rezistencës politike, zhvillimi i qëndrueshëm kërkon harmonizimin e mekanizmave të jashtëm të llogaridhënies me autorsine lokale ndaj reformave. Pavarësisht suksesit të matshëm, duke përfshirë shkarkimin e gjyqtarëve të korruptuar dhe krijimin e organeve kundër korrupsionit, legjitimiteti dhe ritmi i reformës mbeten të debatueshme për shkak të ndërhyrjeve teknokratike, konformitetit performativ të elitave dhe skepticizmit shoqëror ndaj agjendave të drejtuara nga jashtë. Punimi konkludon se promovimi i shtetit të së drejtës duhet të navigojë mes tensioneve midis normave ndërkombëtare dhe realiteteve kontekstuale, duke i dhënë përparësi kornizave hibride që fuqizojnë reformatorët vendas pa riprodhuar varësi neokoloniale.

ZHVILLIMI I AFTËSIVE KOMUNIKUESE TË NDËRMJETËSVE DHE I TEKNIKAVE TË DOMOSDOSHME NË PROCESIN NEGOCIUES DHE NDËRMJETËSUES

PhD. Drita Avdyli¹

Abstrakt

Procesi i ndërmjetësimit është një mekanizëm i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, është një proces i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve realizohet përmes komunikimit ndërmjet dy ose më shumë palëve që kërkojnë të bëjnë zgjedhje për çështje të përbashkëta nëpërmjet komunikimit. Ky komunikim është një proces i shkëmbimit të informacioni ndërmjet dy ose më shumë palëve por shumë njerëz e marrin për të mirëqenë rolin e komunikimit në marrëdhëniet e tyre (nuk tregojnë shumë kujdes). Ata që duan të bëhen ndërmjetës duhet ta konsiderojnë komunikimin si një fushë shumë të vlefshme analize dhe praktike por mbi të gjitha, ndërmjetësit, jo vetëm që duhet të kenë aftësi shumë të mira komunikuese për të kuptuar një mosmarrëveshje dhe për të lidhur palët, por duhet gjithashtu të ndihmojnë palët të përfshihen në një bashkëbisedim konstruktiv, në rastet kur konflikti ka lindur si rezultat i një komunikimi të dobët. Ata duhet të jenë mirëtrajnuar mbi:

- *Komunikimin dhe teknikat e negocimit dhe ndërmjetësimit*
- *Nivelet e komunikimit (verbal, paraverbal, joverbal); dëgjimi aktiv, pyetjet e hapura/të mbyllura përfshijne:*
- *Reflektimin, perfrazimin/riformulimin, përmbledhja; përballja me emocionet; pyetjet efektive;*
- *Empatia dhe pranimi; mbajtja përbrenda e mendimeve tuaja;*
- *Identifikimi i çështjeve; Riformulimi;*
- *Testimi i realitetit; Riorientimi.*

Fjale kyce: Aspekti gjinor, kombinim racional, seancë trajnuese, demonstrimin e roleve,

1. Universiteti Mesdhetar i Shqiperise, avdylidrita@yahoo.com

DEVELOPMENT OF MEDIATORS' COMMUNICATION SKILLS AND ESSENTIAL TECHNIQUES IN THE NEGOTIATION AND MEDIATION PROCESS

PhD. Drita Avdyli¹

Abstract

The mediation process is a dispute resolution mechanism that takes place through communication between two or more parties seeking to make decisions on shared issues. This communication serves as an exchange of information between the involved parties. However, many people take the role of communication in their relationships for granted and do not pay much attention to it.

Those who wish to become mediators should consider communication as a highly valuable field for both analysis and practice. More importantly, mediators must not only possess excellent communication skills to understand a dispute and connect the parties but also assist them in engaging in constructive dialogue, especially in cases where the conflict has arisen due to poor communication.

Mediators must be well-trained in:

- *Communication techniques, negotiation, and mediation skills*
- *Levels of communication (verbal, paraverbal, non-verbal); active listening; open/closed questions*
- *This includes:*
- *Reflection, paraphrasing/reformulation, summarization*
- *Handling emotions*
- *Effective questioning*

1. University Mediterranean of Albania, avdylidrita@yahoo.com

- *Empathy and acceptance*
- *Withholding personal opinions*
- *Identifying issues*
- *Reformulation*
- *Reality testing*
- *Reorientation*

Keywords: *Gender aspect, rational combination, training session, role demonstration.*

GARANCITË LIGJORE DHE REALITETET LOKALE: VLERËSIMI I TRANSPARENCËS DHE TË DREJTAVE ADMINISTRATIVE NË NIVEL LOKAL

Diamanta Vito¹

Megi Marku²

Abstrakt

Transparenca në proceset vendimmarrëse është një pjesë thelbësore e qeverisjes së mirë dhe një element kyç i së drejtës administrative. Ajo ndihmon në sigurimin që institucionet publike të veprojnë në mënyrë të hapur, të ndjekin ligjin dhe të jenë të përgjegjshme ndaj qytetarëve. Në Shqipëri, ligje si Kodi i Procedurave Administrative (Ligji Nr. 44/2015), Ligji për të Drejtën e Informimit (Ligji Nr. 119/2014), dhe Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (Ligji Nr. 146/2014) u japin qytetarëve të drejtën të informohen, të japin mendimin e tyre dhe të ankimojnë vendimet. Këto të drejta mbështeten gjithashtu nga Ligji për Vetëqeverisjen Vendore (Ligji Nr. 139/2015) dhe kuadri tjetër rregullator.

Ky punim shqyrton se si këto garanci ligjore përkthehen në praktikë në nivelin lokal, duke u mbështetur në një vlerësim të tetë bashkive në Shqipëri. Ai eksploron mekanizmat institucionalë që mbështesin transparencën — si proceset e konsultimit publik, programet e transparencës, regjistrat elektronikë dhe publikimi i vendimeve të këshillave — dhe vlerëson efektivitetin e tyre në operacionalizimin e të drejtave të qytetarëve, përfshirë gratë dhe grupet e tjera të cënueshme. Edhe pse bashkitë po tregojnë një rritje

1. Doktorante - Qendra Kërkimore për Studime dhe Zhvillim në Fushën e Ligjit dhe Ekonomisë, Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë, Universiteti i Elbasanit, Shqipëri
diamantavito@yahoo.com

2. Profesore e Asociuar - Qendra Kërkimore për Studime dhe Zhvillim në Fushën e Ligjit dhe Ekonomisë, Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë, Universiteti i Elbasanit, Shqipëri
megi.marku@uniel.edu.al

të ndërgjegjësimit dhe përputhshmërisë me detyrimet ligjore, zbatimin mbetet i pabarabartë për shkak të sfidave strukturore, kapaciteteve të kufizuara institucionale, zbatimit të pasigurt dhe boshllëqeve në përfshirjen qytetare.

Gjetjet tregojnë mangësi kyçe, përfshirë mungesën e informacionit të plotë në të dhënat e prokurimeve publike, publikimin e dobët të të dhënave për donacionet dhe përgjegjësi të paqarta të koordinatorëve të transparencës. Për më tepër, studimi identifikon mungesën e qasjeve të ndjeshme ndaj gjinisë në proceset e pjesëmarrjes dhe transparencës, çka kufizon përfshirjen e zërave dhe perspektivave të grave në vendimmarrjen vendore. Nevoja për trajnim të vazhdueshëm, mjete më të mira komunikimi dhe staf të dedikuar — së bashku me integrimin e strategjive të ndjeshme ndaj gjinisë — është e dukshme. Studimi përfundon me rekomandime konkrete për të forcuar garancitë procedurale, për të promovuar pjesëmarrje të mirëfilltë dhe gjithëpërfshirëse, si dhe për të institucionalizuar transparencën si një motor për përmirësimin e administratës publike, barazisë gjinore dhe llogaridhënies demokratike në sistemin e qeverisjes vendore në Shqipëri.

Fjalë kyçe: *transparencë, vendimmarrje, njësi të qeverisjes vendore, Shqipëri*

FROM LEGAL GUARANTEES TO LOCAL REALITIES: ASSESSING TRANSPARENCY AND ADMINISTRATIVE RIGHTS AT LOCAL LEVEL IN ALBANIA

Diamanta Vito¹

Megi Marku²

Abstract

Transparency in decision-making is an important part of good governance and a key element of administrative law. It helps ensure that public institutions act openly, follow the law, and are accountable to citizens. In Albania, laws such as the Code of Administrative Procedures (Law No. 44/2015), the Law on the Right to Information (Law No. 119/2014), and the Law on Public Consultation (Law No. 146/2014) give people the right to be informed, to give their opinion, and to appeal decisions. These rights are also supported by the Law on Local Self-Government (Law No. 139/2015) and other regulatory frameworks.

This paper examines how these legal guarantees are translated into practice at the local level, drawing on an assessment of eight municipalities in Albania. It explores the institutional mechanisms that support transparency—such as public consultation processes, transparency programs, electronic registers, and publication of council decisions—and assesses their effectiveness in operationalizing the rights of citizens, including women and other vulnerable groups. While municipalities demonstrate increasing awareness and

1. PhD Candidate - Research Centre for Research and Development in Law and Economics, Faculty of Business and Law, University of Elbasan, Albania
diamantavito@yahoo.com

2 Associate Professor -Research Centre for Research and Development in Law and Economics, Faculty of Business and Law, University of Elbasan, Albania
megi.marku@uniel.edu.al

compliance with legal obligations, the implementation remains uneven due to structural challenges, limited institutional capacity, inconsistent enforcement, and gaps in civic engagement.

The findings point to key deficiencies, including the lack of complete information in public procurement records, weak publication of donation data, and unclear responsibilities of transparency coordinators. Moreover, the study identifies a lack of gender-sensitive approaches in participatory and transparency processes, which limits the inclusion of women’s voices and perspectives in local decision-making. The need for ongoing training, better communication tools, and dedicated staffing, along with the integration of gender-responsive strategies, is evident. The study concludes with actionable recommendations to strengthen procedural safeguards, promote meaningful and inclusive participation, and institutionalize transparency as a driver of improved public administration, gender equality, and democratic accountability in Albania’s local governance system.

Key words: *transparency, decision making, local government units, Albania*

LIRIA E SHPREHJES DHE KUFIJTË E SAJ NË EPOKËN E INFORMACIONIT

Dr.Lisien Damini¹

Sara Hylviu²

Abstrakt

Liria e shprehjes zë një vend të rëndësishëm në shoqërinë moderne, duke u konsideruar si një nga themelet kryesore për realizimin dhe mbrojtjen e një sërë të drejtash të tjera themelore, për ruajtjen e dinjitetit si dhe përmbushjen e vetë mbajtësve të të drejtave si pjesë e një shoqërie të lirë e të hapur. Është një e drejtë që rrjedh nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut si dhe mbrohet edhe nga Kushtetuta e shtetit tone dhe e çdo shteti që respekton dhe garanton liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. E megjithatë shpeshherë duket si një koncept mjaft i gjerë që hap një debat të vazhdueshëm duke e ndarë shoqërinë në dy pjesë. Një pjesë e sheh termin “liri e shprehjes” si të palimituar mbi të cilin nuk mund të vendosen kufizime legjitime, as pjesërisht dhe as tërësisht, dhe ka të tjerë që e shohin si koncept abstrakt dhe realisht të pamundur për tu ekzekutuar. Qëndrime të tilla kontroverse me kohën e kanë bërë të paqartë kuptimin e lirisë së shprehjes. Kjo situatë gjen akoma dhe më shumë vështirësi në kohët që jetojmë ku teknologjia ka përparuar me hapa të shpejtë dhe është bërë pjesë e pandashme e rutinës sonë, dhe kur aksesimi në informacion është thuhet i palimituar dhe shpeshherë i pacensuruar. Ky punim do të trajtojë pikërisht kualifikimin ligjor dhe spektrin e kësaj të drejte, dhe se si ndihmon ndërhyrja që ndjek një qëllim legjitim dhe proporcionale në këtë të drejtë në një shoqëri demokratike e cila po jeton në epokën delikate të digjitalizimit dhe informacionit, për të mos shkelur dhe cënuar jetën private, familjare, dinjitetin, moralin, lirinë e mendimit apo besimit të tjetrit.

Fjalë kyçe: Liria e shprehjes, kufizime, proporcionalitet Kushtetuta, KEDNJ,

1. Pedagog, Universiteti Luarasi, lisiendamini11@gmail.com

2. Studente, Universiteti Luarasi, Fakulteti i Drejtësisë, Sara.Hylviu@luarasi-univ.edu.al

FREEDOM OF EXPRESSION AND ITS LIMITS IN THE INFORMATION ERA

Abstract

Freedom of expression maintains an important place in modern society, being considered one of the main foundations for the realization and protection of a number of other fundamental rights, for the protection of dignity and fulfillment of the right holders themselves as part of a free and open society. It is a right that derives from the European Convention on Human Rights and is also protected by the Constitution of our state and of every state that respects and guarantees fundamental human rights and freedoms. Yet it often seems like a very broad concept that opens up a continuous debate, dividing society into two parts. Some see the term of “freedom of speech” as unlimited, on which no legitimate restrictions can be placed, either partially or completely, and there are others who see it as an abstract concept and practically impossible to execute. Such controversial positions have over time made the meaning of freedom of speech and expression unclear. This situation gets even more difficult in the times we live where technology has advanced at a rapid pace and has become an inseparable part of our routine, and when access to information is almost unlimited and often uncensored. This paper will address precisely the legal qualification and spectrum of this right, and how restrictions that pursue a legitimate and proportionate aim to this right, help in a democratic society that is living in the delicate era of digitalization and information, so as not to violate and harm the private and family life, dignity, morality, freedom of thought or beliefs of others.

Key words: Freedom of speech, limitations, proportionality, Constitution, ECHR.

PARIMI I SIGURISE JURIDIKE - “MITI I SIZIFIT” NË SHTETIN TONË TË SË DREJTËS

Dr. Bernina Kondi¹

ABSTRAKT

Siguria juridike si term i veçantë nuk është gjithmonë i kuptueshëm për edhe vetë elementet që përmban. Sot ajo shfaqet si një ndër termat e rëndomta që bën pjesë në fjalorin e shumicës së politikanëve nga njëra anë dhe nga ana tjetër nga sistemi gjyqësor në Shqipëri. Shqipëria në rrugëtimin e saj për krijimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës vazhdon të sfidoj mitin e Sizifit në lidhje me parimin e Sigurisë juridike.

This study examines the role of artificial intelligence as a supportive mechanism for international institutions such as the United Nations, the European Court of Human Rights, and the Council of Europe, assessing both the challenges and opportunities of its implementation. By analyzing successful case studies of AI deployment in humanitarian crisis monitoring and fundamental rights protection, the study proposes a new approach to strengthening the international justice and accountability system. Integrating technology into this field would not only enhance the effectiveness of existing mechanisms but also reduce bureaucratic delays, making human rights protection faster and more reliable in an increasingly interconnected world.

NDRYSHIMET E FUNDIT NË KORNIZËN LIGJORE NË PROKURIMIN PUBLIK DHE PËRDORIMI I SISTEMIT TË E-PROKURIMIT

MSc. Rezelina Uka¹

Abstrakt

Kjo lidhje midis prokurimit publik dhe temës së konferencës mund të sjellë një diskutim të rëndësishëm për mënyrën se si proceset e prokurimit ndikojnë drejtpërdrejt në drejtësinë shoqërore, sigurinë e qytetarëve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Përdorimi i inovacionit teknologjik dhe implementimi i standardeve ndërkombëtare do të mundësojë që të drejtat e njeriut të respektohen më mirë gjatë gjithë procesit të prokurimit, duke siguruar një shoqëri më të drejtë, të sigurt dhe më të barabartë.

Andaj, prokurimi publik është një komponent kyç i administratës publike, duke ndikuar drejtpërdrejt në menaxhimin e financave publike dhe transparencën institucionale. Në Republikën e Kosovës, sektori publik, përmes prokurimeve publike, shpenzon një përqindje të konsiderueshme të buxhetit të shtetit. Kjo e bën prokurimin një fushë me rëndësi të lartë për qeverisjen e mirë dhe për interesin publik.

Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj fushe, ky hulumtim trajton përdorimin e sistemit të E-Prokurimit në Kosovë, duke analizuar ndikimin e tij në transparencën, efikasitetin dhe menaxhimin e fondeve publike. Përmes kësaj analize, synohet të identifikohen përparësitë dhe sfidat që paraqet ky sistem në përmirësimin e procedurave të prokurimit publik.

Sistemi i E-Prokurimit synon të përmirësojë transparencën dhe efikasitetin në menaxhimin e kontratave publike, duke zvogëluar hapësirat për korrupsion dhe abuzim me fondet publike. Sipas

1. Komuna e Gjiçanit, Kosovë, Zyrtare e Prokurimit Publik, rezelina.uka@rks-gov.net

Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, dhe ndryshimeve të mëvonshme, të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara të ndjekin procedura të qarta dhe të bazuara në ligj për të garantuar shpenzimin e drejtë dhe të kontrolluar të parasë publike. Për të lidhur temën e prokurimit publik me temën e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare, mund të theksohet se sistemi i prokurimit është një nga shtyllat kyçe që siguron drejtësi dhe transparencë në menaxhimin e burimeve publike dhe respektimin e të drejtave të individëve.

Fjalë Kyçe: Prokurimi publik, E-Prokurimi, transparenca, efikasiteti, ligji për prokurim, digjitalizimi, menaxhimi i fondeve publike.

RECENT CHANGES IN THE LEGAL FRAMEWORK IN PUBLIC PROCUREMENT AND THE USE OF THE E-PROCUREMENT SYSTEM

MSc. Rezelina Uka¹

Abstract

This connection between public procurement and the conference theme can lead to an important discussion on how procurement processes directly impact social justice, citizen security and the protection of human rights. The use of technological innovation and the implementation of international standards will enable human rights to be better respected throughout the procurement process, ensuring a fairer, safer and more equal society.

Therefore, public procurement is a key component of public administration, directly impacting the management of public finances and institutional transparency. In the Republic of Kosovo, the public sector, through public procurement, spends a significant percentage of the state budget. This makes procurement an area of high importance for good governance and the public interest.

Considering the importance of this area, this research addresses the use of the E-Procurement system in Kosovo, analyzing its impact on transparency, efficiency and management of public funds. Through this analysis, it is intended to identify the advantages and challenges that this system presents in improving public procurement procedures.

The E-Procurement System aims to improve transparency and efficiency in the management of public contracts, reducing the scope for corruption and abuse of public funds. According to the Law on Public Procurement No. 04/L-042, and subsequent amendments, all contracting authorities are obliged to follow clear and legally based

1. Municipality of Gjilan, Kosovo, Public Procurement Officer, rezelina.uka@rks-gov.net

procedures to guarantee the fair and controlled spending of public money. To connect the topic of public procurement with the topic of the International Scientific Conference, it can be emphasized that the procurement system is one of the key pillars that ensures fairness and transparency in the management of public resources and respect for the rights of individuals.

Key words: *Public procurement, E-Procurement, transparency, efficiency, procurement law, digitalization, management of public funds.*

LIRIA E MEDIAS NË SHQIPËRI, ANALIZË E PËRMIRËSIMIT TË LEGJISLACIONIT DHE PËRMBUSHJES SË KUSHTEVE, PËR ANËTARËSIM NË BASHKIMIN EVROPIAN.

Msc. Anxhela Kenaj¹
Msc. Elefteria Komino²

Abstrakt

Ky punim, ka si qëllim të analizojë zhvillimet ligjore të fundit në Shqipëri, në lidhje me lirinë e medias dhe përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me normat evropiane, duke vlerësuar ndikimin e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian, në përmirësimin e kushteve për lirinë e medias. Në pjesën e parë, do të shqyrtohen ndryshimet e legjislacionit të medias në Shqipëri gjatë viteve të fundit, përpjekjet e qeverisë për të përmirësuar kushtet për lirinë e medias dhe implementimin e standardeve evropiane në kuadër të reformave ligjore. Kjo pjesë do të përfshijë analizën e ligjeve dhe akteve normative të miratuara, që kanë pasur ndikim në mjedisin mediatik shqiptar.

Në pjesën e dytë, punimi do të përqendrohet në përputhshmërinë e ligjeve shqiptare me kërkesat e Bashkimit Evropian. Do të shqyrtohen rekomandimet e Komisionit Evropian dhe mënyra se si, ato janë zbatuar në praktikë. Pjesa e tretë, analizon ndikimin e kushteve për anëtarësimin në BE në lirinë e medias në Shqipëri, duke theksuar efektet pozitive dhe negative të këtij procesi në fushën e medias. Pjesë e kësaj analize do të jetë edhe trajtimi i piketave hapëse apo atyre të ndërmjetme, së bashku me masat e parashikuara në udhërrëfyesin për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, pjesë integrale e të cilit është edhe liria e medias.

1. anxhela_kenaj@hotmail.com

2 erikakomino@gmail.com

Në pjesën e katërt, të punimit, do të shqyrtohet roli i organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile në promovimin e lirisë së medias dhe forcimin e pavarësisë së saj në Shqipëri. Organizatat ndërkombëtare, si OSBE dhe Rrjeti i Gazetarëve Shqiptarë, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në këtë proces, ndërsa shoqëria civile ka kontribuar në mbrojtjen e lirisë së medias dhe mbështetjes së gazetarëve.

Në përfundim, punimi ofron rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës së medias në Shqipëri dhe përmbytjen e plotë të standardeve të Bashkimit Evropian. Ky studim do të përdorë një metodologji cilësore dhe analitike, duke përfshirë mbledhjen dhe analizën e të dhënave të cilësisë nga burime të ndryshme, si dokumente zyrtare, raporte të BE-së, studime të rastit, intervista me ekspertë dhe analiza të politikave publike.

MEDIA FREEDOM IN ALBANIA, ANALYSIS OF IMPROVING LEGISLATION AND FULFILLING CONDITIONS FOR MEMBERSHIP IN THE EUROPEAN UNION

Abstract

This article, aims to analyze recent legal developments in Albania, regarding media freedom and the compatibility of Albanian legislation with European norms, assessing the impact of the European Union integration proces, on improving the conditions for media freedom. The first part, will examine changes in media legislation in Albania in recent years, the government's efforts to improve the conditions for media freedom and the implementation of European standards within the legal reforms framework. This part will include an analysis of the adopted laws and normative acts, that have had an impact, on the Albanian media environment.

In the second part, the article will focus on the compatibility of Albanian laws with the requirements of the European Union. The recommendations of the European Commission and the way in which they have been implemented in practice, will be examined. The third part, analyzes the impact of the conditions for EU membership on media freedom in Albania, highlighting the positive and negative effects of this proces, in the field of media. Part of this analysis, will also be the treatment of the opening or intermediate milestones, together with the measures foreseen in the roadmap for Chapter 23 "Judiciary and Fundamental Rights", of which media freedom is an integral part.

The fourth part of the article, will examine the role of international organizations and civil society, in promoting media freedom and strengthening it's independence in Albania. International organizations, such as the OSCE and the Albanian Journalists Network, have played an important role in this process, while civil society has contributed to the protection of media freedom and support for journalists.

In conclusion, the article provides concrete recommendations for improving the media situation in Albania and fully meeting European Union standards. This study, will use a qualitative and analytical methodology, including the collection and analysis of quality data from various sources, such as official documents, EU reports, case studies, expert interviews and public policy analyses.

ANALIZA E KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVE TË HUAJ NË IAL-TË SHQIPTARE: SA KONKURRUES ËSHTË SEKTORI I NDËRKOMBËTARIZIMIT DHE CILAT JANË SFIDAT QË E PRESIN?

Agim Alia¹

Geron Kamberi²

Abstrakt

Strategjia Kombëtare e Arsimit në Shqipëri 2021–2026 thekson vështirësitë që hasin institucionet shqiptare të arsimit të lartë (IAL) për të tërhequr një numër të konsiderueshëm studentësh të huaj, përveç shqiptarëve etnikë nga vendet fqinje. Objektivat kryesore të Strategjisë janë rritja e numrit të studentëve të huaj të regjistruar në IAL-të shqiptare dhe pozicionimi i Shqipërisë si një qendër konkurruese rajonale e arsimit në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë. Studentët e huaj që synojnë të regjistrohen në universitetet shqiptare duhet të ndjekin procedura dhe të plotësojnë disa kërkesa të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi. Çështja që shtrohet këtu është analiza nëse këto kërkesa dhe procedura po lehtësojnë apo po pengojnë regjistrimin e studentëve të huaj.

Qëllimi parësor i këtij punimi është të analizojë zhvillimet dhe sfidat aktuale të kuadrit ligjor dhe institucional në Shqipëri, me fokus të veçantë në krijimin e një mjedisi efektiv dhe tërheqës për studentët e huaj që synojnë të ndjekin studimet e larta në vend. Kërkimi shqyrton kuadrin legjislativ që rregullon këtë fushë, duke evidentuar arritjet kryesore si dhe sfidat që vazhdojnë të ndikojnë në mënyrën e funksionimit të këtij procesi. Punimi synon të ofrojë një vlerësim

1. Luarasi University (LU), Albania, agim.alia@luarasi-univ.edu.al

2. Luarasi University (LU), Albania, geron.kamberi@luarasi-univ.edu.al

të argumentuar mbi sfidat ligjore dhe institucionale që shoqërojnë përpjekjet për tërheqjen e studentëve të huaj dhe realizon një analizë krahasuese me vendet fqinje dhe ato të Bashkimit Evropian. Hipoteza kërkimore e trajtuar në këtë studim është se, ndonëse ekzistojnë kushte dhe premisa reale për rritjen e numrit të studentëve të huaj në institucionet shqiptare të arsimit të lartë, ky proces has pengesa për shkak të mangësive në kuadrin ligjor e institucional, si dhe të zbatimit të pamjaftueshëm të legjislationit në fuqi.

Fjalë kyçe: *Studentë të huaj, Ndërkombëtarizimi, IAL, regjistrimi, kuadri ligjor, sfidat*

ANALYSIS OF LEGAL AND INSTITUTIONAL FRAMEWORK OF FOREIGN STUDENTS ENROLMENT IN ALBANIAN HEI: HOW COMPETITIVE IS THE INTERNATIONALIZATION SECTOR ON THIS ISSUE AND WHAT ARE THE CHALLENGES AHEAD?

Agim Alia¹

Geron Kamberi²

Abstract

The Albanian National Education Strategy 2021-2026 emphasizes the struggle of Albanian Higher Education Institutions (HEIs) to attract a significant number of foreign students, aside from ethnic Albanians from neighboring countries. Key objectives of the Strategy are to increase the number of foreign students enrolled in Albanian HEI and to position Albania as a competitive regional education hub within the Western Balkans and beyond. Foreign students seeking to enroll in Albanian universities need to follow specific procedures and meet certain requirements provided by the legal framework in power. The issue posed here is to analyze if these requirements and procedures are facilitating or hindering the enrollment of foreign students.

The main purpose of this paper is to research the current developments and challenges of legal and institutional framework in Albania to ensure an effective and attracting environment, particularly in creating a suitable environment for foreign students to study in Albania. The research explores the legislative framework on this issue, identifying main achievements and challenges. This paper attempts to provide an assessment of the current legal and institutional

1. Luarasi University (LU), Albania, agim.alia@luarasi-univ.edu.al

2. Luarasi University (LU), Albania, geron.kamberi@luarasi-univ.edu.al

challenges of attracting foreign students and make comparisons to the neighboring and european countries. The research hypothesis here is that, although there are real facts and premises to increase the number of foreign students enrolled in Albanian HEI, this process is slowed down due to obstacles of legal and institutional framework and weak implementation of legal framework.

Keywords: *Foreign Students, Internationalization, HEI, enrolment, legal framework, challenges*

SFIDAT E ZBATIMIT TË PARIMIT TË MERITËS NË BËRTHAMËN E ADMINISTRATËS PUBLIKE NË SHQIPËRI

Kozeta Vuksanlekaj¹

Abstrakt

Tema është mjaft aktuale pas hapjes zyrtare të negociatave për anëtarësim në BE, sepse aspirata e popullit shqiptar për të përmbushur standartet për integrimin evropian, kërkon kapacitete të larta administrative, krijimin e një elite intelektuale me integritet dhe të aftë profesionalisht. Për këtë arsye, tema fokusohet tek kapitali njerëzor, tek asetit intelektual i strukturave më të rëndësishme shtetërore, që në tërësinë e tyre përbëjnë shërbimin civil apo bërthamën e administratës publike. Duke marrë parasysh strukturën e punimit, fokusi është tek risitë kryesore që solli ligji i shërbimit civil i miratuar nga legjislatori shqiptar në vitin 2013, si dhe problematikat e zbatimit të meritës në shërbimin civil.

Hipotezat

Përballja e përmbajtjes së legjislacionit të shërbimit civil me realitetin e jetësimit të tij në praktikë, ka në fokus të hulumtimeve pyetje mjaft sfiduese;

Çfarë reformash duhen ndërmarrë, në mënyrë që parimi i meritës në shërbimin civil, të jetë faktor kyç për të formuar një administratë publike më të përgjegjshme, më profesionale, më të qëndrueshme, me njerëz të aftë, me integritet dhe të përkushtuar për të përballuar sfidat e integritetit evropian?

Cilat janë risitë pozitive të reformave ligjore të shërbimit civil në Shqipëri?

Si mund të garantohet karriera dhe qëndrueshmëria në detyrë e një

1. Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Luarasi, Tiranë, kozetavuksanlekaj@qarkushkoder.gov.al;

nëpunësi civil me integritet dhe të aftë profesionalisht, në një realitet të politizuar?

Metodologjia

Për të vërtetuar hipotezat e ngritura, do të përdoret metoda empirike, bazuar tek vëzhgimet e drejtpërdrejta të një nëpunësi civil, si dhe ndërthurja e tyre me njohuritë shkencore. Për trajtimin e temës, do të përdoren qasje krahasimore ndërmjet ligjit shqiptar dhe kosovar, por jo vetëm. Ndërkohë, do të përdoret metoda normative, si dhe metoda logjike juridike. Natyrisht, edhe sinteza juridike, do të jetë e nevojshme për të arritur në konkluzione dhe rekomandime të rëndësishme.

Konkluzione dhe rekomandime

Reformat e reja të shërbimit civil në Shqipëri, kanë shënuar progres të dukshëm, duke ofruar mekanizma efikas për zbatimin e meritës, konkretisht përdorimin e rekrutimeve në grup për nivelin ekzekutiv të NC-së, si dhe në përdorimin e teknikave të reja administrative. Por reforma të tilla kanë qenë të njëanshme, sepse shumica e risive të reja të LNC-së¹ (2013) janë zbatuar vetëm në institucionet e administratës shtetërore.² Ndërsa tek institucionet e pavarura është ruajtur menaxhimi i decentralizuar, duke mos parashikuar asnjë masë mbrojtëse ndaj militantizmit.

Shërbimi civil është aset i çmuar i administratës publike, bërthama intelektuale e shtetit, që duhet të jetë e përhershme, profesionale, me integritet dhe e pavarur nga politika, në kushtet e paqëndrueshmërisë të forcave politike të qeverisjes, të kontrolluara në mënyrë periodike nga vota e qytetarëve.

Përmbajtja e ligjit sado e përsosur të jetë nuk ka asnjë vlerë, nëse nuk sigurohet jetësimi i tij në realitet. Dhe për zbatimin e ligjit duhet të hartohen akte nënligjore proceduriale, që zbërthejnë të gjitha detyrimet ligjore në veprime konkrete, si dhe të ndërtohen institucione efikase që sigurojnë zbatimin e ligjit.

Fjalët kyçe: Shërbim Civil, nëpunës civil, parimi i meritës, militantizëm.

1. Ligji i nëpunësit civil.

2. Në institucionet e administratës shtetërore përfshihen institucionet qendrore dhe institucionet në varësi të tyre. Ndërsa tek institucionet e pavarura përfshihen edhe bashkitë dhe qarqet.

THE CHALLENGES OF IMPLEMENTING THE PRINCIPLE OF MERIT IN THE CORE OF PUBLIC ADMINISTRATION IN ALBANIA

Kozeta Vuksanlekaj¹

Abstract

The topic is quite actual because the aspiration of the Albanian people to meet the standards for integration into the European Union, requires high administrative capacities and the creation of an intellectual elite with integrity and professional competence. For this reason, the topic focuses on human capital, the intellectual asset of the most important state structures, which constitute the civil service, the core of public administration. Considering the structure of the paper, the focus is on the main changes introduced by the civil service law approved by the Albanian legislator in 2013, as well as the issues related to the implementation of merit in the civil service.

Hypotheses

While confronting the content of the civil service legislation with the reality of its implementation in practice, the research focuses on challenging questions;

What reforms should be taken, so that the principle of merit in the civil service is a key factor to form a more responsible, professional, and stable public administration, with capable people with integrity and dedicated to face the challenges of European integration?

What are the positive novelties of the legal reforms of the civil service in Albania?

How can the career and stability of a civil servant with integrity and

1. Faculty of Law, University "Luigj Gurakuqi", Shkodër, Albania. kozetavuksanlekaj@qarkushkoder.gov.al;

professional capabilities be guaranteed, in a politicized reality?

Methodology

To test the hypotheses raised, an empirical method will be used, based on direct observations of a civil servant, as well as the integration of these observations with scientific knowledge. For the treatment of the topic, comparative approaches between Albanian and Kosovo law will be used, among others. Additionally, normative and legal logical methods will be used. Naturally, legal synthesis will also be necessary to reach important conclusions and recommendations.

Conclusions and Recommendations

The new reforms of the civil service in Albania have delivered significant progress, providing efficient mechanisms for the implementation of merit, specifically the use of group recruitment for the executive level of the civil servant, as well as in the use of new administrative techniques. But such reforms have been one-sided because most of the innovations of the CSL¹ (2013) have been implemented only in state administrative institutions. While in the independent institutions, decentralized management has been preserved, not foreseeing any protective measures against militancy.

The civil service is the most valuable asset of public administration, the intellectual core of the state, which should be permanent, professional, with integrity, and independent from politics, opposed to the instability of political forces in governance, which are periodically controlled by citizens' votes.

No matter how perfect the contents of the law may be, it has no value if its implementation in reality is not ensured. For the enforcement of the law, procedural subordinate acts must be drafted to break down all legal obligations into concrete actions, specifying in detail the coordination and the establishment of efficient institutions that ensure the law's implementation.

Keywords: Civil Service, civil servant, principle of merit, militancy.

1. Civil servant law (CSL).

SIGURIA MJEDISORE SI PERSPEKTIVË E SIGURISË KOMBËTARE BASHKËKOHORE

PhD (c) Kejsi Rizo¹

Abstrakt

Siguria kombëtare lidhet me mbrojtjen e interesave shtetërore dhe stabilitetin e vendit në të gjitha aspektet e tij, përfshirë rendin publik, ekonominë, infrastrukturën kritike, mbrojtjen e interesave kombetare, etj. Nocioni i sigurisë ka evoluar gjatë historisë, së bashku me zhvillimin shoqëror, ekonomik e teknologjik të shoqërive, ndaj sot ajo nuk shihet vetëm përmes lenteve tradicionale të mbrojtjes ushtarake. Garantimi i sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, që integron shumë faktorë të jetës shoqërore. Në nivel kombëtar, siguria lidhet me mbrojtjen e shtetit nga kërcënime të jashtme dhe të brendshme, si sulmet ushtarake, terrorizmi, krizat ekonomike, krizat mjedisore etj. Në nivel ndërkombëtar ka pasur dhe vijon të ketë përpjekje për të përcaktuar mekanizmat për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar, si edhe të sovranitetit shtetëror të shteteve.

Siguria mjedisore, si një aspekt i rëndësishëm i çështjeve të sigurisë, lidhet ngushtë me një nga të drejtat themelore të njeriut, që është e drejta për një mjedis të pastër, të shëndetshëm e të sigurt, dhe ndikon në të drejta të tjera themelore, si e drejta për jetën, shëndetin, ushqimin, strehimin, etj. Nëse siguria mjedisore rrezikohet nga ndotja, ndryshimet klimatike, shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve natyrore, etj., pasojat e saj jo vetëm dëmtojnë drejtpërdrejt cilësinë e jetës, por mund të shkaktojnë edhe kriza më të mëdha.

*Ky punim trajton **çështjen** e sigurisë, duke u ndalur tek një ndër*

1. Ndihmëskomisionere pranë institucionit të Avokatit të Popullit, Doktorante pranë Departamentit të së Drejtës Publike, FDUT, kejsi.rizo.dr@gmail.com

*dimensionet më bashkëkohore të **çështjeve** të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, që lidhet me faktorin e mjedisit i cili gjithnjë e më shumë dekadat e fundit **është** vendosur në qendër të vëmendjes ndërkombëtare, për shkak të pasojave që ngërthen. Ndryshimet mjedisore, e veçanërisht ato klimatike, duket se janë një mozaik i përbërë nga shumë faktorë, që shkaktojnë mungesë të burimeve kryesore për jetesën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërive njerëzore, duke nxitur rrezikun për pasiguri dhe destabilitet në shkallë lokale, kombëtare dhe globale.*

Fjalë kyçe: Siguria kombetare; Siguria mjedisore; Ndryshimet klimatike; Të drejtat e njeriut;

ENVIRONMENTAL SECURITY AS A CONTEMPORARY PERSPECTIVE OF NATIONAL SECURITY

Abstract

National security is related to the protection of state interests and the stability of the country in all its aspects, including public order, the economy, critical infrastructure, the protection of national interests, and more. The concept of security has evolved throughout history, alongside the social, economic, and technological development of societies. Today, it is not only viewed through the traditional lenses of military defense. Ensuring national and international security requires a comprehensive approach that integrates many factors of social life. At the national level, security involves protecting the state from external and internal threats, such as military attacks, terrorism, economic crises, environmental crises, etc. At the international level, there have been, and continue to be, efforts to define mechanisms for maintaining international peace and stability, as well as the sovereignty of states.

Environmental security, as an important aspect of security issues, is closely related to one of the fundamental human rights, which is the right to a clean, healthy, and safe environment. It also impacts other fundamental rights, such as the right to life, health, food, housing, etc. If environmental security is threatened by pollution, climate change, uncontrolled exploitation of natural resources, etc., its consequences not only directly harm the quality of life but can also cause even greater crises.

This paper addresses the issue of security, focusing on one of the most contemporary dimensions of national and international security issues, which is related to the environmental factor. This factor has increasingly been placed at the center of international attention in recent decades, due to the consequences it entails. Environmental

changes, especially climate changes, seem to be a mosaic composed of many factors that cause a lack of essential resources for the survival and sustainable development of human societies, thus driving the risk of insecurity and instability at local, national, and global levels.

Key words: *National security; Environmental security; Climate change; Human rights.*

SHPËRDORIMI I BURIMEVE PUBLIKE NË PERIU DHËN E ZGJEDHJEVE

Dhimitër Zguro¹

Abstrakt

Shpërdorimi i burimeve publike përbën një sfidë për shumë demokraci evropiane, duke përfshirë edhe ato shtete, që kanë traditë zgjedhore të konsoliduar. Me qëllim parandalimin e këtij fenomeni, duke synuar garantimin e integritetit të procesit zgjedhor dhe barazisë në të, si në instrumentet ndërkombëtare, ashtu edhe në të drejtën e brendshme, janë parashikuar detyrime qoftë për autoritetet publike, qoftë për partitë politike. Në Shqipëri, pavarësisht ndërhyrjeve legislative, raportet ndërkombëtare të vëzhgimit të zgjedhjeve kanë vazhduar ta identifikojnë shpërdorimin e burimeve publike si një shqetësim të rëndësishëm gjatë procesit zgjedhor në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur. Kontrastet që ekzistojnë ndërmjet standardeve ndërkombëtare, parashikimeve ligjore në fuqi dhe zbatimit në praktikë të tyre, krijojnë premisa për shpërdorimin e burimeve publike. Ndaj, ky punim shqyrton legjislacionin zgjedhor shqiptar dhe zbatimin e tij në praktikë, duke e krahasuar me standardet ndërkombëtare të zgjedhjeve, me qëllim jo vetëm evidentimin e kontrasteve, por edhe ofrimin e rekomandimeve konkrete, duke synuar rritjen e garancive ligjore për një proces zgjedhor të drejtë.

Fjalë kyçe: e drejta zgjedhore, Kodi Zgjedhor, fushata zgjedhore, burime publike.

1. MSc. Dhimitër Zguro, Junior Associate pranë Halimi Law and Tax. dhimiterzguro@gmail.com / dhzguro@halimi.al

MISUSE OF PUBLIC RESOURCES DURING THE ELECTORAL PERIOD

Dhimitër Zguro¹

Abstract

The issue of the misuse of public resources has proven to be a challenge for many European democracies, including those countries with a well-established electoral tradition. In order to prevent this phenomenon, with a view to guaranteeing the integrity of the electoral process and equality in it, both in international instruments and in domestic law, obligations have been foreseen for both public authorities and political parties. In Albania, despite the implementation of legislative interventions, international election observation reports have repeatedly identified the misuse of public resources as a significant concern during the electoral process. The discrepancy between international standards, legal provisions and their practical implementation creates a context conducive to the misuse of public resources. This paper therefore examines Albanian electoral legislation and compares it with international electoral standards. It aims to highlight the discrepancies between the two and provide concrete recommendations for increasing legal guarantees for a fair electoral process.

Key words: electoral law, Electoral Code, electoral campaign, public resources.

1 MSc. Dhimitër Zguro, Junior Associate at Halimi Law and Tax. dhimiterzguro@gmail.com / dhzguro@halimi.al

DREJTËSIA KUSHTETUESE DHE MBROJTJA E TË DREJTËS PËR MJEDIS TË SHËNDETSHËM SI E DREJTË THEMELORE

Esmeralda Metko¹

Subian Dalani²

Abstrakt

Të drejtat e brezit së tretë, të njohura ndryshe si të drejta moderne, janë kategoria e të drejtave që janë komplekse për tu trajtuar për faktin se, aq sa janë “të reja” në kontekstin e trajtesës juridike, aq edhe janë “të vjetra” pasi në vetëvete kanë qëndruar gjithmonë me njeriun në mënyrë të natyrshme.

E drejta për mjedis të shëndetshëm parë në këndvështrimin e së drejtës kushtetuese, na sjell në vëmendje debate juridike shumë interesante, si psh teoritë që studiojnë personalitetin juridik të natyrës. Në këtë kuadër, ky punim fillimisht trajton të drejtën për mjedis të shëndetshëm duke marrë në analizë teoritë apo rrymat juridike që e konsiderojnë natyrën si “gjë të gjallë” dhe e paisin atë me personalitet juridik duke e “titulluar” me të drejta të caktuara.

Në vijim, trajtohet konteksti shqiptar për mënyrën se si kjo e drejtë pozicionohet në rendin juridik shqiptar, si dhe janë analizuar zhvillimet që vijnë nga jurisprudenca në lidhje me këtë çështje e specifikisht për ato raste që vijnë nga praktika, ku natyrës i janë dhënë të drejta. Dukë qënë së është e drejtë moderne, në kuptimin që trajtimi juridik i saj është relativisht i ri jemi ndalur dhe kemi trajtuar konfliktet parimore dhe etike, në raport me rregullimet ligjore që natyra dhe mjedisi duhet të kenë. Në frymën e gjithë punimit jemi munduar ti përgjigjemi pyetjes: Kush flet për mjedisin?

1. Studente Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, esmeraldametko5@gmail.com

2 Student , Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, dalanisubian@gmail.com

duke konkluduar në fund, në disa rekomandime dhe konkluzione mbi qasjen që duhet të kemi ndaj mjedjsit ku jetojmë, dhe pse e drejta për mjedis të shëndetshëm në kontesktin juridik shqiptar nuk duhet të ngelet thjeshtë një objektiv social por duhet që ti sigurohet vendi si një e drejtë themelore kushtetuese.

CONSTITUTIONAL JUSTICE AND THE PROTECTION OF THE RIGHT TO A HEALTHY ENVIRONMENT AS A FUNDAMENTAL RIGHT

Esmeralda Metko¹

Subian Dalani²

Abstract

Third-generation rights, also referred to as modern rights, constitute a category of rights that are legally intricate to address, given that they are both “new” in terms of their legal recognition and “old” in the sense that they have inherently coexisted with human existence.

The right to a healthy environment, within the framework of constitutional law, gives rise to compelling legal debates, including theories concerning the legal personality of nature. In this regard, this paper initially examines the right to a healthy environment by analyzing legal doctrines and jurisprudential trends that conceptualize nature as a “legal entity” vested with specific rights.

Subsequently, the paper delves into the Albanian legal framework, assessing how this right is embedded within the national legal order and scrutinizing relevant judicial precedents, particularly cases where legal standing has been conferred upon nature. Given that this right is of a modern character, meaning its legal treatment remains relatively recent, the study also explores fundamental and ethical conflicts in relation to the normative framework governing environmental protection.

Throughout the analysis, the central inquiry revolves around the question: Who speaks for the environment? The study ultimately

1. Student, Faculty of Law, University of Tirana, esmeraldametko5@gmail.com

2 Student, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, dalanisubian@gmail.com

presents key conclusions and recommendations, advocating for a legal approach whereby the right to a healthy environment in the Albanian constitutional order is not merely perceived as a socio-political objective but is formally recognized and safeguarded as a fundamental constitutional right.

DËMI NGA AKSIDENTET NË PUNË SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR. LLOJET E PËRGJEGJËSISË SË PUNËDHËNËSIT DHE PROBLEMET E HASURA NË PRAKTIKËN GJYQËSORE

Enton Dhimitri¹

Abstrakt

Siguria dhe shëndeti në punë është një komponent i rëndësishëm i mbrojtjes sociale të punëmarrësve, e cila gezon një mbrojtje nga aktet kombëtare dhe ndërkombëtare. E drejta për mbrojtje sociale është një e drejtë “pozitive”. Krahas njohjes dhe parashikimit të saj në aktet ligjore, shteti ka detyrimin të marrë të gjithë masat jo vetëm për ta njohur, por edhe për ta garantuar atë. Kuadri ligjor vendas, në parim ka parashikuar një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore që garantojnë dhe mbrojnë shëndetin dhe jetën e punëmarrësve në punë. Por në praktikë shfaqen shumë problematika, të cilat kanë sjellë cënimin e shëndetit të punëmarrësve, deri në humbjen e jetës së tyre.

Numri i rasteve të aksidenteve në punë është në rritje të vazhdueshme, duke krijuar një situatë problematike, e cila kërkon marrjen e masave ligjore dhe administrative për të parandaluar ndodhjen e tyre.

Përveç parandalimit një rëndësi thelbësore në rastin e aksidenteve në punë paraqet edhe kompensimi i dëmeve pasurore dhe jo pasurore i punëmarrësve dhe i të afërmeve të tyre apo dhe i personave të tretë të pranishëm në ambientet e punës.

Punimi ka në fokus analizimin e kuadrit ligjor për përgjegjësinë civile të punëdhënësit, shpërblimin e dëmit që i është shkaktuar punëmarrësit nga aksidenti në punë ose në rastin e vdekjes, familjarëve të tij, duke identifikuar dispozitat kontradiktore si dhe

1. Anëtar i Gjykatës së Lartë, enton_gj@live.com

duke evidentuar e mënyrën e duhur të interpretimit, me qëllim dhe zbatimin efektive të tyre në praktikë.

Praktika gjyqësore nuk ka patur një vijë ndarëse të qartë në lidhje me individualizimin e kriterëve për përcaktimin e llojit të kësaj përgjegjësie civile, si kontraktuale apo jo kontraktuale duke krijuar konfuzion mbi mënyrën e përcaktimit të barrës së provës apo për afatet e parashrimit për secilën prej padive që lidhen me to, që i diferencojnë ato nga njëra-tjetra dhe që krijojnë pasoja të ndrsyhme juridike në raport me të drejtat e punëmarrësve,

Nga ana tjetër, cilësimi i saktë i llojit të përgjegjësisë në këto raste shërben për të shmangur përfitimet e dyfishta, nga legjislacioni i sigurimeve shoqërore dhe nga Kodi Civil, që do të binte ndesh me Përgjegjësia e punëdhënësit mund të jetë edhe pa faj dhe një vend të rëndësishëm në këtë punim zënë kushtet e lindjes së kësaj përgjegjësie sidomos kur veprimtaria e punëdhënësit vlerësohet si e rrezikshme për shkak të natyrës së saj apo sendeve që përdoren gjatë kësaj veprimtarie.

Në praktikën gjyqësore shqiptare nuk evidentohet qartë dallimi i përgjegjësisë objektive nga përgjegjësia me faj duke vënë në mënyrë të gabur shenjën e barazisë ndërmjet tyre dhe duke rënduar në mënyrë të padrejtë pozitat e punëmarrësit, për shkak të barrës më të lehtë provuese që ka punëdhënësi në rastin e përgjegjësisë me faj.

Një lloj i veçantë i përgjegjësisë që evidentohet në rastin e aksidenteve në punë është dhe përgjegjësia e përzier ku fajësia e punëdhënësit në shkaktimin e dëmit konkurron me përgjegjësinë e punëmarrësit. Në praktikën gjyqësore, përveç ekzistencës së boshllëkut ligjor në fushën e dëmit jokontraktor në lidhje me kushtet e lindjes së kësaj përgjegjësie, nuk ka patur as një kuptim të drejtë praktik të kësaj përgjegjësie duke e konfoduar atë me përgjegjësinë objektive

Përgjegjësia e punëdhënësit është analizuar edhe në formën e një përgjegjësie të prejardhur, që gjen zbatim kur punëdhënësi përgjigjet për dëmet e shkaktuar gjatë marrëdhënies së punës nga punëmarrësit.

Në praktikën gjyqësore nuk është mbajtur një qëndrim koherent nëse neni 618 i Kodit Civil, është i zbatueshëm në këtë rast edhe

kur i dëmtuari nga aksidenti në punë është një punëmarrës tjetër, i ndryshëm nga punëmarrësi fajtor apo nëse përgjegjësia e punëdhënësit në këtë rast është kontraktore apo jokontraktore dhe si qëndron kjo përgjegjësi në raport me parashikimet e nenit 39/2 të KP në lidhje me zbritjen e shpërblimit të përfituar si pension invaliditeti, nga vlera totale e dëmit të shkaktuar.

Në sintezë të parashtrimeve të mësipërme duhet theksuar se aspektet teorike dhe dallimet për secilën nga llojet e përgjegjësisë në rrsin e dëmeve të shkaktuara nga aksidentet në punë janë ndërthurur dhe analizuar me shembuj konkret nga praktika gjyqësore, shqiptare dhe ajo e huaj, me qëllim evidentimin e problematikave që ka kuadri ligjor ekzistues në lidhje me garantimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve ose personave të tretë dhe adresimin e rekomandimeve konkrete.

WORKPLACE ACCIDENT DAMAGES UNDER ALBANIAN LEGISLATION: TYPES OF EMPLOYER LIABILITY AND CHALLENGES IN JUDICIAL PRACTICE

Abstract

Occupational health and safety represent a crucial component of employees' social protection, enjoying safeguards provided by both national and international legal instruments. The right to social protection is a “positive” right. Beyond its recognition and inclusion in legal acts, the state bears the obligation to take all necessary measures not only to acknowledge this right but also to ensure its effective implementation. The national legal framework, in principle, has foreseen a series of laws and bylaws that aim to protect the health and lives of employees in the workplace. However, practical implementation reveals numerous issues that have led to the infringement of employees' health, even resulting in loss of life.

The number of workplace accidents continues to rise, creating a problematic situation that requires urgent legal and administrative measures to prevent their occurrence. In addition to prevention, the compensation of material and non-material damages suffered by employees, their family members, or third parties present at the workplace is of fundamental importance in cases of accidents.

This paper focuses on the analysis of the legal framework regarding employer civil liability, the compensation of damages caused to employees due to workplace accidents or, in the event of death, to their family members. It identifies contradictory provisions and highlights the appropriate methods of interpretation with the aim of ensuring their effective application in practice.

Judicial practice has lacked a clear demarcation in determining the nature of this civil liability—whether contractual or non-

contractual—creating confusion regarding the allocation of the burden of proof and the applicable statute of limitations for each type of claim, both of which carry different legal consequences with respect to employees' rights.

Furthermore, accurately determining the type of liability in such cases helps avoid double compensation under both the social insurance legislation and the Civil Code, which would contravene the principle of full compensation for damages.

Employer liability may also arise irrespective of fault, and this study gives particular importance to the conditions under which such strict liability arises, especially when the employer's activity is considered inherently hazardous due to its nature or the tools used.

In Albanian judicial practice, there is no clear distinction between strict liability and fault-based liability, often equating the two erroneously and unfairly burdening the employee, given the lighter evidentiary burden placed on the employer in cases involving fault-based liability.

A particular form of liability addressed in workplace accident cases is contributory liability, where the employer's fault in causing the damage is combined with the contributory negligence of the employee. In addition to legal gaps regarding the conditions for the emergence of non-contractual liability, judicial practice has also failed to correctly interpret this type of liability, often confusing it with strict liability.

Employer liability is also analyzed in the context of vicarious liability, which applies when the employer is held responsible for damages caused by employees during the course of their employment.

Judicial practice has not maintained a consistent stance on whether Article 618 of the Civil Code applies when the injured party is an employee other than the one at fault, nor whether the employer's liability in such cases is contractual or non-contractual. Uncertainty also remains about how this liability interacts with Article 39/2 of the Labor Code, particularly concerning deductions from the total damage award in cases where the injured party has received a disability pension.

In conclusion, the theoretical aspects and distinctions between various types of liability in cases of workplace accident damages have been interwoven and analyzed using concrete examples from both Albanian and foreign judicial practices. The objective is to highlight the shortcomings of the existing legal framework in guaranteeing the health and safety of employees and third parties and to provide concrete recommendations for improvement.

HEQJA DORË NGA TRASHËGIMIA SIPAS LIGJIT PËR TRASHËGIMIN I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Prof. Asoc. Dr. Muharem Faiku¹

Liridona Avdyli²

Imran Sejfullahu³

Heqja dorë nga trashëgimia është një proces i rregulluar nga Ligji për Trashëgiminë e Kosovës, i cili parashikon mundësinë për të hequr dorë nga të drejtat e trashëgimisë së në personi të vdekur. Ky akt mund të kryhet përmes një deklarate të qartë dhe të lirë të vullnetit të trashëgimtarit. Megjithatë, ky proces duhet të jetë në përputhje me kushtet ligjore dhe procedurat e parashikuara nga ligji, duke garantuar që çdo akt i heqjes dorë nga trashëgimia të jetë i vlefshëm dhe që mos i shkelë të drejtat e personave të tjerë të cilët janë përfshirë në këtë proces. Çfarë përmban procedura ligjore për heqjen dorë nga trashëgimia, sipas Ligjit për Trashëgiminë në Kosovë? Cilat janë pasojat ligjore të heqjes dorë nga trashëgimia për trashëgimtarët? A mund të heqë dorë nga trashëgimia një trashëgimtarë pa vullnetin e tij të lirë dhe pa ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara? Ligji për Trashëgiminë e Kosovës gjithashtu ka përcaktuar pasojat që mundë të ndodhin me rastin e heqjes dorë nga trashëgimia, përfshirë edhe ndikimet mbi pasuritë dhe përgjegjësitë ligjore të trashëgimtarëve.

Kypunim ka për qëllim të analizojë aspektet ligjore dhe procedurale të heqjes dorë nga trashëgimia sipas Ligjit për Trashëgiminë në Kosovë. Heqja dore nga trashëgimia është një akt i ndërmarrë nga trashëgimtari, i cili ka mundësinë të heqë dorë nga e drejta e tij për të trashëguar pasurinë e një të ndjeri, në përputhje me ligjin në fuqi. Gjithashtu, do të analizohet procedura ligjore që

1. University "Ukshin Hoti" Prizren, Republic of Kosovo, muharem.faiku@uni-prizren.com

2. Student, Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, liridonaavdyli.pz@gmail.com

3. Student, Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, imransejfullahu5@gmail.com

duhet ndjekur për realizimin e këtij akti dhe çfarë ndikimi ka në të drejtat e tjera të trashëgimtarëve.

Fjalë kyçe: *Trashëgimtarët, procedura ligjore, deklarata e vullnetit, Ligji për Trashëgimi i Kosovës.*

WAIVER OF INHERITANCE ACCORDING TO THE LAW ON INHERITANCE OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Prof. Asoc. Dr. Muharem Faiku¹

Liridona Avdyli²

Imran Sejfullahu³

The waiver of inheritance is a process regulated by the Law on Inheritance of Kosovo, which provides for the possibility of waiving the inheritance rights of a deceased person. This act can be carried out through a clear and free declaration of the will of the heir. However, this process must be in accordance with the legal conditions and procedures provided for by the law, ensuring that any act of waiving the inheritance is valid and does not violate the rights of other persons who are involved in this process. What does the legal procedure for renouncing inheritance contain, according to the Law on Inheritance in Kosovo? What are the legal consequences of renouncing inheritance for heirs? Can an heir renounce inheritance without his free will and without following the established legal procedures? The Law on Inheritance in Kosovo has also determined the consequences that may occur in the event of renouncing inheritance, including the impacts on the assets and legal responsibilities of the heirs. This paper aims to analyze the legal and procedural aspects of renouncing inheritance according to the Law on Inheritance in Kosovo. The renunciation of inheritance is an act undertaken by the heir, who has the opportunity to waive his right to inherit the property of a deceased person, in accordance with the law in force. It will also analyze the legal procedure that must be followed to carry out this act and what impact it has on the other rights of the heirs.

